



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR I HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS 2019-2027

Tetor 2019

Hartuesi i Raportit të VSM i HZK-së Podujevë

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë “INSI” shpk

1. Ismajl Baftijari
2. Reshat Azizi
3. Valon Gërmizaj

Përmbajtja

Hartuesi i Raportit të VSM i HZK-së Podujevë.....	2
Lista e Tabelave.....	4
Lista e figurave	4
Lista e akronimeve dhe shkurtesave.....	5
1.0 Hyrje.....	6
1.1 Të Dhëna Historike	10
1.2. Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor	11
1.3. Objektivat e VSM për Harten Zonale të komunës së Podujevës	11
1.4. Raporti Përfundimtar	12
2.0 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	13
2.1 Direktiva VSM e BE-së	13
2.2 Direktiva të tjera të BE-së	13
2.3. Strategjia 2020 e BE-së.....	14
2.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB	14
2.5 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollit i Kievit.....	15
2.6 Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse	16
3.0 PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM	19
3.1. Metodologjia	19
3.2. Literatura dhe Burime të Shkruara Informimi për VSM.....	19
3.3. Takime dhe Biseda me Përfaqësues të Institucioneve	20
3.4. Struktura e Raportit të VSM-së.....	21
4.0 HARTA ZONALE KOMUNALE (INFORMATAT E RËNDËSISHME PËR VSM)	22
4.1. Nevoja për Hartën Zonale Komunale.....	22
4.2 LISTA EZONAVE	24
4.3. KUSHTET TJERA MJEDISORE TE KOMUNES SË PODUJEVËS	27
5.0 KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME	36
5.1. Shfrytëzimet e tokës	36
5.2. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore.....	38
5.3 Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës.....	40
5.3. Zona aktive	43

6.0 Zona ekonomike – industriale dhe komerciale.....	50
6.1 Sipërfaqet për industri sipas projeksioneve të HZK-së	51
6.2 Kushtet zhvillimore	51
6.3 Zonat turistike	54
7.0 Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit.....	59
7.1 Sipërfaqet minerare sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjisë nacionale.....	60
7.2 Kushtet zhvillimore	61
8.0 Zonat e rrjetit të transportit	63
8.1 Zona e rrjetit të transportit rrugor	63
8.2 Transporti hekurudhor.....	64
8.3 Zona e rrjetit të transportit publik dhe transportit jo të motorizuar.....	65
8.4 Zonat e shërbimeve publike- Infrastruktura teknike	66
8.6 Kushtet zhvillimore	70
9.0 - SWOT ANALIZA	75
9.1 Sfidat e identifikuara	75
9.2 Vizioni për komunën e Podujevës.....	76
9.3 Strategjia e Zonimit komunal	76
9.4 Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor	77
9.5 Mjedis i pastër dhe atraktiv	82
10.0 PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS.....	83
11.0 PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL	84
11.1 Objektiva Strategjike	84
11.2 Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike	86
11.3 Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal	86
11.4 Efektet kumulative	89
12.0 NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE.....	91
12.1 Harta Zonal Komunale e Podujevës dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit	91
12.2 Konsiderata Mjedisore në Hartimin dhe Përpunimin e Hartës.....	91
12.3 Masat e Nevojshme në HZK-ë për Mbrojtjen e Mjedisit	99
13.0 MONITORIMI.....	111
14.0 PËRFUNDIM	116
15.0 LITERATURA	119

Lista e Tabelave

Tabela 1. Tërësitë dhe nën-tërësitë hapësinore.....	23
Tabela 2. Lista e zonave.....	24
Tabela 3. Madhësia e parcelës	26
Tabela 4. Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas kateve hipsometrike	30
Tabela 5. Lloji i tokave dhe sipërfaqet	30
Tabela 6. Sipërfaqet e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit.....	31
Tabela 7. Temperaturat sipas muajve	32
Tabela 8. Lista e trashëgimisë kulturore sipas HZK dhe listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e vitit 2017.....	39
Tabela 9. Vlerat natyrore.....	41
Tabela 10. Dimensionet e parcelës, ndërtesave, etazhiteti dhe intensiteti i zhvillimit.....	48
Tabela 11. Kategoria e tokës	49
Tabela 12. Dimensionet e ndërtesave industriale poashtu varen nga lloji i industrisë dhe madhësia e veprimtarisë	52
Tabela 13. Ngjyrat Pastele shifra RGB	53
Tabela 14. Dimensionet e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit	55
Tabela 15. Vlerat kufitare të burimit të zhurmës (dBA) nga trafiku rrugorë dhe hekurudhor	57
Tabela 16. Vend parkimet	59
Tabela 17. Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë dhe Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive.....	63
Tabela 18. Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës (burimi: Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2017-2022 dhe azhurnuar nga të dhënat e fundit)	69
Tabela 19. Madhësitë e parcelës për objektet e shërbimeve publike-infrastrukturës teknike.....	70
Tabela 20. Objektivat e PZHK-së të për të cilat HZK ka parapr kushte zhvillimore për zbatim.....	83
Tabela 21. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentet mjedisore.....	90
Tabela 22. Objektivat me veprime për zbatim të HZK	92
Tabela 23. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas HZK-së.....	101
Tabela 24. Receptorët Mjedisor	112

Lista e figurave

Figure 1. Harta Gjeologjike e komunës së Podujevës	28
Figure 2. Hipsometria e terrenit për komunën e Podujevës	29
Figure 3. Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës si dhe sipërfaqet ujore me zonat e mbrojtura ujore	43
Figure 4. Ndarja në njësi urbane e Komunës së Podujevës	46
Figure 5. Harta e zonave bujqësore.....	50
Figure 6. Harta Zona ekonomike – industriale/komerciale.....	54
Figure 7. Harta Zonat turistike.....	59
Figure 8. Harta Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit	62
Figure 9. Harta Zona e rrjetit të transportit.....	66
Figure 10. Harta Zonat e shërbimit publik-infrastruktura teknike	74

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
HEC	Hidrocentralet
HZK	Harta Zonale Komunale
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
MAPL	Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
PRrH	Plani Rregullues i Hollësishëm
PRrU	Plani Rregullues Urban
PTK	Posta dhe Telekom i Kosovës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1.0 Hyrje

Me qëllimi të sigurimit të shkallës së lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut është obligim të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor i cili është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik e në rastin tonë ky vlerësimin strategjik mjedisor është bërë për Hartën Zonale Komunale.

Vlerësimi strategjik mjedisor është një obligim ligjor por edhe funksional në të cilin do të analizohen ndikimet në mjedis në fushën e shfrytëzimit të tokës, bujqësisë, pylltarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit e mbeturinave, menaxhimit e ujërave, telekomunikacionit, turizmit dhe fushave tjera.

Në këtë formë do të krijohet një kornizë për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen si dhe ndikimin në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën etj.

Në këtë raport do të identifikohen dhe analizohen ndikimet pozitive dhe negative të mundshme gjatë zbatimit të Hartes Zonale Komunale të Podujevës (2019-2027), si dhe do të propozohen masat të cilat duhet marrë për zvogëlimin e ndikimit negativ të mundshme që ndodhin gjatë zbatimit të planit zhvillimor komunal, me qëllim të përmirësimit të jetesë dhe shëndetit të qytetarëve, si dhe të mbrojmë florën dhe faunën, ekosistemet, cilësinë e ajrit, ujit dhe mjedisit në komunën e Podujevës.

Termet e përdorura në këtë dokument kanë këto kuptime:

“Sistemi i integruar për mbrojtjen e mjedisit” është sistem i mbrojtjes së mjedisit kur autoritetet publike bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

“Mjedi” është rrethina natyrore: ajri, toka, uji, klima, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgimia kulturore si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

“Ndotja e mjedisit” është ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut.

“Dëmtim i mjedisit” është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, zvogëlimi i llojlojshmërisë biologjike dhe peizazhore, të ekosistemeve natyrore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës prej veprimtarive të njeriut ose fatkeqësive natyrore.

“Degradim i mjedisit” është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit i shkaktuar nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut.

“Rrezik” është potenciali i ndonjë aktiviteti, qoftë i drejtpërdrejt ose i tërthortë, që mund të shkaktojë ndotje për mjedisin, jetën, shëndetin e njeriut dhe të mirat materiale.

“Aksident mjedisor” është ndodhia e papritur dhe e pakontrolluar përkatësisht disa ndodhi të cilat krijohen me lirim, derdhjen ose hedhjen e materieve të rrezikshme, prodhimin, qarkullimin, përdorimin, transportimin, përpunimin, magazinimin apo ruajtjen afatgjate në mënyrë jo adekuate.

“Pëlqim mjedisor” është autorizim me shkrim i nxjerrë nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin, ose aktin nënligjor me qëllim të marrjes së lejes për ndërtim.

“Leja e integruar mjedisore” është autorizimi me shkrim që lëshohet nga autoriteti kompetentë pajtim me ligjin që kërkohet për marrjen e lejes për operim.

“Autorizim mjedisor” është dokument zyrtarë i lëshuar me shkrim nga ministria, me të cilin i lejohet bartësit zhvillimi i aktivitetit apo zbatimi i projektit vetëm një here, në pajtim me kushtet e përcaktuara në të.

“Leje mjedisore” është dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria me këtë ligj, e kërkuar me qëllim që

të merret leja e punës.

“Leje mjedisore komunale” është dokument me shkrim që e lëshon komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas ligjit.

“Indikator/tregues” Një informatë, në përgjithësi sasiore, e cila përdoret për të matur dhe përcjellë gjendjen aktuale dhe progresin e një sistemi kompleks. Në kuadër të VSM-së, indikatorët shpesh përdoren për matjen e nivelit të suksesit të një plani ose projekti dhe për arritjen e objektivave.

“Ndikimet e tërthorta” Ndikimet që mund të përnxiten nga një projekt apo veprim strategjik, për shembull zhvillimi i cili bëhet rreth udhëkryqeve të autostradës pasi të jetë ndërtuar ajo. Po ashtu quhen ndikime të gjeneruara apo të përnxitura.

“Masat për zbutje” Masat që i shmangin, zvogëlojnë, përmirësojnë dhe kompensojnë ndikimet e mëdha të dëmshme të ndonjë veprimi strategjik në mjedis.

“OJQ” Organizatë jo-qeveritare (p.sh. shoqatat qytetare, unioni i bujqve) të themeluara në mënyrë ligjore nga subjektet fizike ose juridike që funksionojnë të pavarur nga cilado qeveri.

“Objektivi” Synimi i veprimit strategjik ose VSM-së, që e përkufizon atë që mundohet të arrijë, drejtimi i dëshiruar i ndryshimit ose përmirësimit të trendëve aktual.

“Plani” Procedura e formalizuar, që i përcakton objektivat e bashkërenduar dhe të matur në kohë për zbatimin e një politike.

“PM10” Grimcat e imëta që kalojnë nëpër grykën me madhësi të paracaktuar siç përkufizohet në metodën referente për mostrat dhe matjen e PM10, EN 12341, me ndalim efikas prej 50 % në diametrin aerodinamik prej 10 µm. Disa grimca paraqiten natyrshëm, që burojnë nga vullkanet, stuhitë e pluhurit, pyjet dhe zjarret e fushave me bar dhe nga burimet tjera. Veprimtaritë njerëzore, si djegia a karburanteve nga fosilet në automjete, termocentralet dhe veprimtaritë e ndryshme industriale, po ashtu prodhojnë nivele të ngritura të grimcave të imëta në ajër të cilat lidhen me dëmtimet e shëndetit si sëmundjet e zembrës, dëmtimi i funksionimit të mushkërive dhe kanceri i mushkërive.

“Shkoqitja” Procesi i vendosjes së përmbajtjes dhe nivelit të hollësive në VSM (llojet e efekteve në mjedis, alternativat që duhen shqyrtuar) dhe si duhet të kryhet VSM-ja (afati kohor, metodologjia, struktura e raportit, etj). Ky proces duhet të kryhet herët, mundësisht në konsultim me autoritetin kompetent dhe grupet e prekura.

“Raporti i VSM” Raporti i kërkuar nga Ligji për VSM-në si pjesë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili i identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet e rëndësishme të mundshme në mjedis nga realizimi i një plani ose programi. Ky dokument duhet ta regjistrojë procesin dhe konkluzionet e procesit të VSM-së. Po ashtu quhet edhe raport mjedisor.

“Aktor” Dikush që ndikohet nga veprimet strategjike ata që kanë interes ose edhe ndikim në to.

“Veprim strategjik” A Vendimi që është "përmbi" nivelin e projektit: politika, plani ose programi.

“Direktiva për VSM-në” Direktiva Evropiane 2001/42/EC (për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis).

“Vlerësimi i qëndrueshmërisë” VSM-ja që i shqyrton çështjet ekonomike dhe shoqërore si dhe mjedisore.

“Çrregullim mjedisor” ka të bëjë me ndotjen e mjedisit kur materiet ndotëse i tejkalojnë normat e përcaktuara me ligj.

“Emision” konsiderohet shkarkimi i materieve ndotëse, i energjisë dhe zhurmës nga burimet individuale dhe difuzive në mjedis.

“Informacion mjedisor” është çdo informatë e shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose ndonjë material tjetër në lidhje me gjendjen e përbërësve të mjedisit, masat, raportet, kost benenfit analizat si dhe gjendja e shëndetit të njeriut.

“Mbeturinë” është çdo substancë ose lëndë të cilën zotëruesi e hedh, mendon ta hedh ose është i detyruar ta hedh.

“Mbeturinë e rrezikshme” janë mbeturinat toksike, gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përfllakshme,

kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja negative për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe për ekosistemet natyrore.

“Materie të rrezikshme” janë kimikatet dhe materiet tjera të cilat kanë karakteristika të dëmshme dhe të rrezikshme.

“Ndotje” është shkarkim i materieve dhe kimikateve në formë të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë, si dhe vibrimet, rrezatimin, ngrohjen, dritën, zhurmën apo forma të tjera të energjisë në mjedis, që kanë potencial domethënës që t'i shkaktojë dëme shëndetit të njeriut, organizmave të gjallë apo ekosistemeve dhe mjedisit në tërësi.

“Ndotës” është personi juridik apo fizik i cili me veprimin apo mosveprimin e tij shkakton ndotjen e mjedisit.

“Ministria” është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

“Resurset natyrore” janë të gjithë përbërësit e natyrës që njeriu i shfrytëzon për qëllime ekonomike. Resurset natyrore mund të jenë: të papërsëritshme (lëndët minerale) dhe të përsëritshme (të mirat biologjike, uji, toka e përsëritshme).

“Vlerat e natyrës” janë pjesë të natyrës të cilat meritojnë mbrojtje të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose interesit shkencor, estetik, kulturor, historik, arsimor dhe ekonomik.

“Shfrytëzimi i qëndrueshëm” nënkupton shfrytëzimin e resurseve natyrore që sigurojnë plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto resurse.

“Zhvillimi i qëndrueshëm” është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t'i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t'i përmbushin nevojat e veta.

“Sanimi” është proces i ndërmarrjes së masave për ndalimin e ndotjes dhe degradimin e mëtutjeshëm të mjedisit deri në nivelin i cili është i sigurt për shfrytëzim të mëtutjeshëm të lokacionit, duke përfshirë, rregullimin e hapësirës, revitalizimin dhe rikultivimin.

“Riciklim” është përpunimi i mbeturinave në procesin parësorë apo për dedikim tjetër, duke përfshirë riciklimin biologjik pa shfrytëzim të energjisë.

“Fondi për mbrojtjen e mjedisit” do të thotë instrument ekonomik për stimulimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit. në Kosovë.

“Publiku” konsiderohet një ose më shumë persona juridik ose fizik, shoqatat e tyre, organizatat apo grupimet.

“Publiku i interesuar” publiku i prekur apo që ka të ngjarë për t'u prekur, ose i cili ka interes, në procedurat vendimmarrëse mjedisore të cilat referohen në këtë ligj. Për qëllim të këtij përkufizimi, organizatat jo-qeveritare të cilat promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe që përmbushin kërkesat e parashtruara sipas ligjit vendor do të konsiderohen si organizata që kanë interes

“Burimet e lëvizshme të ndotjes” janë mjete me motor me djegie të brendshme që lëvizin dhe shkaktojnë ndotje në mjedis.

“Statusi i mjedisit të rrezikuar” është gjendje mjedisore kur tejkalohet shkalla e ndotjes e përcaktuar në bazë të matjeve, hulumtimeve dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes, në raport me normat e lejuara.

“Instrumentet ekonomike” janë instrumente, të cilat kanë për qëllim të ndikojnë në ndryshimin e sjelljes së subjekteve ekonomike, nëpërmes llogaritjes të shpenzimeve mjedisore për shfrytëzimin e resurseve natyrore.

“Cilësia e mjedisit” konsiderohet përqendrimi i materieve ndotëse në mjedis.

“Kadastru i ndotësve” është grup i të dhënave për burimet e ndotjes, llojin sasinë, mënyrën dhe vendin e shkarkimit, rrjedhjen apo vendosjen e materieve të dëmshme në mjedis, për stabilimentet dhe pajisjet për mbrojtjen e mjedisit si dhe proceset të cilat përdoren për mbrojtjen e mjedisit, të cilat të dhëna mbledhen për periudhën e vitit kalendarik.

“Projekti” - ekzekutimi i punëve ndërtimore, të instalimeve ose skemave të tjera, largimin ose çmontimin e instalimeve ose skemave, intervenimet e tjera në rrethinën e natyrës dhe në peizazh përfshirë

nxjerrjen e resurseve minerale dhe atyre që kërkojnë punë rehabilitimi.

“Aplikuesi” personi fizik ose juridik, vendor apo i huaj, i cili është bartës i kërkesës për marrjen e Pëlqimit mjedisor për realizimin e një projekti.

“Pëlqimi mjedisor” vendimi me shkrim i nxjerrë nga Ministria në pajtim me ligj, si parakusht për fillimin e realizimit të projektit.

“Ministri” Ministri kompetent për çështjet e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

“Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis” (në tekstin e mëtejshëm: VNM) - identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të projektit në mjedis, konsultimin e autoriteteve mjedisore dhe të publikut, duke marrë parasysh raportin e VNM dhe rezultatet e konsultimeve në vendimmarrje, përcaktimin e metodës për parandalimin, shmangien, zbutjen ose rehabilitimin e ndikimeve të dëmshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe dhënien e informatave mbi vendimin.

“Raporti i VNM” rezultati i një vlerësimi të ndikimit në mjedis.

“Përzgjedhja” procesi, gjatë të cilit përcaktohet nëse do të jetë i nevojshëm ose jo një VNM për projekte të caktuara.

“Vendimi i Përzgjedhjes” vendimi se a është i nevojshëm ose jo VNM për një projekt të veçantë.

“Studimi” procesi i identifikimit të informatave minimale që kërkohen për një raport të VNM-së mbi ndikimet e mundshme mjedisore të një projekti të propozuar bazuar në informatat për projektin, si dhe në lokacionin dhe rrethinën e tij.

“Njoftimi i Studimit” një deklaratë me shkrim e lëshuar nga ana e Ministrisë, e cila përmban një mendim mbi informatat lidhur me ndikimet e pritura që duhet të parashtrohen në një Raport të VNM-së.

“Përmbledhja jo-teknike” dokumenti i shkurtër, i ndarë nga dokumentet tjera, që paraqet rezultatet e rëndësishme të raportit të VNM, të shprehura në një format më të thjeshtë dhe më të kuptueshëm për debate publike.

“Ditë” ditë pune.

“Informim Lokal” publikimi i një njoftimi në një gazetë e cila qarkullon në lokalitetin në të cilin do të realizohet projekti i propozuar, në ueb faqe të komunës ku do të realizohet projekti i propozuar dhe në ueb faqen e Ministrisë.

“Planet dhe programet” planet dhe programet, duke përfshirë edhe ato të bashkë financuara nga Bashkimi Evropian ose nga institucionet tjera ndërkombëtare si edhe ndonjë modifikim të tyre, të cilat janë subjekt i përgatitjes ose miratimit (ose që të dyjave), nga ndonjë autoritet në nivel qendror, rajonal apo lokal, ose që janë përgatitur nga ndonjë autoritet për miratim përmes një procedure legislative, rregullatore dhe administrative nga ana e Parlamentit ose Qeverisë;

“Vlerësimi Strategjik Mjedisor” (VSM) - është proces i vlerësimit të ndikimeve të mundshme në mjedis të një politike, plani ose programi. përgatitja e një raporti të VSM, mbajtjen e konsultimeve, marrjen parasysh të këtij raporti dhe të rezultateve të konsultimeve në vendimmarrje si dhe ofrimin e informacioneve lidhur me vendimin në pajtim me ligjin;

“Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor” (Raporti VSM) - një pjesë të dokumentacionit të planit ose programit i cili përmban informacionet e kërkuara me këtë ligj;

“Komisioni” trupi i propozuar nga ministri dhe të miratuar nga Qeveria, në rastet kur vet Ministria është autoritet përgjegjës i planit ose programit;

“Trupat konsultativ” Ministrinë, ose në rastet kur Ministria është vet autoritet përgjegjës, atëherë Komisionin; dhe cilindo trup tjetër të përcaktuar me ligj i cili ka përgjegjësi specifike për mjedisin dhe për të cilin Ministria konsideron se mund të shqetësohet për planin ose programin e propozuar;

1.1 Të Dhëna Historike

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prishtinës në jug, në gjatësi të vogël me Obiliqin, Vushtrrinë, Mitrovicën dhe Leposaviqin në perëndim. E tërë pjesa veriore dhe lindore kufizohet me Republikën e Serbisë. Gjatësia totale e vijës kufitare është 175,2 km. Kufiri i komunës kalon nëpër terrene malore, afër vijave ujëndarëse apo nëpër to, dhe në pjesë të ulëta nëpër disa qafa malore, ose në luginë duke i prerë tërthorazi. Me Prishtinën gjatësia e kufirit është 37,39 km i cili kalon nëpër terrene kodrinore-malore dhe kah perëndimi lëshohet në luginën e lumit Llap te Lupçi i Poshtëm. Nga kjo pikë kufiri merr drejtim verior dhe kufizohet në distancë 2,8 km me komunën e Obiliqit. Kah veriu vazhdon kufizimi me komunën e Vushtrrisë duke u ngritur maleve të Kopaonikut me gjatësi 18,9 km. Me Mitrovicën gjatësia është 17,52 km, me Leposaviqin gjatësia është 7,7 km duke u rritur lartësia mbidetare. Me Republikën e Serbisë gjatësia është 90,9 km. Lartësia mbidetare e kufirit në pjesën perëndimore është mjaft e lartë ngase shtrihen në pjesën jugore të maleve të Kopaonikut. Në kufizim me komunën e Leposaviqit në majën Shatorica lartësia mbidetare është 1770 m. Pika më e ulët e kufirit është në pjesën jugore në fshatin Lupç i Poshtëm në luginën e lumit Llap me rreth 550 m.

Duke u bazuar në burime të shumta historike, treva e Llapit është herët e banuar për shkak të kushteve të volitshme natyrore. Komuna e Podujevës ka shënuar rritje të konsiderueshme të popullsisë që nga viti 1948 kur kishte 43783 banor. Sipas regjistrimit të fundit në vitin 2011, popullsia e komunës së Podujevës ka rreth 87,289 banorë¹.

Vendbanimet e komunës së Podujevës janë formuar në mënyrë spontane, pa ndonjë rregull të planifikimit hapësinor apo urban. Madje, edhe pjesa më e madhe e vet qytetit të Podujevës është zhvilluar në mënyrë spontane, ndërsa vetëm një pjesë e qytetit është zhvilluar në bazë të planeve rregullative. Forma e parregullt e vendbanimeve është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-ekonomik dhe historik.

Për shkak të kërkesave të reja për njësi banimi në territorin e komunës së Podujevës ka ndodhur edhe një tjetërsim intensiv në përdorimin e tokës, duke konvertuar në truall ndërtimi sipërfaqe të gjera dikur me përdorim bujqësor në periferi të disa vendbanimeve, dhe duke rritur intensitetin dhe koeficientin e ndërtimit.

Në pjesën më të madhe, mënyra e akomodimit të popullsisë ka qenë e paplanifikuar, dhe e përqendruar sidomos në zonat periferike të vendbanimeve dhe në zonat afër rrugëve. Kjo gjë ka vënë nën presion edhe infrastrukturën dhe shërbimet ekzistuese, të cilat nuk kanë arritur t'u përgjigjen kërkesave në rritje si pasojë e këtij zhvillimi. Orientimi i zhvillimit të Podujevës për të siguruar shërbime efektive (dhe funksionale) dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së aspekteve mjedisore të komunës ka qenë i tillë që as nuk i është afruar niveleve të planifikuara apo të kërkuara. Sigurisht, zhvillimet ekzistuese për Podujevën, janë të pamjaftueshme dhe jorealiste për t'u përgjigjur nevojave hapësinore dhe kërkesave të zhvillimit të Podujevës 20 viteve të fundit.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për situatën, dhe duke njohur nevojën për orientim të zhvillimit në Podujevë, Komuna e Podujevës vendosi të zhvillojë Planin Zhvillimor Komunal.

Procesi dhe qëllimet e zhvillimit të planit nga detyra projektuese përmbledhen si më poshtë:

- Të japë një profil të gjendjes së tanishme për të patur një analizë të faktorëve me ndikim në zhvillimin e komunës së Podujevës, si tani edhe në të ardhmen;
- Të bëjë një analizë të profilit të siguruar duke identifikuar tendencat dhe faktorët e zhvillimit që do të kenë një ndikim kyç në zhvillimin dhe planifikimin e komunës në 8+ vitet në vijim;
- Të identifikojë perspektivat e zhvillimit të komunës në një vizion, parime dhe prioritet strategjike për komunën e Podujevës.
- Të bëjë shtrirjen hapësinore të zhvillimeve në kornizën e zhvillimit hapësinor

¹ Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 - Komuna e Podujevës, të dhëna nga publikimi i fundit i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Një kërkesë ligjore për planin zhvillimor komunal është vlerësimi i ndikimeve potenciale nga zbatimi i këtij plani në mjedis. Ky Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) ka për qëllim t'i sigurojë komunës së Podujevës një seri rregullash dhe kriteresh mjedisore të nevojshme për t'u zbatuar, të përmbledhura këto në një raport VSM-je që do të kalojë nga konsultimi i publikut, dhe më tej nga miratimi përfundimtar eventual nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH)

1.2. Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim nga ana njerëzore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të "parandalimit" sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM).

Procesi i VSM-se është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.

1.3. Objektivat e VSM për Harten Zonale të komunës së Podujevës

Objektivi kryesor i VSM-së është orientimi i Hartës Zonale Komonale të Podujevës për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij. Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të HZK-së, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre. VSM analizon disa skenarë. Skenari "0", pra "të mos bërit asgjë" në Podujevë do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm. Në vend të kësaj, VSM-ja synon të orientojë planin për realizimin e objektivave të tij në një mënyrë të qëndrueshme.

Për Hartën Zonale Komonale të Podujevës, vlerësimi merret veçanërisht me ndikimin mjedisor që mund të ketë zbatimi i hartës. Siç u tha në paragrafin më sipër, skenari "0" nuk është zgjidhja e duhur, pasi gjendja aktuale mjedisore në Podujevë është ekstremisht e dobët po t'i referohemi standardeve evropiane, dhe do të përkeqësohet edhe më shumë nëse vazhdon rritja e paplanifikuar.

Veçanërisht për HZK-në, ky vlerësim shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të:

- mjedisit komunal në tërësi – përdorimit të tokës, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, hot-spotëve potenciale të ndotjes, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore;
- mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar – monumentet e godinat arkeologjike, kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat peizazhistike, qendrat historike;
- veprimtarive ekonomike dhe shoqërore – të tilla si tregtia, industria, shëndeti dhe arsimit, si dhe ndikimi që këto kanë mbi mjedisin.
- infrastrukturës dhe sigurimit të shërbimeve – sigurimi (burimor) i ujit, energjisë dhe telekomunikacioneve; menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme; qarkullimi dhe lëvizshmëria në rrugë dhe transport; lëvizshmëria alternative;

1.4. Raporti Përfundimtar

Raporti Përfundimtar do të jetë rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës së Podujevës, si edhe debateve me publikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet që dalin gjatë procesit, do u jepet përgjigje dhe do integrohen nëse gjykohen të drejta, dhe në fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Komuna e Podujevës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ky kapitull i parë jep sfondin dhe të dhënat historike, si dhe shpjegon nevojën për një VSM, duke detajuar edhe objektivat e VSM-së. Kapitulli i dytë mbulon paraqitjen e kuadrit ligjor dhe institucional mbi të cilin bazohet procesi i zhvillimit të raportit të VSM-së. Kapitulli i tretë trajton procesin dhe metodologjinë e VSM si edhe jep burimet e shkruara apo takimet e kryera ku autorët janë bazuar në kuadër të përgatitjes së projekt-raportit përfundimtar të VSM-së.

Kapitulli i katërt bën një përmbledhje të qëllimit dhe komponentëve të Hartës Zonale Komunale të Podujevës (HZK-së) dhe të mënyrës së integritit të tij me planet e tjera, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore. Shpjegohet nevoja për hartën, objektivat dhe shtrirja e saj, përpunimi dhe zbatimi i HZK-së, shkalla në të cilën HZK-ja ndikon në planet e tjera.

Në kapitullin e pestë jepet një shqyrtim i gjendjes mjedisore ekzistuese në komunën e Podujevës përfshi paraqitjen e problematikave kryesore në cilësinë mjedisore të ujit, ajrit, biodiversitetit dhe tokës, nivelit të zhurmave dhe shëndetit publik.

Kapitulli i gjashtë përmban analizën mjedisore të alternativave, e cila ballafaqon alternativën "0" (mos bëj asgjë), duke e ballafaquar me alternativën e zhvillimit sipas modelit të zgjerimit të planit të qendrës, dhe me alternativën sipas HZK-së.

Në kapitullin e shtatë jepen parimet kryesore mjedisore dhe shqyrtohen objektivat strategjike të zhvillimit urban. Jepen disa veprime konkrete që mund të realizohen në mbështetje të objektivave strategjike. Gjithashtu paraqiten në mënyrë të detajuar edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal, kriteret të ndara në katër kategori bazë.

Kapitulli i tetë paraqet ndikimet e mundshme mjedisore nga HZK-ja si edhe masat zbutëse të propozuara. Vlerësohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alternativat e zhvillimeve të HZK-së, me objektivat që të përmirësohet cilësia e jetës së banorëve të Podujevës që banojnë aktualisht dhe që do të akomodohen në të ardhmen. Në përgjithësi masat zbutëse do të synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Hartën Zonale të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Kapitulli i nëntë trajton aspektet e monitorimit afatgjatë për verifikimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Do të monitorohen treguesit e objektivave të mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Raporti paraqet përfundimet me një përmbledhje të shkurtër dhe sugjeron disa prej veprimeve kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit të HZK-së dhe detajimit të punës gjatë hartimit të Planeve urbane dhe rregulluese.

2.0 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1 Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlament i Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & venditose shfrytëzime të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejn një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmbledhet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merrën parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

2.2 Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit

duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

2.3. Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha² është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetete strategjike janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të rritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

2.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t'isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit³. Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

³http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programete vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëte sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

2.5 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

2.5.1 Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasjen...1998) Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartoj në dis pozitave e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat iposedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave jo qeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;

- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisorenë për gjithësi.

2.5.2 Konventa ESPOO

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi..... Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenën dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

2.5.3 Protokollin e Kievit

Është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë dotë mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokollin është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën ESPOO, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi i Strategjikut Mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin qëndrueshëm. Protokollin poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokollin kërkon që vlerësimistrategjikmjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillimi rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

1.6 Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

1.6.1 Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;

- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. HZK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton kushtet zhvillimore dhe masat për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 4 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet te përfshijnë zhvillimin e qendrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmonime politikën dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

1.6.2 Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e Planeve dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi për katë s' duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet e tij. Raport i VSM-së identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i Planit ose Programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në Ligj në mënyrë që t'iu ofrojnë qasje në dokumente të VSM-së organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM-së është një dokument për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa të posaçme për raste të këshillimeve ndërkuftare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Po ashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit

përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve të VSM-së.

1.6.3 Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislacionit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapsinore të Kosovës 2010-2020+, Strategjin për Mjedisin dhe Planie Veprimit në Mjedis, si dhe disa Plane, Programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

3.0 PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM

3.1. Metodologjia

Kryerja e VSM për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor.

Qëllimi i raportit të VSM-së për Hartën Zonale Komunale të Podujevës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Hartës Zonale Komunale, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi i Hartës Zonale Komunale të propozuar.

Metodologjia për hartimin e raportit të VSM është në përputhje me ligjin për VSM Nr. 03/L-230, i cili është transpozim i direktivës së BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis”.

Mbështetur në sa më sipër raporti i VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- a) një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- b) përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore të Hartës Zonale Komunale dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- c) përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet plani ;
- d) përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka mundësi të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- e) përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me hartën;
- f) përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektivat janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- g) përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- h) Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i hartës.
- i) një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- j) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

Hartës Zonale Komunale për numrin e madh dhe diversitetin e gjerë të problematikes që trajton, kërkon konsultimin e një game të konsiderueshme dokumentacioni. Behet fjale për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë të ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përveç materialeve që dispononte vete Grupi hartues i VSM-s, u siguroi nga komuna e Podujevës, institucioneve të tjera publike dhe kërkimet në internet. Më poshtë po rendisim disa nga dokumentet kryesore që u përdoren në trajtimin e aspekteve të ndryshme mjedisore për komunën e Podujevës dhe më gjerë.

3.2. Literatura dhe Burime të Shkruara Informimi për VSM

Materiali që përben Detyrën e Projektimit, sqaruar në dokument si Harta Zonale Komunale i hartuar nga grupet punuese, trajton në mënyrë serioze problemet mjedisore të komunës së Podujevës.

Ky dokument ndër të tjera përmban informacion lidhur me shtrirjen gjeografike, gjeologjinë, sizmiken, hidrologjinë, hidrografinë, mbetjet e natyrave të ndryshme, cilësinë e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, ekonominë, infrastrukturën, transportin, urbanistikën, informacion mbi sektorët socio-ekonomik. Në përgjithësi materiali është i kompletuar, në veçanti në trajtimin e problemeve mjedisore me të cilat përballlet komuna. Ai përmban të dhëna analitike mbi mjedisin fizik, mbetjet, cilësinë e ajrit dhe të

ujërave sipërfaqësore, etj.

Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në mjedis kanë përcaktuar vizionin për mjedisin i cili përkufizohet si: zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur pasuritë natyrore nga ndotja dhe dëmtimi dhe promovimi i vlerave mjedisore.

Për realizimin e këtyre perspektivave, investimet për mbrojtjen e mjedisit me qëllim që standardet e Bashkimit Europian të mund të arrihen brenda viteve të ardhshëm do të fokusohen në fushat e mëposhtme:

- Trajtimi i ujërave të ndotura;
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve sipas standardeve të BE;
- Mbyllja në zonat e ndryshme e vend-depozitimeve ekzistuese;
- Rehabilitimi i tokave të ndotura dhe burimeve të ndotjes;
- Përmirësime teknologjike në objektet industriale

Drejtimet e mësipërme për rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit, janë probleme prioritare për komunën e Podujevës.

Hartës Zonale Komunale e Podujevës paraqet një plan të hapësirës së Podujevës dhe propozon zhvillime të përdorimit të tokës e të infrastrukturës deri në vitin 2027+. Ajo nënvizon gjithashtu edhe nevojën për të adresuar boshllëqet financiare, njerëzore e të burimeve institucionale për një ekzekutim efektiv të planifikimit.

Mbi bazën e programit të Qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, ajo përcakton edhe qëllimet të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

- Përmirësimi i standardeve të kërkuara (BE, Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbetjet urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;
- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;
- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe;
- Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve.

Pothuajse të gjitha këto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë probleme me të cilat ndeshet edhe komuna e Podujevës. Zbutja dhe zgjidhja e tyre përben një kontribut madhor në realizimin e këtij Plani.

Për një vlerësim sa më real të situatës mjedisore në komunën e Podujevës dhe luhajtjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës të nxjerra nga Detyra e Projektimit (Hartës Zonale Komunale), informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit në lumenjtë e komunës së Podujevës, zhurmave, menaxhimit të mbetjeve, etj, u gjeten në Raportet Hartës Zonale Komunale dhe dokumente tjera të nivelit qendrorë, përgatitur institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

3.3. Takime dhe Biseda me Përfaqësues të Institucioneve

Autoret e raportit të VSM-së kanë pasur fatin të jenë përfshirë në shumë takime dhe mbledhje me

përfaqësues, me institucione të ndryshme në kuadër të hartimit të HZK-së.

Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve profesionale të qeverisjes komunale dhe qendrore, si edhe botës akademike dhe ekspertë të pavarur kanë zhvilluar një dyzinë mbledhjesh për të përcaktuar ecurinë e HZK-së qysh nga fillimi deri tek debatet mbi zgjidhjet hapësinore apo infrastrukturore. Shënimet e këtyre mbledhjeve janë bërë pjesë e shqyrtimit nga autorët në kuadër të përgatitjes së raportit të VSM-së.

Në mënyrë të ngjashme, Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve të qeverisjes komunale dhe qendrore, me përfaqësues edhe të shoqërisë civile dhe sektorit privat gjatë disa takimeve kanë debatuar për vizionin e zhvillimit të komunës në nivel me të gjerë. Edhe shënimet e këtyre takimeve janë shqyrtuar nga autorët e raportit të VSM - së.

Nga procesverbalet e mbledhjeve dhe takimet me anëtar të Grupeve punuese të komunës së Podujevës, si edhe me drejtorinë e planifikimit urban dhe mbrojtje të mjedisit pranë kësaj komune, janë marre informacione dhe të dhëna të ndryshme që lidhen me shtrirjen e komunës (gjeografia), projeksione të popullsisë në zona të ndryshme të komunës, zonimin, peizazhin, infrastrukturën rrugore, zonat rekreative, zonat e ndotura, menaxhimin e mbetjeve, infrastruktura e ujit të pijshëm, ujërave të zeza dhe të bardha, zonat e parkimit. Këto informacione dhe takime kanë ndihmuar grupin e hartimit të VSM-së, të fokusohet më mirë në zona ekzistuese të Komunës dhe sipërfaqe që mendohet t'i shtohen, ku parashikohen zhvillime të caktuara.

Gjithashtu takime janë realizuar me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me problematiken mjedisore në komunën e Podujevës, zonat e ndotura mjedisore (hot spote) dhe zonat me rëndësi ekologjike. Këto takime kanë ndihmuar autorët veçanërisht në hartimin e kritereve kufizuese mjedisore.

3.4. Struktura e Raportit të VSM-së

Kapitujt e mësipërm paraqiten sfondin, të dhënat historike, nevojën për VSM, përfshi kuadrin ligjor dhe institucional mbi të cilin bazohet procesi i zhvillimit të raportit të VSM-së. U paraqit gjithashtu procesi dhe metodologjia për VSM si edhe burimet e shkruara apo takimet e kryera ku autorët janë bazuar në kuadër të përgatitjes së draft raportit përfundimtar të VSM-së.

Kapitulli i katërt paraqet nevojën dhe objektivat e HZK-së, si edhe marrëdhëniet e saj me planet dhe programet që kanë lidhje me të. Paraqitet një përmbledhje të qëllimit dhe komponentëve të HZK-së dhe të mënyrës së integritit të saj me planet e tjera të qytetit, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore.

Situata mjedisore në komunën e Podujevës paraqitet në kapitullin e pestë. Këtu pasqyrohet situata mjedisore, përfshirë infrastrukturën dhe aspekte socio-ekonomike, në komunën e Podujevës dhe rreth e saj.

Mbështetur në publikimet mbi gjendjen e mjedisit në komunën e Podujevës do të analizohen treguesit e cilësisë së mjedisit, fizik dhe biologjik (gjeologjia, hidrologjia, sizmika, përdorimi i tokës, biodiversiteti, cilësia e ajrit, e ujërave sipërfaqësore, ndotja e tokës, pikat e nxehta mjedisore, niveli i zhurmave, menaxhimi i mbetjeve në përgjithësi dhe atyre urbane në veçanti, sipërfaqet e gjelbra, etj). Mbi bazën e kësaj analize do të vlerësohet situata mjedisore aktuale dhe do të identifikohen zonat me problematike të qytetit si në aspektin e ndotjes ashtu dhe vlerave rekreative.

Kapitulli i gjashtë përmban analizën mjedisore të alternativave, e cila ballafaqon alternativën “zero” (mos bej asgjë), duke e ballafaquar me sipas HZK-së. Në këtë kapitull evidentohen përparësitë e zhvillimit të planifikuar në drejtim të krijimit të një komune me më shumë infrastrukturë dhe me më pakë zhurme e pluhur, me më shumë hapësira të gjelbra dhe me të pastër, e një komunë që rritet dhe zhvillohet me një cilësi jete më të mirë që orientohet nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në kapitullin e shtatë jepen parimet kryesore mjedisore dhe shqyrtohen objektivat strategjike të zhvillimit komunal. Në të jepen në mënyrë të detajuar edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal, kritere të ndara në katër kategori të rëndësishme.

Vendosja e objektivave për mbrojtjen e mjedisit është kërkesë e VSM Nr. 03/L-230 dhe Direktivës së 2001/42/EC të BE. Objektivat që synohet të arrihen, përcaktohen mbi bazën e situatës mjedisore të komunës së Podujevës, problemeve mjedisore të identifikuar dhe kërkesave që synon të realizojë HZK-ja.

Gjithashtu në këtë kapitull do të prezantohen edhe kriteret mjedisore që kufizojnë në një apo disa drejtime të zhvillimit zona të veçanta, me qëllim respektimin e standardeve shëndetësore e mjedisore si dhe ruajtjen e trashëgimisë.

Kapitulli i tetë paraqet ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat zbutëse të propozuara. Mbi bazën e informacionit mbi situatën aktuale mjedisore, ndikimet eventuale të HZK-së në shëndetin e njeriut dhe elementet e mjedisit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin komunal, në të propozohen masa për zbutjen e çdo ndikimi negativ në cilësinë e mjedisit nga zbatimi i HZK-së.

Do të vlerësohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alternativat e zhvillimeve të HZK-së, me objektiv që të përmirësohet cilësia e jetës së qytetarëve të komunës që banojnë aktualisht dhe që do të akomodohen në të ardhmen. Mbi bazën e vlerësimit analitik të cilësisë së elementeve të mjedisit si ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mbetjeve të ngurta, zhurmave, sipërfaqeve të gjelbra, në zonat e ndryshme të komunës, do të bëhen propozime për masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike, sipas karakteristikave dhe mundësive që lejohen për ndërhyrje për tu konsideruar nga ekipi i hartimit të HZK-së. Në përgjithësi masat zbutëse dhe kufizuese/ndaluese do të synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Harten Zonale Komunale të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Kapitulli i nëntë trajton aspektet e monitorimit afatgjatë për verifikimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Do të monitorohen treguesit e objektivave të mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Qëllimi i monitorimit të HZK-së, është identifikimi në kohë i efekteve të padëshiruara që mund të shfaqen në fazat e hershme të zbatimit të HZK-së, për të mundësuar masat e nevojshme për parandalim apo zbutjen të këtyre efekteve. Për këtë qëllim është hartuar një program monitorimi i cili do të ndjekë të gjitha zhvillimet në kuadrin e zbatimit të Hartës.

Raporti përfundon me një përmbledhje të shkurtër dhe disa sugjerime për veprime kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit të HZK-së.

4.0 HARTA ZONALE KOMUNALE (INFORMATAT E RËNDËSISHME PËR VSM)

4.1. Nevoja për Hartën Zonale Komunale

Komuna e Podujevës ka përjetuar një proces më të ngadalshëm të urbanizimit. Pas luftës në Kosovë rajoni por edhe komuna e Podujevës ka përjetuar migrimin të një pjese të popullatës nga zonat rurale dhe ato të thella malore drejt zonave periurbane dhe të vendbanimeve të mëdha të komunës.

Në vitet e para të pas luftës mungesa e PZhK-së dhe HZK është justifikuar me

- (I) Mungesën e kornizës ligjore,
- (II) Mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe financiare
- (III) Paqartësinë profesionale për natyrën e politikës për tu përballur me këtë fenomen, dhe
- (IV) Pa-aftësinë për ta kthyer çështjen e Planifikimit Zhvillimor Komunal dhe Urban në një prioritet për qeverinë komunale. Ndërsa viteve të fundit, dukshëm, çështja e planifikimit dhe zhvillimit komunal dhe urban ndërtoi interesa që u konsoliduan në sektorin e ndërtimit me ndikim të dukshëm në ekonomi, por që nuk ishin vazhdimisht në balancë me interesin publik. Kjo situatë justifikoi gjithmonë ndërhyrje të pjesshme në indin ndërtimor të vendbanimeve pa u kujdesur për një vizion të përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm

komunal në të gjithë vendbanimet e Podujevës.

Kjo gjë ka rezultuar me një përdorim të paefektshëm të tokës, që është i kushtueshëm për shërbimet dhe kërkonjë mobilitet të lartë. Në një pjesë të Podujevës, ngjeshja kaotike e vendbanimeve ushtron presion në shërbimet ekzistuese, shkakton kërcënim për trashëgiminë dhe zvogëlon zonat e gjelbra dhe të qarkullimit. Në tërësi, në vendbanimet ka ndodhur një degradim serioz mjedisor.

Në këtë mënyrë, Komuna e Podujevës vendosi të përgatisë dhe miratojë një hartë zonale komunale që do t'i përgjigjej më mirë situatës aktuale të përdorimit të tokës dhe do të akomodonte nevojat e komunës për planifikim dhe zhvillim por edhe do të plotësonte një aspekt legal që obligon komunat të përgatisin hartë zonale komunale.

Kategorizimi i vendbanimeve

Me qëllim të lehtësimit të përcaktimit të shfrytëzimeve të lejuara dhe kushteve zhvillimore për secilin vendbanim, në kuadër të secilës tërësi hapësinore janë identifikuar dhe krijuar tipologji të vendbanimeve të cilat janë të ngjashme për nga karakteri, dendësia e banimit, struktura e sipërfaqeve të ndërtuara, funksionaliteti, etj.

- **Tipi i parë (T1)**-përfshihen vendbanimet krejtësisht rurale me dendësi të ulët të banimit (jo më e madhe se 30b/ha) dhe/ose që janë të depopulluara, të karakterizuara me një intensitet shumë të ulët të zhvillimit, në të cilat mungojnë funksionet eksterne.

- **Tipi i dytë (T2)**-përfshijnë vendbanimet të cilat gjithashtu kanë karakter rural, dendësi prej 50-80 b/ha, në të cilat përveç objekteve të banimit, bujqësisë dhe ekonomisë së vogël zhvillohen edhe funksione tjera të cilat i shërbejnë popullsisë së vendbanimit.

- **Tipi i tretë (T3)** -përfshijnë ato vendbanime ku përveç objekteve të banimit, bujqësisë dhe ekonomisë së vogël zhvillohen edhe funksione tjera eksterne të cilat u shërbejnë popullsisë së vendbanimit por edhe atyre përreth.

- **Tipi i katërt (T4)** - përfshin vendbanimin urban-qendrën komunale të Podujevës në të cilën zhvillohen të gjitha funksionet shoqërore-ekonomike që shërbejnë gjithë territorin e komunës.

Tabela 1. Tërësitë dhe nën-tërësitë hapësinore

Nën-tërësitë	TËRËSITË HAPËSINORE			
	Malet dhe Peisazhet (MP)	Natyra dhe Turizmi (NT)	Aktive qendrore (AQ)	
			AQ- rurale	AQ- urbane
VENDBANIMET E TIPIT 1	T1-MP Brecë; Dumnicë e Epërme; Pakashticë e Epërme; Pakashticë e Poshtme; Lupç i Epërm; Dvorishtë; Majac; Murgull, Popovë, Repë, Përpellac; Potok; Reçicë, Tërnavicë; Sllatinë; Sylevicë, Zhiti	T1-NT Bllatë; Muhazob; Surdull, Brainë; Metergoc; Turuçicë, Kushevicë; Bërvenik, Barainë Kalaticë; Dy; Rakinicë	T1-AQ Kunushec; Radujevc; Halabak	
VENDBANIMET E TIPIT 2	T2-MP Dobërdol; Zakut; Bradash; Buricë; Dobratin; Llaushë;	T2-NT Shajkofc	T2-AQ Merdar; Miroc; Sallabajë; Siboc i Epërm; Siboc i Poshtëm; Bajçinë;	

	Metehi; Velikarekë	Revuq;		Shakovicë; Penuhë, Dumnicë e Dumosh; Gërdoc; Kaçybeg; Llapashticë e Llugë;	Balloç; Bellopojë; Poshtme; Shtedim; Godishnjak; Lladoc; Epërme;	
VENDBANIMET E TIPIT 3	T3-MP Pollatë Kërpimëh	T3-NT Batllavë, Herticë, Orlan	T3-AQ Letanc; Gllamnik; Surkish; Poshtme; Obrançë, Peran, Llužhan	Tërrnavë, Lupç i Poshtëm; Llapashticë e Livadicë;		
VENDBANIMET E TIPIT 4	/	/	/			T4-AQ Qyteti

4.2 LISTA EZONAVE

HZK-ja ka bërë ndarjen e territorit në zona/nënzona është bërë në përputhje me rekomandimet e PZHK-së, LPH-së dhe UA- ve respektive. Për çdo zonë janë përcaktuar Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, të veçanta, përkohshme, të ndaluara si dhe kushtet zhvillimore.

4.2.1 Lista e të gjitha zonave

Tabela 2. Lista e zonave

Zona	Nën-zonat		Simboli	Ngjyra
Pyjore			ZP	
Bujqësore	Bujqësi për konsum vetjak		Zb-Kv	
	Bujqësi për konsum komercial		Zb-Kk	
Banimit	Banim i përhershëm	Banim individual	ZB-In	
		Banim shumëbanesor	ZB-Sh	
	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri	Banim individual me afarizëm	ZB-la	
		Banim shumëbanesor me afarizëm	ZB-ShA	
	Banim tjetër	Vila banimi	ZB-P	
		Banim I përkohshëm-kamping		

Shfrytëzim i Përzier - Përgjithshëm		ZM		
Shërbimeve	Të komunitetit	Shërbim të administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale	ZSh-ApMs	
		Shërbimi arsimor	ZSh-A	
		Shërbim shëndetësor dhe shoqëror	ZSh-Sh	
		Shërbim fetar dhe shërbim tjetër komuniteti	ZSh-FSht	
	Kulturore, argëtuese, rekreative-	Shërbim kulturor	ZSh-K	
		Shërbim argëtues	ZSh-Ar	
		Infrastrukturë sportive	ZSh-Is	
		Hapësirë e hapur rekreative dhe shërbime tjera rekreative	ZSh-HrSht	
		Shërbime tjera rekreative	ZSh-tr	
		Infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza	ZSh-UK	
		Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike	ZSh-E	
		Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave	ZSh-Tm	
	Format tjera të infrastrukturës publike	ZSh-t		
Rrjetit të transportit	Rrjeti rrugor		ZkT-Rr	
	Rrjeti hekurudhor		ZkT-H	
	Urat		ZkT-U	
	Transporti publik		ZkT-Tp	
Ekonomike	Industriale dhe biznesit		ZI	
Turistike	Turizëm vikendor		ZT-V	
	Turizëm rehabilitues		ZT-R	
	Ekoturizëm		ZT-Et	
	Turizëm malor		ZT-M	
	Turizëm kulturor dhe sportiv		ZT-KS	
	Turizëm ndërkuftar		ZT-Nk	
Sipërfaqe Ujore dhe	Sipërfaqet ujore		SU	

zonat e mbrojtura sanitare	Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve	Zm-U	
Natyrore	Monumente me karakter botanik	ZN-B	
	Monumente me karakter hidrologjik	ZN-H	
Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore	Trashëgimia arkeologjike	Zm-a	
	Trashëgimia arkitekturore	Zm-A	
Sipërfaqet e interesit të përgjithshëm		Zlp	
Rezerva minerare dhe fushat e eksploatimit		ZmS	
Zona mbishtresore		ZMb	

Zona e Banimit

Zonë e banimit konsiderohet sipërfaqja e caktuar kryesisht për qëllime të banimit⁴. Sipas nomenklaturës së HILUCS, banimi përfshin këto nënkategori:

- Banim i përhershëm- përfshin hapësira banimi të dominuara nga ndërtesat e banimit individual (shtëpitë e veçanta të rrethuara me kopshte dhe/ose oborre, apo në kombinim të shtëpive të veçanta, shtëpi dyshe, shtëpi në varg, etj) dhe ndërtesat e banimit me shumë njësi.
- Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri- Kjo klasë përfshinë hapësira të caktuara për banim të kombinuar me funksione të tjera në pajtueshmëri (p.sh. shërbime të ndryshme, industri të lehta etj)
- Banim tjetër- Kjo klasë përfshinë hapësira të caktuara për banim të përkohshëm.

Banimi

Sipas shënimeve të marra nga regjistrimi i fundit i popullsisë, në komunën e Podujevës jetojnë 87,289 banorë, në territorin prej 633 km².

Pjesa dërmuese e popullsisë në komunën e Podujevës (64.5 % e popullsisë) jeton në fshat. Ndërsa 35.5 % e saj jeton në qytet, respektivisht në qendrën e vetme urbane të kësaj komune me qendër në Podujevë.

Tabela 3. Madhësia e parcelës

Kategoria e vendbanimit	Tipi i objektit	Madhësia e parcelës ndërtimore për objektbanimi		Fronti minimal i parcelës ndërtimore për objekt të banimit
		minimale	maksimale	
Banimi i përhershëm- i ulët				
Në të gjitha kategoritë e	Shtëpi të veçanta	4 ari	6 ari	15m'

⁴Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

vendbanimeve	Shtëpi dyshe	2.5 ari	4.5 ari	12m'
	Shtëpi në varg	1.5 ari	3 ari	6m'
Banimi i tjetër – banim i përkohshëm (shtëpi malore, vila banimi)				
Në vendbanimet ku lejohet ndërtimi i shtëpive malore, vilave të banimit	Vila	4 ari	5ari	10m'
	Shtëpi malore			
Banim me funksione tjera në përshtatshmëri				
Në vendbanimet e kategorisë 3	Shtëpi të veçanta	4 ari	6 ari	15m'
	Shtëpi dyshe	2.5 ari	4.5 ari	12m'
	Shtëpi në varg	1.5 ari	3 ari	6m'

4.3. KUSHTET TJERA MJEDISORE TE KOMUNES SË PODUJEVËS

4.3.1. Ndërtimi gjeologjik dhe mbërthimi tektonik

Komuna e Podujevës nga aspekti gjeologjik është e ndërtuar prej formacioneve të ndryshme. Marrin pjesë formacione të Paleozoikut, Triasiku, Jurasiku, Kretaku i Sipërm, Neogjenit, Pliocenit dhe sedimentet e Kuaternarit.

4.3.1.1. Karakteristikat litostratigrafike

Paleozoiku - Formacionet me të vjetra janë ato të rreshepeve sericite dhe filite të cilat ndërtojnë një brez në luginën e lumit Kaqanodoll, përkatësisht shtrihen në komunat kadastrave Lupç i Poshtëm, pjesën perëndimore të Majacit, Lupç i Epërm dhe pjesën perëndimore të Popovës. Në pjesën lindore paraqiten shkëmbinj të acid dhe të ndërmjetëm si janë: granitet, dacitet, riolitet etj. Këto formacione shtrihen kryesisht në vendbanimet Orllan Turuqicë, Muhazob etj.

Jurasiku - formacionet e Jurasikut shtrihen pothuajse paralel me ato të paleozoikut. Përbëhen nga formacioni diabaz stallor dhe nuk ka shtrije aq të madhe në këtë komunë. Kanë shtrirje gjatësore prej Bellopoje në jug deri në Tërnavicë në veri. Në disa vende janë të ndërprera me formacione tjera. Përgjatë prishjeve të reja tektonike në kontak me formacionet e jurasikut paraqiten serpentinitet që nuk kanë shtrirje të madhe. Hasen në lokalitetet: Dobratin, Katunisht, Sallabajë, Zhiti etj.

Kretasiku - Në territorin e Podujevës janë mjaftë të përhapura formacionet e kretasikut të cilat përfaqësohen me disa njësi.

Kretaku i poshtëm shtrihet si në pjesën veriore, verilindore dhe vazhdon kah jugu me një brez i cili tutje kah jugu zgjerohet dhe arrin deri te fshatrat Dyz dhe Brainë. Përfaqësohet prej formacioneve alevrolite, mergelet, gëlqerorët konglomeratik.

Kretaku i sipërm senonian shtrihet në pjesën jugperëndimore të komunës. Përfaqësohet nga konglameratet, mergelet, argjilitet, gëlqerorët ranor etj.




Figure 1. Harta Gjeologjike e komunës së Podujevës

Plioceni –shtrihet në pjesën e ulët të komunës, përkatësisht në fushëgropën e Llapit. Shtrihet në të dy anët e Lumit Llap. Është i përfaqësuar me zhavorre, rëra, argjila, mergele, etj. Kompaktësinë e këtij formacioni e prishë lumi Llap, Dumnica, Batllava ku janë shtresuar formacione tjera.

Kuaternari - Sedimentet aluviale, në formë të tarracës lumore, janë të përfaqësuara përgjatë të dy anëve të rrjedhave ujore dhe përbëhen nga zhavorret, rëra, dhe suargjillat. Zhavorri përbëhet nga zajet (guralecët) e kuarcit dhe shkëmbinjtë metamorfik.

Sedimentet deluviale janë konstatuar në pjesën veriore të komunës, përkatësisht në rrëzë të shpateve malore (Metehi, Godishnjak, Penuhë).

Sedimentet aluviale janë prezentë përgjatë të dy anëve të rrjedhave lumore dhe degëve të tyre, që përfaqësohen nga depozitimet zhavorreve dhe rërës. Shtrirja e këtyre sedimenteve si për kah trashësia ashtu edhe gjërësia është e ndryshme.

4.3.1.2. Tektonika

Në aspektin tektonik territori i komunës së Podujevës shtrihet në zonën tektonike të Vardarit. Kjo zonë është e ndarë në tri njësi tektonike. Kjo komunë shtrihet në zonën Qendrore të Vardarit e cila ka shtrirje VVP-JJL. Një pjesë e vogël e territorit që përfshinë ekstremin lindorë shtrihet në Zonën e Brendshme të Vardarit. Njësia Qendrore e Vardarit mund të ndahet në dy pjesë (verior dhe jugor), kufiri i të cilave kalon në lindje të Prishtinës që njihet si dislokacioni i Grashticës. Lëvizjet tektonike më të shprehura në këtë hapësirë kanë ndodhë gjatë mezozoikut që e dëshmojnë edhe formacionet e kësaj periudhe. Në këtë zonë kanë ndodhur edhe procese intrudive dhe efuzive vullkanike përgjatë plasave dislokative në triasik. Pas një qetësimi tektonik në mbarim të kretakut dhe fillim të paleogjenit territori i Kosovës me këtë edhe zona e Vardarit marrin veçori kontinentale.

Nga lëvizjet radiale të miocenit dhe pliocenit janë përfshirë edhe malet e ulëta në lindje të territorit të komunës. Lëvizjet tektonike radiale janë aktivizua përgjatë plasave të vjetra edhe pas fazës liqenore. Kjo është manifestua me shkarjen e sedimenteve liqenore që mbulojnë fundin e basenit, maskojnë relievin tektonik dhe vijat dislokative të bazës që ndodhet nën to.

Në miocen, me lëvizje radiale tektonike, krijohen basenet si forma negative që ndodhen në mes të

maleve. Në pliocen këto lëvizje bëjnë thellimin dhe zgjerimin e baseneve dhe përfundon krijimi i relievit tektonik. Këto zhytje ose lëshime përgjatë dislokacioneve në hapësirën e Podujevës kanë qenë më të dobëta. Me përfundimin e krijimit të këtyre baseneve fillon faza liqenore e tyre.

Në këtë hapësirë format elementare të relievit tektonik janë malet dhe basenet neogjen si forma negative.

4.3.2. Relievi

Relievi është një faktorë i rëndësishëm fiziko-geografik për çdo hapësirë, andaj në planet zhvillimore komunale trajtohet nga aspekti i përshtatshmërisë së tij për zhvillim. Çka ofrojnë ato forma relievo, si shfrytëzohet hapësira që pa tjetër e ka bazën në ndonjë formë relievo.

Në territorin e kësaj komune hasen forma të ndryshme relievo që janë krijuar nga agjens të ndryshëm. Mund të dallohen tri tërësi kryesore relievo, në përfundim malet e Kopaonikut, majet e të cilave arrijnë deri 1770 metra. Në pjesën lindore ndodhen malet e ulëta, majet e të cilave nuk kalojnë 1100 metra, nga të cilat më të rëndësishme janë: Prugovci, Braina, malet e Turuqicës, Herticës etj.

Në mes këtyre dy tërësive malore ndodhet fushëgropa e Llapit e shtrirë në drejtimin V-J, me gjatësi rreth 31 km. Gjatë fazës liqenore ka komunikua me basenin e Kosovës. Njëkohësisht në këtë fushëgropë është i koncentruar vendbanimet, bukës etj. aktiviteti ekonomik, popullsia, tokat e




Figure 2. Hipsometria e terrenit për komunën e Podujevës

Në pjesët malore vendbanimet janë më të rralla por ndodhen pyjet dhe kullosa. Pjesa perëndimore ka rrëpira më të ashpra dhe më rrallë e populluar. Pjesa lindore është më e ulët dhe lëshohet në fushëgropë me rrëpira më të buta prandaj është më e përshtatshme, për këto arsye është më e banuar. Si rezultat i formave relievore rrjedh ekspozicioni i terrenit që në këtë komunë është i përshtatshëm ngase ka pakë sipërfaqe që është i ekspozuar kah veriu, verilindja dhe veriperëndimi. Pjesa jugore e komunës ka ekspozicion verior dhe në luginat lumore që janë prerë në male. Prej formave tjera relievore dallohen luginat lumore që fillojnë në male. Rëndësia e tyre është ngase ofrojnë kushte për shtrirjen e rrjetit rrugorë, por përgjatë tyre shtrihen edhe vendbanime. Më të rëndësishmet janë luginat e lumit Llap, lumit të Kaqandollit, lumit Batllava. Lumi Dumnica nuk ka luginë të shprehur lumore, ngase rrjedhja e tij kryesisht është nëpër fushëgropën e Llapit. Luginat relativisht të ngushta kanë rëndësi për akumulacione të ujit si është ajo e Llapit dhe Kaqandollit. Ekzistojnë luginat tjera por me dimensione mjaft të vogla si ajo e lumit të Tërnavës, lumit të Turuqicës, Brainës etj.

Nga analiza e formave relievore mund të dallohen katet hipsometrike. Ndarja në këto kate është e ndryshme varësisht prej problemeve që duhet të analizohen. Nga kjo strukturë e relievit mund të ndahen këto kate: në relievin fushorë-bregor deri në 700 m, 700-900m kodrinor, 900-1200 relativisht malore dhe mbi 1200 m malore. Deri në 700 m shtrihen 179.1 km², nga 700-900 metra lartësi mbidetare shtrihen 195.1 km², 900-1200 shtrihen 185.5 km² dhe mbi 1200m janë 69.0 km² sipërfaqe.

Tabela 4. Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas kateve hipsometrike

Katet hipsometrike	Sipërfaqja (km ²)	%
500-700m	179.1	28.5
700-900m	195.1	31.0
900- 1200m	185.5	29.5
Mbi 1200m	69	11.0
Gjithsej	628.7	100

4.3.3. Tokat

Komuna Podujevës përfaqësohet me tipa të llojllojshme të tokave: toka aluviale, deluviale, rendzinë, ranker, murme argjilore liqenore, e mesme e kuqërremtë, pseudogleje etj.

Tokat aluviale si toka hidromorfike të cilësisë së lartë shtrihen përgjatë lumit Llap, si dhe tokat tjera që kanë cilësi të mira kultivimi siç janë: deluviale, e mesme e kuqërremtë, rendzinat shtrihen po ashtu në fushëgropën e Llapit me trashësi mbi 25cm - b80> cm.

Tipi i llojeve tjera të tokës kanë përhapje në tërë territorin e komunës si: rankere, psudoglej, murrme argjilore etj.

Tabela 5. Lloji i tokave dhe sipërfaqet

Lloji i tokës	Sipërfaqja/ha
Toka aluviale	5842 ha
Toka deluviale	2918 ha
Toka rendzinë	4804 ha
Toka ranker	5025 ha
Murrme argjilore e liqenore	23 ha
E mesme e kuqërremtë	4228 ha
Toka psudogleje	4030 ha

Boniteti i tokave. Sipërfaqet e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit

Tabela 6. Sipërfaqet e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit

Klasa	Sipërfaqe /ha	%
Klasa I	1683	3
Klasa II	5613	9
Klasa III	3232	5
Klasa IV	4794	8
Klasa V	6522	10
Klasa VI	38090	60
Klasa VII	2936	5
Gjithsej	62870	100

Në bazë të dhënave 15322ha ose 25% janë nën mbrojtje në bazë të ligjit të bujqësisë, ku kategoritë I-IV janë nën mbrojtje për përdorim për kultivim të kulturave të ndryshme bujqësore. Rreth ¼ e sipërfaqes së përgjithshme të komunës ka vlera të larta të bonitetit, ato shtrihen kryesisht përgjatë fushëgropës së lumit Llap.

Boniteti i klasës V-VI-VII shtrihen në rreth 75%të sipërfaqes së përgjithshme. Janë më pak kualitative për kultura bujqësore e sidomos ato të klasës VII.

4.3.4. Bota bimore, llojet dhe përhapja

Kushtet pedologjike, klimatike, lartësia e shprehur mbidetare kanë ndikua që të ketë lloje të ndryshme bimore dhe shtazore. Ky biodiversitet më karakteristik është për pjesën e maleve të Kopaunikut. Në zonat malore dhe kodrinore malore dominojnë pyjet, ka edhe sipërfaqe të zhveshura e barishta. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: ahu (*Fagus sylvatica*), qarri (*Quercus cerris*), bungu, shkoza (*Carpinus orientalis*). Disa trungje sipas Instituit për Mbrojtjen e Natyrës janë shpallur si monumente natyrore si plepit në Bajqinë dhe Orllan, trungu i qarrit në Pollatë, Dumnicë dhe Dobratin. Trungjet e ahut janë me dimensione mjaft të mëdha (gjatësia dhe trashësia e drurit). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*Tilia kordata*), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta, sikurse lloji i shkurreve: thana (*Cornus mas*), murrizi (*Crataegus monogyna*), kaça (*Rosa canina*), manaferra e egër (*Rubus fruticosus*), shtogu (*Sambucus nigra*), kulumbria (*Prunus spinosa*), lajthia (*Corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponjë (*Pteridium aquilinum*) etj.

Nga bimët barishtore dallohen lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë që përdoren në mjekësinë popullore, që përdoren si çaj: çaji i malit (*Origanum vulgare*), kantarioni (*Hypericum perforatum*), kamomili (*Matricaria chamomila*), dredhëza (*Fragaria vesca*) etj. Prej drunjëve gjetembajtëse janë mbjellur disa hapësira pranë liqenit të Batllavës, mandej afër fshatit Dobërdol.

Në hapësirat e rrafshëta të komunës, fushëgropën e Llapit zakonisht rritet shelgu (*Salix alba*) në brigje të lumenjve, si dhe plepi që u përmend më lartë. Bimë të ulëta ka mjaft, si lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*Papaver rhoeas*), hithi (*Urtia dioica*) formacionet e livadheve si tërfili dhe shkurre të rralla.

Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë: ujku (*Canis lupus*), derri i egër, dhelpra, lepuri (*Lepus europaeus*), iriqi (*Ernaceus europeus*) etj. Kohët e fundit, jo vetëm në këtë hapësirë, ka filluar të paraqitet kaprolli (*Capreollus chrysaetos*) i cili dikur ka qenë mjaft i përhapur.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si trishtili kokëzi (*Parus major*), zogu i malit, pëllumbi i egër (*Columba livia*), qukapikthi (*Dryobates major*), laraska (*Pica pica*), qyqja (*Cuculus canorus*) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë shqiponja e zezë (*Aquila chryetos*), petriti (*Malco tinnunculus*). Shpezë shtegtarë që jetojnë

janë dallëndyshja, lejleku etj.

Në lumenj jeton gjarpri i ujit (*Natrix natrix*), gurit (*Vipera ammodytes*), bollujca (*Tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*Helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*Testudo bermanni*). Peshq ka disa lloje, në lumin Llap në pjesën e epërme dikur ka qenë mjaft i pasur me trofta të përroskave (*Barbus barbus*) që jeton në ujëra të shpejta dhe ftohta, mustaku i përrrenjve, bërcoku, mlyshi, krapuliqi, krapu (*Cyprinus carpio*), shtuka (*Esox lucius*) etj. Pjesë të kësaj komune shfrytëzohen për gjuajtje peshku sportive në liqenin e Batllavës dhe brigjeve të lumit Llap. Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje merimanga, kaçadreri (*Lucanus cervus*), etj.

4.3.5.Kushtet dhe karakteristikat klimatike

Komuna e Podujevës ka klimë të mesme kontinentale. Në klimë ndikojnë faktorë mikroklimatikë që japin disa specifika të vogla kësaj hapësire. Prej faktorëve mikroklimatikë më të rëndësishmit janë fushëgropa e Llapit dhe malet që e rrethojnë nga të gjitha anët. Efekti i maleve është se kanë reshje më shumë, temperatura më të ulëta, bora qëndron më gjatë, janë të mbuluara me pyje etj. Dallimi në hipsometri prej 550 m kuota më e ulët dhe 1770 m paraqet diferencë prej 1220 m që e shprehur në temperaturë dallimi është 6,8 °C.

Për analizën e parametrave meteorologjike do të shfrytëzohen të dhënat nga stacioni i Podujevës.

- a. Temperaturat në këtë komunë oscillojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Për analizë do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore 15 vjeçare, minimumet dhe maksimumet absolute.

Tabela 7. Temperaturat sipas muajve

Muajt	Podujevë			
	Temperaturat mesatare	Maksimumi absolut	Minimumi absolut	Amplituda
I	-2,1	13,5	-27,2	40,7
II	-0,6	17,5	-25,5	43,0
III	3,5	24,0	-20,0	44,0
IV	9,3	26,0	-4,5	30,5
V	13,5	31,0	-2,0	33,0
VI	17,8	34,0	-1,5	35,5
VII	20,1	37,0	3,0	40,0
VIII	20,1	36,5	2,0	38,5
IX	16,1	34,6	-2,0	36,6
X	10,4	29,5	-6,5	36,0
XI	5,7	20,5	13,6	34,1
XII	1,4	18,0	19,0	37,0
Vjetore	9,6	37,0	-27,2	64,2
Dimri	-0,4	18,0	-27,2	45,2
Pranvera	8,8	31,0	-20,0	51,0
Vera	19,3	37,0	-1,5	38,5
Vjeshta	10,7	34,6	13,6	48,2
Per.vegje.	16,2	37,0	-4,5	41,5

Temperatura mesatare është 9,6 °C, muaji me i ftoftë është janari me temperaturë mesatare -2,1°C, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me 20,1°C. Muaji më i ftoftë me temperaturë ekstreme

është janari me $-27,2^{\circ}\text{C}$, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me $37,0^{\circ}\text{C}$. Amplituda më ekstreme për këtë periudhë është $64,2^{\circ}\text{C}$. Në periudhën vegetative paraqiten temperatura negative që nganjëherë sjellin dëme në bujqësi.

Për jetën e përditshme ka rëndësi lagështia relative e ajrit që paraqet shkallën e ngopshmërisë së ajrit me avull të ujit. Varësisht nga temperatura e ajrit varet edhe lagështia relative e ajrit.

Sasia vjetore e reshjeve është 697 mm që është nën mesataren e Kosovës për këtë periudhë (784mm). Muaji më i lagësht është maji ($77,5$) ndërsa muaji më i thatë marsi me $42,3\text{mm}$. Si shihet në tabelë gjatë periudhës vegetative bien gati 50% e sasisë së reshjeve. Prej stinëve vjeshta është më e lagështa ndërsa vera është më e thatë me $147,9\text{ mm}$. Nëse kalkulojmë sasinë e reshjeve me madhësinë e territorit të komunës së Podujevës del se mesatarisht bien 432 mil m^3 ujë. Kjo është vlerë mesatare dhe duhet pasur parasysh se pika monitoruese është në pjesën e ultë. Me që territori i kësaj komune shtrihet në pjesë malore që kanë sasi të reshjeve më të lartë, atëherë sasia e reshjeve duhet te jetë më e madhe.

Reshjet oscilojnë dhe të rëndësishme janë rastet kur kjo sasi është maksimale dhe minimale ngase çrregullojnë ekuilibrin natyrorë në territorin që bien. Maksimumi absolut maksimal është 256mm në muajin maj që paraqet 36% të sasisë mesatare. Kjo komunë jo rrallë përfshihet nga moti i lig. Muaji me minimum absolut është gushti me 0 reshje dhe korriku me vetëm $0,4\text{mm}$ (40 mililitra për m^2), që tregon se ndodhin thatësi.

Përkundër këtyre variacioneve ekstreme te sasia e reshjeve është shumë i rëndësishëm intensiteti i tyre. Mesataret mujore vjetore e shumëvjeçare fshehin në vete shpërndarjen e tyre.

d. Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës. Erërat e thata dhe të ngrohta ndikojnë në rritjen e avullimit dhe humbjen e lagështisë nga toka dhe bimët. Erërat ndikojnë në komoditetin e ambientit të njeriut, në temperaturat fiziologjike të njeriut. Me së shumti fryjnë erërat veriore, jugore dhe më pak verilindore. Shpejtësi me të madhe mesatare kanë erërat veriore dhe jugperëndimore. Për të gjitha erërat e me drejtimet që i kanë shpejtësi mesatare $3-4\text{ m/s}$, nuk kanë dallime ndërmjet tyre. Shpejtësia maksimale është te erërat jugore deri $18,9\text{ m/s}$.

4.3.6. Hidrografia në komunën e Podujevës

Me që komuna e Podujevës përfshin sipërfaqe mjaft të madhe paraqiten pothuajse të gjitha llojet e ujërave. Territori i komunës së Podujevës ka një rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit të Zi. Ujërat sipërfaqësor paraqiten në formë të përrockave, përrenjëve burimeve dhe lumenjëve. Nëpër këtë territor buron dhe shtrihet lumi Llap, i cili njëkohësisht është dega më e rëndësishme e lumit Sitnica. Lumi Llap buron nga malet e Kopaunikut, ndërsa si burim i tij merit bashkimi i lumit Murgulla me atë të Sllatinës në fshatin Pollatë. Mirëpo si degë duhet të merret lumi Murgulla⁵. Pjesa burimore e lumit rrjedh nëpër lugina relativisht të ngushta dhe të rrëpita. Në fushëgropën e Llapit lumi hyn në fshatin Pollatë ku shpejtësia e lëvizjes zvogëlohet dhe merë karakteristika të lumit fushorë. Sistemi lumor i lumit karakterizohet me rrjet relativisht të dendur të rrjetit lumor. Gjerësia e lumit ndryshon për shkak të dinamikës që kanë lumenjtë, ajo sillet në nivele normale rreth $9-12$ metra në pikën hidrometrike në Lluzhan, thellësi deri në $1,2\text{m}$. Thellësia gjithashtu nuk është e njejtë ngase shtrati ndërtohet nga thellimet ku uji është më i qetë dhe pjesët e cekëta ku thellësia është më e vogël. Gjatësia e këtij lumi në komune është 61 km , ndërsa deri në grykëderdhje në lumin Sitnica $82,7\text{ km}$. Gjatë reshjeve intesive dhe shkrirjes së borës gjatë stinës së dimrit kur temperaturat rriten, lumi del nga shtrati dhe i përmbytë pjesët rreth tij duke shkaktuar dëme të konsiderueshme.

Lumi Llap vrojtohet në pika hidrometrike, në Lluzhan dhe në Milloshevë. Pika hidrometrike në Lluzhan funksionon prej vitit 1950 me disa ndërprerje. Në këtë pikë prej vitit 1981 është theluar shtrati i lumit

⁵R. Pllana, Hidrologjia e lumit Llap, Buletini i FSHMN, Prishtinë, 1981.

dhe nivelet janë shënuar me vlera negative.

Lumi Batllava ka sipërfaqe të pellgut 315 km² dhe derdhet në Llap afër Lluzhanit. Këtë lum e formojnë disa degë që bashkohen në Orllan. Në vitin 1965 është ndërtuar penda e lartë 40,5m me qëllim të shfrytëzimit të ujit. Ky akumulacion ka kapacitet rreth 40 mil m³ ujë, në fillim është ndërtuar për nevojat e KEK-ut, më vonë është bashkangjitur edhe furnizimi i Prishtinës me ujë, tani janë kyçur shumë vendbanime të kësaj komune si dhe qyteti i Podujevës.

Lumi i Kaqandollit është dega më e rëndësishme e djathtë e lumit Llap, me gjatësi 32,5 km dhe sipërfaqe 193,6 km².

Pellgu i lumit Llap në komunën e Podujevës kryesisht përputhet me vijën e kufirit komunal, përveç me komunën e Prishtinës. Kështu ujërat e lumit të Ballabanit, nga venbanimet si: Koliq, Sharban, Rimanishtë i shkarkojnë ujërat në këtë komunë.

Në këtë komunë hasen disa burime termale dhe termominerale. Më të rëndësishëm janë burimi i Revuçës me prurje prej 10 l/s, dhe një tjetër në fshatin Dobratin. Burime mineralike ndodhen dy në fshatin Sallabajë dhe një në Shakovicë. Burime termomineralike janë nga një në fshatin Sallabajë dhe në Shakovicë.

Ujërat nëntokësorë nuk janë të hulumtuar sa duhet në këtë komunë. Ujërat nëntokësorë ndodhen në sedimentet aluviale që shtrihen në fushëgropën e Llapit përgjatë lumenjëve Llap, Dumnicë, Batllavë. Trashësia e këtyre sedimenteve ujëmbajtëse është deri 6,5m. Niveli i ujit ndodhet në thellësi 2,6 m me ndryshime sezonale. Për shkak të pjerrësisë që e ka fushëgropa rritet shpejtësia e lëvizjes së ujërave nëntokësore dhe shkarkimi i tyre në lumenjë, prandaj verës dukshëm bie niveli i tyre.

4.3.7. Erozioni dhe vërshimet

Erozioni është prezent pothuajse në tërë territorin e Komunës së Podujevës, ku 4.11 % janë sipërfaqe pa erozion, 0.44 % me erozion shumë të dobët, 29.70 me erozion të dobët, 31.91 % me erozion të mesëm, 29.52 % me erozion të fortë dhe 4.32 % me erozion shumë të fortë. Përshpejtimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka inicuar edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar mjedisor.

Më tepër prezentë është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.

Për parandalimin e erozionit PZHK rekomandoi që rajonet në të cilat erozioni ka intensitet të madh e që sjellin pasoja të dëmshme në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe paluajtshme, duhet të shpallen zona erozive ku sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës i shpallë komuna.

Gjithashtu rekomandoi ndërmarrjen e masave parandaluese dhe antierozive për minimizimin e shfaqjes së erozionit.

Vërshimet -Lumi Llap gjatë periudhës së lagështisë ka dispozita të rrezikimit të sipërfaqeve tokësore. Sipas vlerësimeve në Hidroekonominë e Kosovës sipërfaqe që janë të rrezikuara nga vërshimet janë rreth 50.0 ha, ndërsa në rrezik të përhershëm janë rreth 2972.0 ha.

Mbrojtja nga vërshimet përfshinë aktivitetet dhe masat për shmangien apo zvogëlimin e pasojave që mund të kenë vërshimet për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik⁶.

Për të parandaluar dhe minimizuar dëmet PZHK ka rekomanduar masat dhe kushtet në vijim:

⁶Ligjin Nr. UA Nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave

- zgjerimin e shtretërve të lumenjve në mënyrë që të përballojnë vëllimin e ujit;
- eliminimin e lakesave të forta të lumit;
- përcaktimin e vendit për menaxhimin e brigjeve të lumenjëve;
- prerjen e shelgjeve dhe pastrimin nga ana e pronarëve të pronave;
- mbrojtjen e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, të cilat paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit;
- parandalimin e nxjerrjes ilegale të inerteve pranë shtretërve të lumenjëve;
- kufizimin e shfrytëzimit të tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesorë me kullota të përhershme ose pyje përgjatë vijës ujore së paku 10 m nga vija ujore me qëllim të parandalimit të vërshimeve;
- meliorizimin dhe pyllëzimin e brigjeve të lumenjve;
- ndërtimin e kanaleve dhe / ose mureve mbrojtëse;
- kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjëve, sidomos ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet;
- mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve, por prerja lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për rregullim peizazhor për rekreim, si modeli i terrenit dhe mbjellja e barit.

Gjithashtu duhet të ndërmerren masat dhe kushtet zhvillimore tjera të përcaktuara me Ligjin Nr. UA Nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave dhe UA Nr. 04/2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërrjedhave dhe Akumulacioneve.

4.3.8. Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit

Sipërfaqet ujore përfshijnë të gjithë ujërat e brendshëm sipërfaqësor (liqenet dhe akumulimet, ujërrjedhat e hapura) dhe ujërat nëntokësor (burimet akuifere intergranular dhe karstik, burimet minerale, termale dhe termominerale).

4.3.9 Sipërfaqet ujore dhe zonat e mbrojtura sanitare të burimeve të ujit sipas PZHK-së dhe Strategjive nacional

Në komunën e Podujevës, sipas PZHK, lumenjtë dhe shtretërit e tyre përbëjnë 1% të sipërfaqes së përgjithshme.

Sipërfaqet ujore në Podujevë përfshijnë.

- Lumenjtë (Llap, Murgulla, Dumnica, Batllava, Kaqandollit)
- Burime të ujit natyror (Revuçë, Zhiti, Dobratin, Peran)
- Burime termomineralike (Sallabajë dhe Shakovicë)
- Akumulimi Batllava

Me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve ujore nga ndotja prej mbeturinave inerte, ujërave të zeza dhe industriale, degradimi nga eksploatimi i inerteve (sidomos në lumin Llap dhe Murgull), erozioni dhe vërshimet, si dhe veprimet e pakontrolluara të njeriut, HZK ka paraparë ndërmarrjen e këtyre veprimeve dhe masave si:

- a) Ndërtimin e impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe industriale në lumenj;
- b) Rregullimin e shtretërve dhe krijimi i brezave të gjelbër përgjatë tyre;
- c) Aktivitete për pastrimin e shtratit të lumit Llap dhe Liqenit Batllava;
- d) Ndërtimin e teracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve;
- e) Ndërtimin e argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gjërryerjes;

- f) Meliorimi dhe mbjellja e fidanëve pyjore në brigjet e lumenjve;
- g) Ndalimin e nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve;
- h) Largimin e barrierave nga shtrati i lumenjve, qofshin ato natyrale apo të krijuara nga njeriu;
- i) Ndërtimi i kanaleve dhe/ose mureve mbrojtëse;
- j) Kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet;
- k) Masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve;
- l) Veprime për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve (mbjellja, modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit);
- m) Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve;
- n) Ndalimi i ndryshimit të rrjedhës së lumit;
- o) Hartimi i PRH-së për bregun e lumit Llap me qëllim trajtimi si hapësirë publike;
- p) Hartimi i PRRH-së për sipërfaqet që përfshijnë ujin termal në Lluzhan.

4.3.10. Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara të veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Në *pasurinë ujore publike* (qoftë ujërrjedhë apo akumulacion), sipas ligjit për ujëra, respektivisht udhëzimit administrativ për rregullimin e statusit të pasurisë ujore, si dhe për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulacioneve komuna ka paraparë masa të veçanta. Gjerësia e brezit bregujor është 5 m' nga shtrati i ujërrjedhës sipas përcaktimit ligjor.

5.0 KUSHTET ZHVILLIMORE TË PËRGJITHSHME

Rregullat e mëposhtme do të zbatohen për të gjitha shfrytëzimet, zhvillimet dhe ndërtesat në territorin e komunës, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me këtë HZK. Sipas përcaktimit ligjor të UA 24/2015, këto kushte mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, masat mbrojtëse, modelet e projektimit dhe udhëzimet mbi:

- shfrytëzimet e tokës (shfrytëzimet e lejuara, shfrytëzimet dytësore, të lejuara të veçanta, të përkohshme dhe të ndaluara);
- qasjen në parcelën kadastrale;
- qasjen në infrastrukturën teknike;
- rregullat për parkim dhe shkarkim;
- rregullat për zhvillim të peisazhit dhe shiritave të gjelbër mbrojtës;
- kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial;
- kërkesat dhe zvogëlimi i zhurmës etj.

5.1. Shfrytëzimet e tokës

5.1.1. Shfrytëzimet e lejuara

Në *Tërësinë Malet dhe Peisazhet* shfrytëzimet e lejuara të tokës janë: Pylltari, Blegtori, Bletari, Turizëm kulturor dhe natyror, Shërbime, Infrastrukturë rrugore, teknike dhe sociale si dhe Banim. Zhvillimi lejohet nëpërmjet dendësimit brenda zonës së ndërtuar dhe atë në këto vendbanime: Kërpiemeh dhe Metehi, Revuq, Dobratin, Dobërdol, Llaushë, Velikarekë, Bradash, Buricë dhe Zakut. Objektet e planifikuara të infrastrukturës sociale dhe publike do të jenë të koncentruara në nënqendrën e

Kërpimehit. Zhvillimi i blegtorisë dhe prodhimtarisë blegtorale me eko-produkte dhe bletarisë është i lejuar. Shërbimet për qytetarët do të ofrohen në nën-qendrën sekondare të Kërpimehit. Zhvillimi i turizmit është i lejuar në shkallë të vogël dhe ndërtimi i objekteve shërbyese turistike duhet të bëhet sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara në zonën përkatëse.

Në *Tërësinë Natyra dhe Turizmi* shfrytëzimet e lejuara të tokës janë: Bujqësia, Blegtoria, Industria, Bizneset, Pylltaria, Turizmi kulturor dhe natyror, Infrastruktura, rrugore, teknike dhe sociale, Shërbimet dhe Banimi. Zhvillimi lejohet nëpërmjet plotësimit të hapësirave ndërmjet ndërtimeve ekzistuese dhe dendësimit brenda zonës së lejuar ndërtimore dhe atë në këto vendbanime: Shajkoc dhe Batllavë. Stimulohet zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, bletarisë. Lejohet shfrytëzim racional i pyjeve dhe zhvillimi i industrisë së drurit, mobilieve dhe artizanateve me kapacitet të kufizuar. Shërbimet për qytetarët do të ofrohen në nënqendrën sekondare: Orllan.

Në *Tërësinë Aktive-Qendrore* shfrytëzimet e lejuara të tokës janë: Bujqësia, Industria me theks ajo ushqimore, Tregtia, Turizmi rekreativ dhe kulturor (ditor dhe vikendor), Transporti, Shërbimet, Banimi, Infrastruktura sociale dhe teknike. Zhvillimi i bujqësisë intensive lejohet me kusht që të respektohet vija e zgjerimit të vendbanimeve. Zhvillimi/duhet të bëhet me plotësimin e hapësirave ndërmjet ndërtimeve ekzistuese dhe dendësimin brenda zonës/kufirit të lejuar ndërtimor dhe atë në: Konushevc, Dumnicë e Poshtme, Letanc, Peran, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Gllamnik, Surkish, Ballofc, Shtedim, Mirofc, Podujevë, Penuhë, Godishnjak, Sallabajë, Lluzhan, Bellopojë, Radujevc, Kaçibeg, Siboc i Poshtëm, Siboc i Epërm, Sfeqël, Dumosh, Lladoc, Lupç i Poshtëm, Shakovicë, Merdar, Livadhia. Shërbimet e nivelit komunal do të ofrohen në qendrën komunale të Podujevës, kurse shërbimet për qytetarët do të ofrohen në nën-qendrën sekondare Lluzhan. Objektet e planifikuara të infrastrukturës sociale dhe publike në këto qendra do të jenë të koncentruara.

5.1.2. Shfrytëzimet dytësore

Në zonat përkatëse do të lejohet vetëm zhvillimi i shfrytëzimeve dytësore që janë përcaktuar me PZHK dhe HZK. Shfrytëzimet dytësore nuk duhet të themelohen para zhvillimit të shfrytëzimit të ndërtesës ose strukturës kryesore, të cilës i shërben ose ndaj së cilës është vartëse. Shfrytëzimet dytësore nuk do të vazhdojnë të ekzistojnë pasi shfrytëzimi, objekti apo struktura kryesore të cilës i shërben, ose ndaj të cilës është vartëse, të jetë ndërprerë së ekzistuari.

5.1.3. Shfrytëzimet dhe strukturat e përkohshme

- Do të lejohen ndërtimi apo instalimi i strukturave të përkohshme vetëm nëse pronari apo investitori posedon certifikatën për përdorim;
- Shfrytëzimet e përkohshme si panairë, koncerte, ekspozita, do të lejohen vetëm në hapësira ku nuk pengojnë lëvizshmërinë e këmbësorëve dhe veturave;
- Strukturat e shfrytëzimit të përkohshëm nuk duhet penguar vizurat përreth hapësirës;
- Kohëzgjatja e qëndrimit të strukturave të përkohshme do caktohet nga autoriteti përgjegjës komunal;
- Të gjitha pajisjet, materialet, ndriçimi, shtyllat, strukturat si dhe elementet tjera të përkohshme duhet të largohen dy ditë pas përfundimit të lejes së shfrytëzimit.

5.1.4. Shfrytëzimet dhe strukturat e veçanta

- Në të gjitha zonat do të lejohen vetëm shfrytëzimet dhe strukturat e veçanta të definuara me HZK të komunës së Podujevës;
- Zhvillimi shfrytëzimeve të veçanta në zonat përkatëse si autolarjet, impiantet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, objektet për trajtimin dhe reciklimin e mbeturinave, depot për mbeturina, instalimi i trafostacioneve dhe shtyllave të telekomunikacionit do të lejohen vetëm kur ndërmerren kushte dhe masa plotësuese të përcaktuara me ligjet përkatëse për zbutjen apo

pengimin e shqetësimeve që do të mund t'i shkaktojnë mjedisit dhe banorëve në zonën përkatëse dhe përreth.

5.1.5. Shfrytëzimet e ndaluara

- Nuk lejohet zhvillimi i atyre shfrytëzimeve në zona nëse nuk janë paraparë me PZHK dhe HZK;
- Nuk lejohen shfrytëzimet jo bujqësore/blektrorale në tokën bujqësore të kategorisë I-IV.
- Nuk do të lejohen zhvillimet/ndërtimet në tokën kualitative bujqësore jashtë kufirit ndërtimor dhe në mos-përputhje me ligjet respektive ndërsa ndërtimet ekzistuese do të trajtohen si jokonformitet.
- Ndalohet parcializimi i tokës bujqësore;
- Prerja e pakontrolluar e pyjeve për nevoja të përpunimit është e ndaluar;
- Ndalohet zhvillimi i shfrytëzimeve përpos atyre bujqësore si kultivimi jashtë kufirit të përcaktuar me PZHK vetëm nëse me HZK do të përcaktohet ndryshe;
- Nuk lejohet zhvillimi i atyre shfrytëzimeve

5.2. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore

Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore janë pjesë të territorit të cilat përmbajnë karakteristikat dhe vlera të posaçme historike, artistike, trashëgimisë kulturore dhe mjedisore urbane. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përcaktojnë mbrojtjen afat-gjate dhe konservimin e një zonë gjeografike me karakteristika të veçanta të trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike, peizazhet kulturore me potencial të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit.

Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përfshijnë perimetrin e vend-shtrirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojtje dhe zonës mbrojtëse të tij në radius prej 50 m (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 m për trashëgiminë arkeologjike nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet në pajtueshmëri me planin e Institucionit kompetent.

Në momentin që ndonje vlerë e trashëgimisë kulturore hyn në listën për mbrojtje të përkohshme apo të përhershme (shih në ligj procedurat për shpalljen e vlerës në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme), ajo regjistrohet në Kadastër.

5.2.1. Sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore sipas HZK-së dhe dokumenteve tjera

HZK i referohet mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore për të cilat propozon që komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) duhet të përgatis planin menaxhues me qëllim të mbrojtjes së monumentit nga çfarëdo zhvillimi që mund të ketë efekte negative tek ato. PZHK propozon përpilimin e katalogut të hartës për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për nevojat e turizmit, dhe vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK. Sipas PZHK në komunë ekzistojnë edhe shumë vlera të trashëgimisë të cilat kanë mbetur jashtë përfshirjes në listën për mbrojtje nga MKRS. Sipas raportit të vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, brenda dy viteve të zbatimit të planit, është punuar pjesërisht në veprimin vërjen nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK-së, kurse nuk ka progres të shënuar për hartimin e planit menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve natyrore dhe përpilimi i katalogut turistik për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Pavarësisht këtyre, vlerësimi ka vënë në pah realizimin e të tjera projekteve që nuk kanë qenë të përfshira me plan si: mbledhjen e ekspozateve në terren, inicimin e trashëgimisë shpirtërore, ekspozita të prezantimit të etno-trashëgimisë dhe fushata senzibilizimi për grumbullimin e ekspozateve

të trashëgimisë.

Në vijim është dhënë tabela që prezanton vlerat sipas Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e vitit 2017 dhe ato të përcaktuara sipas PZHK. Me HZK janë lokalizuar këto vlera dhe për to është përcaktuar zona mbrojtëse sipas përcaktimeve të ligjit respektiv.

Tabela 8. Lista e trashëgimisë kulturore sipas HZK dhe listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme e vitit 2017

KATEGORIA: TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE					
A	Nënkategoria: Monument/Ansambël	Periodha	Vend-ndodhja	HZK	Lista 2017
1	Lokalitet Arkeologjik	Antikë	Sallabajë		
2	Gërmadhat e kishës	Mesjetë	Sallabajë		
B	Nënkategoria: Lokalitet arkeologjik/rezevat				
1	Lokalitet arkeologjik-Maja e Llapit ('vërhlab')	Antikitet i vonë	Bellasicë	√	√
2	Varret e vjetra, gjurmët e kishës	Antikitet i vonë, Mesjetë	Pollatë	√	√
3	Lokaliteti arkeologjik- Çuka e Brainës	Antikitet i vonë, Mesjetë	Brainë	√	√
4	Gërmadhat e Kishës 'Perandori Konstantin dhe Perandoreshës Jelena'	Mesjetë	Orllan	√	√
5	Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjel Mehillit	Mesjetë	Rakinicë	√	√
6	Lokaliteti arkeologjik Vindenis 'Polanicë'	Romake, antikitet i vonë	Gllamnik	√	√
7	Gërmadhat e kishës së Marisë së Zjarrit	Mesjetë	Batllavë	√	√
8	Lokaliteti arkeologjik-Kalaja (qyteaza)	Antikitet i vonë	Lupç i Poshtëm	√	√
9	Gërmadhat e kishës së Shën Arkangjelit	Mesjetë	Bradash	√	√
10	Lokaliteti neolitik 'Gumnishtë'	Parahistori	Surkish	√	√
11	Kalaja e Ballocit	Antikitet i vonë	Balloc	√	√
II. KATEGORIA: TRASHËGIMIA ARKITEKTURORE					
A	Nënkategoria: Monument/Ansambël				
1	Kisha e Shën Andrejës	shek.XIX	Qytet		√
2	Shtëpia e Kadri Metehisë	shek.XVII	Metehi		√
3	Shtëpi banimi	1935	Qytet		√
4	Kulla e Xhemail Haxhiut	shek.XIX	Hercicë		√
5	Shtëpi banim- Avdullah Avdullahu	shek.XIX	Llaushë e ulët		√
6	Kishëz	shek.XIX	Rakinicë		√

7	Xhamia e brainës	shek.XVIII	Brainë		√
8	Mulliri Metehi	shek.XX	Metehi		√
9	Pojata e Avdyl Shabani	shek.XX	Metehi		√
10	Flladniku i Avdyl Shabani	shek.XX	Metehi		√
11	Xhamia e Dumnicës	shek.XIX	Dumnicë		√
12	Kulla e Nazif Muratit	shek.XIX	Popovë		√
13	Mulliri i Demë Ahmetit	shek.XIX	Reçicë		√
14	Shtëpi banimi- Sabit Hamiti	shek.XX	Reçicë		√
15	Kulla e Demë Ahmetit	shek.XX	Reçicë		√
16	Shtëpi banimi-Musa Hamiti	shek.XIX	Reçicë		√
17	Shtëpi banimi-Hasan Ramadani	shek.XX	Shajkoc		√
18	Mulliri	shek.XIX	Majac		√
19	Koshi i Basri Rrahmanit		Lladoc		√
TË PROPOZUARA NGA KOMUNA PËR MBROJTJE					
20	Teqja në Herticë				
21	Xhamia në Herticë				
22	Mulliri në Pollatë				
B	Nënkategoria: Fushat e konservimit arkitekturor				
1	Shishe	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
2	Kupë	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
3	Vazo	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
4	Sarkofag	shek.II-IV	Vindenis,Gllamnik		√
5	Broke	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		√
6	Byzylyk	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		√
7	Broke	shek.IV-VI	Vindenis,Gllamnik		√

5.3 Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës

Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës përfshijnë:

- Rezervatet strikte të natyrës;
- Parqet kombëtare;
- Zonat e veçanta të mbrojtura të natyrës;
- Zonat e veçanta të ruajtura;
- Parqet natyrore;
- Monumentet e natyrës;
- Peizazhet e mbrojtura;
- Monumentet e arkitekturës së parkut.

5.3.1 Sipërfaqet me vlera të mbrojtura të natyrës sipas PZHK-së dhe dokumenteve tjera

Lista e monumenteve të natyrës në komunën e Podujevës, duke referuar regjistrin të MMPH-së/Institutit për mbrojtje të natyrës është sikur në tabelën vijuese.

Tabela 9. Vlerat natyrore

	Monumente me karakter botanik	Sipërfaqja e mbrojtur	Zona buferike e përfshirë në kuadër të sipërfaqes	Pronësia
1	Trungu i Qarrit në Pollatë	5 ari		
2	Trungu i shpardhit në Dyz	5 ari	10 m rreth projekcionit të kurorës	Private
3	Trungu i dushkut në Llapashticë të Epërme	5 ari		Private
4	Trungjet e dushkut në Llapashticë të Epërme	10 ari		Shoqërore
5	Trungu i plepit në Murgull	5 ari		Shoqërore
6	Trungu i plepit në Orllan	5 ari		Komunës
	Monumente me karakter hidrologjik			
1	Burimi i ujit termo-mineral në Shakovicë	1ha 40 ari e 54m		
2	Burimi i ujit termo-mineral në Sallabajë	31 ari e 47m		
	Monumente me karakter botanik dhe hidrologjik			
1	Trungu i ahut dhe vrella në Dobratin	10 ari	10 m rreth projekcionit të kurorës dhe burimit të ujit	Private

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Monumentet me karakter botanik

Shfrytëzimet e lejuara:

Në sipërfaqen e monumentit lejohen:

- Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të monumentit nën kushtet të cilat i përcakton autoriteti përgjegjës sipas projektit për sanimin e gjendjes;
- Punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit;
- Shfrytëzimi i ujit (nën mbikëqyrjen e organeve kompetente) duke mos përguar rrjedhën e tij.

Në zonën buferike lejohen shfrytëzime për qëllime të prezantimit me kusht që nuk e rrezikojnë monumentin.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: Lejohen veprimtari që kanë për qëllim hulumtimin, mbledhjen e të dhënave profesionale si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Mjetet për mbrojtjen e bimëve dhe plehtrat minerale mund të përdoren në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Shfrytëzimet e përkohshme: /

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në sipërfaqen e monumentit ndalohet:

- Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
- Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
- Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur;

- Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- Punimi (lëshimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur
- Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të monumentit të natyrës.

Në zonën buferike të monumentit ndalohet:

- Rrjedhja (lëshimi) i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;
- Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
- Ndërrimi i kulturës;
- Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së monumentit.

Monumentet me karakter hidrologjik

Shfrytëzimet e lejuara: Në sipërfaqen e monumentit lejohen objekte dhe stabilimente që janë në funksion të mbrojtjes së tij.

Në zonën buferike lejohen ato ndërhyrje dhe punë të cilat nuk i dëmtojnë dhe nuk i ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është shpallur e mbrojtur.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: Lejohen veprimtari që kanë për qëllim hulumtimin, mbledhjen e të dhënave profesionale si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Mjetet për mbrojtjen e bimëve dhe plehurat minerale mund të përdoren në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Shfrytëzimet e përkohshme:

Shfrytëzimet e ndaluara:

Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij. Ndalohen apo kufizohen aktivitetet në vijim:

- ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës;
- ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve;
- mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve;
- deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura;
- ndryshimi i regjimit të ujërave;
- evitimi i përmytjeve, përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike;
- kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës;
- gjuetia, peshkimi, veprimtaritë rekreative- sportive;
- vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera;
- aktivitetet tjera të cilat mund të rrezikuar vlerën e mbrojtur të natyrës.

Në zonat buferike ndalohet kryerja e ushtrimeve dhe aktiviteteve të tjera ushtarake të cilat mund t'i rrezikojnë vlerat e natyrës.

5.3.1.1 Kushtet zhvillimore

Kushtet zhvillimore për ndërtesat dhe instalimet në kuadër të shfrytëzimeve të lejuara në këto zona (në këtë rast vlen për monumentet e natyrës me karakter hidrologjik), si dhe rregullat për zhvillimin e peisazhit dhe shiritave mbrojtës të gjelbërimit, siguria nga zjarri etj përputhen me kushtet zhvillimore të përgjithshme.

Masat e përgjithshme mbrojtëse si dhe masat e mbrojtjes për monumentin e natyrës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe akteve ligjore përcjellëse.




Figure 3. Zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës si dhe sipërfaqet ujore me zonat e mbrojtura ujore

5.3. Zona aktive

Tërësia **Aktive – pjesa urbane** është e ndarë në 5 njësi urbane. Njësia e qendrës dallohet me prezencën e objekteve publike, kulturore e tregtare, e mbuluar kryesisht me objekte banimi kolektiv. Ndërsa, 4 njësitë tjera të zonës urbane, Qendra 2 veri dhe jug, si dhe Qendra 3 veri dhe Jug, janë të dominuara kryesisht me banim të cilat e rrethojnë qendrën e qytetit. Rrugët kryesore në drejtim të qendrës, si dhe disa rrugë anësore ndaj qendrës, dallohen me aktivitete tregtare. Zonat e banimit zhvillohen në të gjitha njësitë e zonës urbane, ndërsa zona industriale shtrihet në lindje të qytetit, buzë magjistrales Prishtinë-Merdar.

Struktura urbane e Podujevës gradualisht është duke u ndryshuar si rezultat i zhvillimeve të cilat kanë ndodhur viteve të fundit. Përpos sipërfaqeve të banimit në pjesën urbane hynë sipërfaqet tjera të ndërtuara si, transporti, shërbimet, sipërfaqet e veçanta dhe sipërfaqet e gjelbra. Kufiri urban në qytetin e Podujevës përfshinë pjesërisht zonat kadastrale të Podujevës, Obrancës dhe Letancit.

Hapësira qendrore urbane në komunën e Podujevës është e përcaktuar si hapësirë për riformatim dhe zhvillim. Këtu kryesisht parashihet të bëhet rigjenerim dhe rivitalizim urban, dhe dendësim i theksuar në njësitë qendrore të tij. Ky dendësim është planifikuar të bëhet në përputhje të plotë me dispozitat të cilat janë të përcaktuara me PZHK.

Për të përmirësuar lëvizshmërinë brenda zonës urbane është paraparë edhe krijimi i rrjetit të ri të rrugëve të cilat do të ofronin lidhshmëri të mirë në mes të tërësive brenda zonës urbane, duke patur për prioritet transportin e pa motorizuar si dhe do të ofrohen mundësi për organizmin e transportit urban.

Lëvizshmëria do të rregullohet me një plan të veçantë të mobilitetit i cili do të hartohet brenda 2 viteve pas hartimit të hartës zonale.

Njësia urbane “Qendra 1”

Është pjesa qendrore e qytetit në të cilën janë të vendosura të gjitha përmbajtjet administrative dhe kulturore të qytetit.

Rrugët që e kufizojnë njësinë Qendra 1 janë: në anën veriore fillon me rrugën Qefser Sadiku dhe Shaban Shala, në anën veri—lindore kufizohet me rrugën rajonale R 126 duke vazhduar në anën Lindore me rrugën rajonale. Në anën Juglindore më rrugën Vëllezërit Frashëri, në pjesën Jugore kufizohet me rrugën primare urbane Besnik Restelica, përderisa në anën perëndimore kufizohet me rrugën R (127) , Afrim Zhitia, Ilir Konushevc, 2 Korriku dhe përmbillet me trasenë e hekurudhës deri te rruga nacionale R 126.

Bazuar në PRRU-në ekzistuese kjo tërësi është e ndarë në 17 blloqe të cilat janë të plotësuar kryesisht me banim me funksione tjera në pajtueshmëri. Pavarësisht që etazhiteti maksimal i kësaj tërësie sipas PRRU-së ka qenë P+7, në realitet ndërtimet e larta të objekteve të banimit janë realizuar në etazhitet prej P+9. Dendësia e banimit për këtë pjesë është paraparë të jetë 120-300 b/ha. Me këtë hartë zonale është paraparë që të bëhet rizhvillim i disa blloqeve ku etazhiteti maksimal arrinë në P+9. Varësisht prej etazhitetit të përcaktuar në blloqet përkatëse, kërkohet që zhvilluesi i projektit të paraqes një zgjidhje ideore urbanisitike në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë hartë zonale.

Për VSM kjo njësi duket e gjerë, mund të jetë zona qendra 1, njësi më e vogël se që është propozuar në HZK.

Njësitë urbane “Qendra 2 Veri dhe Qendra 2 Jug”

Njësitë urbane Qendra 2 Veri dhe Jug, gjenden përreth pjesës qendrore të qytetit përkatësisht Qendrës 1 dhe 2.

Rrugët që i rrethojnë janë si më poshtë:

Qendra 2 Veri në anën Veriore kufizohet me rrugën Hyzri Talla, Rrugën Nacionale R 127, rrugën Hakif Zejnullahu, Iset Maloku, Ilir Konushevc. Në anën Lindore përgjatë kufirit të zonës urbanë që njëherit paraqet edhe kufirin e zhvillimeve në këtë pjesë. Në anë jugore përfundon tek rruga Bedri Bajrami, ndërsa në pjesën Perëndimore përputhet me trasenë e hekurudhës, deri tek rruga 2 korriku.

Qendra 2 Jug në anën Veriore fillon me rrugën bedri Bajrami deri tek Parku i pishave dhe kalon përgjatë rrugëve Hakif Sheholli, Fehmi Aganideri tek rruga nacionale M 25 në pjesën Jugore. Në anën jug perëndimore kufizohet me trasenë e hekurudhës, përderisa në pjesën perëndimore me rrugët “Nazim Gafurri, Zahir Pajaziti, Vëllezërit Frashëri e deri tek rruga Jusuf Koliqi.

Këto dy njësi kanë karakteristika të njëjta të cilat përbëhen prej disa blloqeve dhe përmbajtja e tyre është kryesisht banim individual dhe banim me funksione tjera në pajtueshmëri. Dendësia e banimit variron prej 60-120 banorë për ha. Për dallim prej zonës qendrore e cila tashmë veçse është ri zhvilluar në këtë tërësi nuk ka patur shumë zhvillime. Karakterizohet me rrugë të ngushta, mungesë të hapësirave publike dhe përmbajtjeve tjera të cilat do të ngrisin kualitetin e banimit në këto pjesë. Banimi individual e përbën pjesën me të madhe të tij dhe sipas planeve të mëhershme është paraparë dendësia e zonës dhe ngritja e kualitetit të banimit dhe shërbimeve përcjellëse. Në tërësinë qendra 2 jug, pjesa perëndimore e saj gjendet jashtë kufirit urban dhe kufizohet me kopshtin lindor në të cilin tashmë është zhvilluar banimi individual. Fokusi kryesor në këto njësi do të jetë ofrimi i infrastrukturës rrugore dhe të transportit, përderisa ndërtesat shkollore do të përmbushin nevojat e banorëve për hapësira rekreative dhe sportive, në mungesë të hapësirave tjera publike. Kryesisht etazhiteti në këto njësi arrin deri në P+3 të banimit me funksione tjera në përshtatshmëri, me përjashtim të disa pjesëve të cilat kufizohet me Qendrën 1, ku është planifikuar të ketë ndërtim deri në P+12. Përgjatë rrugëve përmbledhëse në qytet, në të njëjtën kohe që kryejnë funksionin e rrugëve rajonale, është i zhvilluar

banimi me funksione tjera në pajtueshmëri. Inkurajohet zhvillimi i banimit individual të shtëpive dyshe dhe në varg, për shkak të dendësimit i cili është paraparë.

Njësitë urbane Qendra 3 Veri dhe Qendra 3 Jug

Në zonën urbane njësitë urbane Qendra 3 Veri dhe Qendra 3 Jug gjenden si është përshkruar më poshtë. Qendra 3 Veri përputhet me kufirin e zonës Urbane, deri tek kryqëzimi i rrugëve Ilir Konushevcu dhe Ramadan Murati, ku vazhdon përgjatë rrugës Iset Maloku, Hyzri Talla, Shaban Shala, Rrugën Qesfer Sadiku, rrugën Rajonale R 126 dhe në Jug Perëndim përgjatë kufirit të zonës kadastrale të Podujevës. Në anën perëndimore dhe veriperëndimore përputhët me kufirin urban.

Qendra 3 Jug - Ngjashëm sikur Qendra 3 veri, kjo njësi paraqet kufirin e zonës urbane në atë rurale dhe në pjesën veri perëndimore fillon nga kufiri i zonës kadastrale të Podujevës dhe vazhdon me kryqëzimin e rrugëve rajonale R126 dhe R 127, pastaj ndjekë Dr. Ali Hadri, Vëllezërit Frashëri, Zahir Pajaziti, Nazim Gafurri deri tek Traseja e Hekurudhës më pas vazhdon përgjatë rrugës nacionale N 25 deri tek kufiri urban në Juglindje, Jug dhe Perëndim.

Të dyja paraqesin njësitë të cilat janë në kufi me zonën rurale dhe zonën bujqësore brenda kufirit kadastral të Podujevës. Si të tilla kanë dendësi më të ulët prej 60-90 banorë për ha. Po ashtu e gjithë kjo tërësi është dominuar nga banimi individual, si dhe shërbime të nevojshme për komunitetin. Në parcelat përgjatë rrugëve rajonale të cilat gjenden në këtë tërësi, pjesërisht është i zhvilluar banimi me funksione tjera në pajtueshmëri, i njëjti funksion planifikohet të vazhdojë të plotësohet dhe dendësohet. Për shkak të karakterit të njësisë inkurajohet zhvillimi i banimit individual, shtëpive të veçanta të cilat do të mund të zhvilloheshin aktivitete të bujqësisë urbane ashtu siç edhe është praktikuar deri më tani. Kjo zonë karakterizohet me mungesë të hapësirave rekreative dhe sportive, në veçanti njësia Qendra 3 Jug po ashtu edhe me mungesë të tokave komunale për ndërtimin e këtyre përmbajtjeve. Në të ardhmen komuna duhet të ndërmer masa për të siguruar hapësira rekreative për banorët në këtë pjesë të qytetit.

Tërësia Kopshti Lindor

Brenda zonës kadastrale të Podujevës, por jashtë kufirit urban në anën perëndimore jashtë kufirit urban gjendet parku i pishave i cili në të njëjtën kohe paraqet kufirin e zonës së ndërtuar duke vazhduar me tokën bujqësore të klasit I-IV e cila do të mbrohet si e tillë. Ky park parashihet të mbrohet në të ardhmen dhe në afërsi të tij parashihet që në tokën komunale të ndërtohen hapësira rekreative sportive të cilat do të jenë në shërbim të komunitetit. Për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara të viteve të fundit, toka bujqësore përreth kopshtit lindor është dëmtuar dukshëm, gjithsesi që pjesa e mbetur planifikohet të mbrohet me këtë hartë zonale.




Figure 4. Ndarja në njësi urbane e Komunës së Podujevës

5.3.1. Zona Bujqësore

Toka bujqësore është toka e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore si arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hurdhja peshku dhe moçale, si dhe tokat tjera që nuk janë në shfrytëzim për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor, duke marrë parasysh vetitë e tyre natyrore dhe kushtet ekonomike⁷.

5.3.1.1 Sipërfaqet bujqësore sipas projeksioneve të PZHK

Sipas PZHK-së, sipërfaqja bujqësore shtrihet në të tri tërësitë hapësinore të Podujevës që përfshijnë gjithsejt 62.870ha ku 25% e sipërfaqes i përket klasës I-IV, dhe pjesa e mbetur klasës V – VII. Në këto sipërfaqe është rekomanduar të zhvillohen bujqësia dhe blegtoria.

Për periudhën dy-vjeçare, vlerësimi i zbatimit të planit ka vënë në pah progresin në zbatimin e një mori veprimeve të parapara në fushën e zhvillimit të bujqësisë të cilat përfshijnë veprimet të cilat kanë ndikuar në shtimin e numrit të bizneseve në këto lëmi duke mundësuar rritjen e numrit të fermerëve, bletarëve dhe blegtorëve rrjedhimisht rritjen e sipërfaqeve të punëshme dhe produktivitetit.

Bazuar në këto zhvillimi edhe HZK e konsideron prioritet zhvillimin e këtyre dy fushave.

Duke pas parasysh që sipas Ligjit për tokën bujqësore në fuqi nuk lejohet ndërtimi i infrastrukturës bujqësore si shtallave dhe objekteve tjera bujqësore në tokën e klasës I – IV, ndërtimi i tyre do të lejohet

⁷UA mbi Normat Teknike të Planifikimit hapësinor

në tokën e klasës V – VII. Megjithatë, ky kusht do të mund të ndryshohet në rast të shfuqizimit të pjesërishëm apo të plotë të ligjit në fuqi.

5.3.1.2 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Harta zonale ka përcaktuar zonën bujqësore varësisht nga boniteti dhe karakteristikat gjeografike të secilës tërësi hapësinore, ka përcaktuar shfrytëzimet e lejuara, ato dytësore, të lejuara të veçanta, shfrytëzimet e përkohshme dhe ato të ndaluara.

Tokë Bujqësore e kategorisë I – IV

Si *Shfrytëzime të lejuara* për këtë zonë janë prodhim bujqësor komercial, bujqësia për konsum vetjak si pemëtaria, perimtaria në të hapur dhe në serra, lavërtaria, kultivimi i bimëve foraxhere dhe mjekuese, fidanishtet, si dhe bletaria. *Shfrytëzimet dytësore të lejuara* janë infrastruktura e bujqësisë si strehë për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore, dhe hapësira për makineritë dhe pajisjet tjera, shërbim kulturor si monumentet kulturore dhe natyrore, hapësirë e hapur rekreative si pyll, lum, tokë bujqësore, burimet e ujit dhe

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara janë infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe për ujitje infrastruktura e transportit si rrugët ekzistuese lokale dhe të pakategorizuara, prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë, hekurudha dhe infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike (trafostacionet) dhe shtyllat e telekomunikacionit (rekomandohet që të shmanget vendosja e infrastrukturës në këtë zonë, nëse është e pashmangshme atëherë preferohet në tokën e kategorisë V – VII).

Shfrytëzimet e përkohshme të lejuara janë shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore / blegtorale, peshkimi si peshkim rekreativ dhe profesional, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairt. *Shfrytëzimet e ndaluara* përfshijnë: bujqësi për prodhim bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore si shtalla dhe infrastrukturë trajtimi dhe përpunimi të produkteve bujqësore, prodhim për konsum vetjak si strehë për kafshë dhe shtalla, pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër, mesëm apo të gjatë dhe në mbulesë të vazhdueshme, minierë e materialeve për prodhimin e energjisë, e xeheve metaleve, gurore tjetër, akuakulturë, industri e lëndës së parë, prodhimeve të rënda, e prodhimeve të lehta, prodhim i energjisë (infrastruktura), shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, i patundshmërisë, i akomodimit dhe ushqimit, financiar dhe i sigurimit, teknik profesional dhe shkencor, të informimit dhe komunikime, administrativ dhe mbështetës, tjetër profesional financiar dhe i informacionit, i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, arsimor, shëndetësor dhe shoqëror, fetar, tjetër i komunitetit, kulturor të gjitha objektet, argëtues të gjitha objektet, infrastrukturë sportive, infrastrukturë e transportit ujor e ajror, shërbim i logjistikës dhe magazinimit, infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave, formë tjetër e infrastrukturës publike dhe banim.

Tokë Bujqësore e kategorisë V – VII

Shfrytëzime të lejuara për këtë zonë janë prodhim bujqësor komercial dhe bujqësi për konsum vetjak si pemëtaria e perimtaria në të hapur dhe në serra, bletaria, kultivimi i fidaneve, dhe i bimëve mjekuese e dekoruese, ndërtesat bujqësore të kategorisë I dhe II (sipas përcaktimit të Ligjit të ndërtimit Nr.04/L-110 /UA për kategorizimin e ndërtimeve) ku përfshihen: fermat për kultivimin e kafshëve të trasha (lopë, dele, dhi), ferma të shpezëve, ndërtesa bujqësore përcjellëse për bagëti dhe shpezëtari, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës, hapësira për makineritë dhe pajisjet bujqësore dhe peshkim.

Shfrytëzimet dytësore të lejuara janë banimi në rastet kur kemi zhvillim të bujqësisë për konsum vetjak, hapësirë e hapur rekreative, infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes të cilat janë në funksion të plotësimin të përmbajtjeve të lejuara.

Shfrytëzimet e veçanta të lejuara janë industri për prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit si prodhimi i qumështit, infrastruktura e transportit si rrugët ekzistuese lokale dhe të pakategorizuara, ndalesat e autobusëve, prodhim i energjisë alternative të bazuar në biomasë (hapësira ku mund të prodhohet biomasa), prodhim i energjisë së ripërtërishme (sipërfaqe me panele solare që shfrytëzojnë burimin diellor për prodhimin e ujit të ngrohtë edhe për energji elektrike), shtigjet për bicikleta dhe këmbësorë, hekurudha dhe infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike (trafostacionet) dhe shtyllat e telekomunikacionit.

Shfrytëzimet e përkohshme të lejuara janë shërbime tregtare si mbledhja dhe shitja e prodhimeve bujqësore/blegtorale, shërbim argëtues dhe rekreativ si festivalet dhe panairët, peshkim rekreativ dhe profesional. *Shfrytëzimet e ndaluara* përfshijnë: bujqësinë për konsum vetjak dhe për prodhim komercial, pylltarinë, minierë dhe gurore, akuakulturë, prodhimtari parësore tjetër, industri e lëndës së parë, e prodhimeve të rënda, e prodhimeve të lehta si prodhim i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, prodhim i energjisë bërthamore, shërbim tregtar si riparim i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, shërbim i patundshmërisë, akomodimit dhe ushqimit, profesional financiar dhe i informacionit, i komunitetit, shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ të gjitha objektet, shërbim tjetër, infrastrukturë e transportit ajror, ujor, e hekurudhor, shërbim i logjistikës dhe magazinimit, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave, formë tjetër e infrastrukturës publike, banim i përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri, dhe banim tjetër.

5.3.1.3 Kushtet zhvillimore

Sa i përket dimensionit të parcelës për zhvillimin e pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë, kultivimit të fidaneve, bimëve dekorative, dhe mjekuese në rastet e vetfinancimit ajo mund të jetë e madhësisë që e posedon pronari, mirëpo në rastet e aplikimit për grante duhet të përputhet me kërkesat e përcaktuara nga MBPZHR.

Tabela 10. Dimensionet e parcelës, ndërtesave, etazhiteti dhe intensiteti i zhvillimit

Lloji i shfrytëzimit	Dimenzioni i parcelës (minimale)	Dimensionet e ndërtesës dhe lartësia
Ndërtesat bujqësore të kategorisë I*		Deri 600 m ² * Fermat 1 kat me lartësi minimale 7m' dhe maksimale 10m'; Depo për grumbullim të produkteve
- Ndërtesa bujqësore, ferma dhe ndërtesa tjera përcjellëse për bagëti dhe shpezëtari, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës;	Min. 6500 m ²	
- Garazha, hangar dhe ndërtesa tjera për vendosjen e mjeteve dhe makinave bujqësore si dhe ndërtesa tjera ndihmëse bujqësore	Min. 800 m ²	bujqësore/blegtorale dhe qumështit > 7m.

Ndërtesat bujqësore të kategorisë II*		Deri 4000m ² dhe lartësi deri në 25 m dhe mbi 4000m ² ose lartësi 25m *
- Ndërtesa bujqësore, ferma dhe ndërtesa tjera përcjellëse për bagëti dhe shpezëtari, ndërtesa për ruajtjen e produkteve bujqësore të tilla si depo për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, pleme, hambar, ahur, bodrume të verës; - Garazha, hangar dhe ndërtesa tjera për vendosjen e mjeteve dhe makinave bujqësore si dhe ndërtesa tjera ndihmëse bujqësore		
Silose për nevoja të prodhimeve bujqësore	/	Kapacitet deri në 10000m ³ *
Banim	Deri në 500 m ²	P+1+Nk
*Në përputhje me Ligjin e ndërtimit Nr.04/L-110 /UA për kategorizimin e ndërtimeve		

Tabela 11. Kategoria e tokës

Kategoria e tokës			
I - IV		V - VIII	
IShZPK	ISN	IShZPK	ISN
/	/	50 %	0.5

- a) *Qasja në parcelë*: përputhet me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- b) *Distanca*: distanca në mes të objektit për banim dhe stallës së bagëtive duhet të jetë:
 - a. Minimum 50m' për shtallat që përdoren për konsum komercial
 - b. Minimum 15,00 m' për stllat që përdoren për konsum vetanak

Të gjitha aktivitetet tjera duhet të zhvillohen duke respektuar distancat nga resurset me rëndësi lokale dhe kombëtare dhe nga infrastruktura rrugore që janë të përcaktuara me ligjet përkatëse.

- c) *Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- d) *Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- e) *Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- f) *Formësimi arkitektonik dhe estetik*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Materialet e përdorura për ndërtimin e ndërtesave bujqësore preferohet të jenë nga konstrukcioni i drurit apo ai metalik. Kulmi të jetë dy uJORë i mbuluar me llamarinë të valëzuar.
- g) *Siguria nga zjarri*: përputhen me kushtet e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.
- h) *Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike*: para se të filloj zhvillimi në parcelë (objektet bujqësore) duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe publike.

- i) *Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta*: 1VP për 100m² të sipërfaqes së ndërtuar.
- j) *Bonuset e zonimit*: Autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor legjislacionet në fuqi si p.sh. Ligjin për tatimin në pronë i cili parasheh lirimin nga tatimi në pronë për pronarët që punojnë tokën bujqësore, apo dhe instrumente tjera. Do të ofrohen lehtësira nga komuna si rritja e ISN-së nëse është e nevojshme që për interesin publik të përdoret pjesë e tokës bujqësore nga Komuna për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe për shtrirjen e infrastrukturës së transportit dhe të shërbimeve publike.
- k) *Jonkonformitetet*: nëse në këtë zonë ekzistojnë zhvillime apo objekte të cilat zhvillohen apo janë ndërtuar pa pëlqimin dhe lejen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë si dhe të Komunës dhe të cilat nuk janë në harmoni me kërkesat e HZK-së ato do të jenë subjekt i “ngrirjes së zhvillimit” dhe duhet të trajtohen përmes programeve të veçanta apo ligjeve respektive. Për këto zhvillime/objekte komuna nuk ka detyrim të siguroj dhe të ofroj infrastrukturën rrugore dhe teknike dhe shërbimet.
- l) *Masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës bujqësore*: masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës bujqësore për ndarjen apo bashkimin e parcelave rregullohet me legjislacionet respektive në fuqi.




Figure 5. Harta e zonave bujqësore

6.0 Zona ekonomike – industriale dhe komerciale

Kjo zonë është e dedikuar për zhvillimin e ndërtesave për prodhimtari industriale⁸.

6.1 Sipërfaqet për industri sipas projeksioneve të HZK-së

Sipas PZHK-së përveç aktivizimit të ndërmarrjeve industriale dhe zhvillimit të zonave të tilla në pjesët tjera të komunës, është rekomanduar përcaktimi i zonave të vecanta për zhvillimin e veprimtarive industriale dhe komerciale, ku njëra nga ato lokacionet është edhe ai në vendbanimin rural Livadicë që i përket ndërmarrjes shoqërore Koperativa. Andaj edhe me HZK është rekomanduar që i njëjti lokacion të jetë zona ekonomike industriale dhe komerciale, kjo për arsye që Komuna e Podujevës e ka miratuar vendimin për shfrytëzimin e këtij lokacioni për qëllime ekonomike. Kjo zonë do të trajtohet me PRRH, mirëpo si aktivitet paraprak do të jetë studimi i fizibilitetit, dhe krahas hartimit të PRRH-së do të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis të aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë.

6.1.1 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: industri e lëndës së parë si prodhimet e drurit dhe produkteve me bazë të drurit, prodhimet e produkteve jometalike dhe minerale, prodhimi i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, shërbimet tregtare me shumicë, prodhimi i produkteve të metaleve bazine dhe metaleve të fabrikua si prodhimi i telave elektrik dhe prodhimi i produkteve prej gomës dhe plastikës.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: shërbim i logjistikës dhe magazinimit, shërbim administrativ dhe mbështetës, shërbim i komunikimit e informimit, shërbim teknik profesional dhe shkencor shërbim financiar dhe i sigurimit, rrjetet e transportit rrugor si dhe shërbime publike si infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, shpërndarjes së gazit, dhe energjisë termike elektrike,

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: infrastrukturë e telekomunikacionit (antena) e energjisë termike elektrike (trafostacionet).

Shfrytëzimet e përkohshme:

Shfrytëzimet e ndaluara: prodhim bujqësor komercial, dhe prodhim bujqësor për konsum vetjak, pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër, pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë, dhe pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, minierë e materialeve për prodhimin e energjisë, minierë e xeheve metaleve, dhe miniera dhe gurorë tjetër, akuakulturë dhe peshkim, gjueti dhe menaxhim i kafshëve shtegtare, prodhim i produkteve të tekstitit, i produkteve të letrës, produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, i produkteve kimike dhe fibrave, dhe i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, dhe i produkteve tjera të rënda, prodhimi rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, i pajisjeve elektrike dhe optike, dhe i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë si prodhim i energjisë bërthamore, i energjisë së bazuar në fosile, i energjisë së bazuar në biomasë, dhe i energjisë së ripërtëritshme, dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpia, i patundshmërisë, i akomodimit dhe ushqimit, dhe shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit, shërbim arsimor, shëndetësor dhe shoqëror, fetar, dhe shërbim tjetër i komunitetit, shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ, argëtues, infrastrukturë sportive, hapësire e hapur rekreative, dhe shërbim tjera rekreative, infrastrukturë e transportit ajror dhe ujor, shërbime publike si infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave dhe formë tjetër e infrastrukturës publike, banim i përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri dhe banim tjetër.

6.2 Kushtet zhvillimore

- a) *Dimensionet e parcelës, lartësia e objektit, intensiteti:* Dimensionet e parcelës varen nga lloji i industrisë dhe madhësia veprimtarisë që i shërben asaj industrie (qoftë një parcelë apo më shumë). Parcela duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar që nevojat aktuale

⁸Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

dhe të ardhshme mund të përmbushen.

Tabela 12. Dimenzionet e ndërtesave industriale poashtu varen nga lloji i industrisë dhe madhësia e veprimtarisë

Lloji i aktivitetit	Dimenzionet e parcelës		Lartësia				IShPKZh	SGJP	ISN	SNP
	min.	maks.	Kat / Lartësia		Minimale	Maksimale				
Ndërtesat industriale	2500 m ²	10000 m ²	1 kat	7 m	2 kate	12 m	50%	40%	0.5 – 1.0	50%
Ndërtesat tregtare me shumicë	1000 m ²	2500 m ²	1 kat	5 m	2 kate	8 m	50%	40%	1.0	50%

Duke ju referuar UA Nr.04/2017 për kategorizimin e ndërtimeve, ndërtesat industriale të mbuluara si fabrika, punëtori, thertore, birrari etj i përkasin kategorisë së II dhe madhësia e tyre mund të sillet deri në 400m² dhe mbi 400m².

b) Lartësia në raport me rrugën publike: nuk mund të jetë më e madhe se 1,5 L / 1 GJ, ku GJ është gjerësia e rrugës publike (distanca ndërmjet dy vijave rregulluese) dhe L është lartësia e ndërtesës.

Lartësia në raport me kufinj të e parcelës: Nuk mund të jetë më i vogël se 0.5 L / 1 GJ dhe më i madh se 2 L / 1 GJ, ku GJ- është distanca mes ndërtesës dhe kufiri të parcelës kadastrale dhe L është lartësia e ndërtesës. Kur pjerrësia e parcelës kadastrale është (8%) për qind ose më pjerrët, lartësia e specifikuar (L) kontrollohet me rrafshin 45° të ndriçimit natyror

c) Vijat:

Vija ndërtimore (VN) në rastet kur zona shtrihet përgjatë arterieve rrugore vija ndërtimore duhet të përcaktohet në përputhje me Ligjet rë rrugët. Vija rregulluese (VRr) duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese apo të planifikuar.

d) Qasja në parcelë: në përputhje me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Në këtë rast qasja nga rruga nacionale apo rajonale duhet të realizohet duke respektuar kushtet e përcaktuara me legjislacionit për rrugët të përmendur në seksionin zona e rrjetit të transportit.

e) Distanca: objektet industriale duhet të vendosen në lokacionet që do të jenë larg zhvillimeve fqinje, si dhe në distanca të përcaktuara me ligjet dhe aktet ligjore përkatëse nga monumentet natyrore e kulturore, dhe resurset natyrore, ashtu që të pengohet apo shmangët ndikimi negativ. Gjithashtu, distanca e këtyre objekteve nga infrastruktura e transportit hekurudhor, infrastruktura ekzistuese e telekomunikacionit, trajtimin e mbeturinave apo të ujësjellësit, ujërave të zeza dhe energjisë termike elektrike ekzistuese duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligje dhe aktelgjore të sektorëve përkatës. Objektet industriale nuk duhet të ndërtohen në afërsi të zonës së banimit, shërbimeve dhe hapësirave të hapura rekreative. Ndërtesat industriale duhet të jenë të larguara së paku 800m’ nga shkollat dhe qendrat shëndetësore.

f) Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuat disa kushte specifike të përcaktuara me ligjet përkatëse për të mbrojtur mjedisin përreth nga ndotja. Në mënyrë që të parandalohet ndotja duhet të krijohen brezat mbrojtës sanitar me gjerësi minimale 5m’.

g) Siguria nga zjarri: duhet të merren parasysh kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje

nga Zjarri.

- h) *Ndriçimi natyror dhe artificial*: Përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- i) *Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- j) *Kërkesat për efikasitet të energjisë*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- k) *Formësimi arkitektonik dhe estetik*: do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike për këtë zonë. Kërkesat shtesë përfshijnë:

- Objektet të jenë të ndërtuara nga materiali i fortë dhe i qëndrueshëm. Materialet duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës dhe duhet t'i përshtaten strukturës dhe karakterit të objektit dhe të përdoren elemente ndërtimi që janë karakteristike për zonën. Objektet industriale duhet ndërtohen nga konstrukcionet e betonit, çelikut, apo materialeve të reja bashkëkohore.
- Fasada duhet të ketë ngjyrë të nuancave të lehta; e preferueshme përdorimi i ngjyrave pastelesh, sipas paletës prezantuar në figurën e mëposhtme ose të ngjashme. Nuk lejohet përdorimi i ngjyrave që tërheqin vëmendjen dhe ngjyrave bazë, të cilat mund të jenë intensive (të papërziera me ngjyrat tjera apo shkallë të hirtë) ose të zbutura-akuarele (ngjyra bazë e zbutur me ngjyrën e bardhë).
- Ngjyra Pastelesh shifra RGB.

Tabela 13. Ngjyrat Pastelesh shifra RGB

61,120,125	151,177,176	84, 53, 81	155,99,76	242,223,180	192,109,105	201,208,174

- Dritaret dhe dyert duhet të jenë nga druri, PVC, alumini, çeliku. Nuk lejohet përdorimi i dritareve-pasqyrë dhe me ngjyrë;
- Kulmi duhet të jetë dy ujqor apo i rrafshët.
- Parcela duhet të jetë e rrethuar me rrethojë të lartësisë prej 2.2m' nga muri, metali apo çeliku.
 - l) *Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike*: para se të filloj zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike.
 - m) *Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta*: në këtë zonë duhet të planifikohet që për ndërtesë industriale të ketë 1VP/100m² të sipërfaqes bruto të ndërtuar dhe shërbimet tregtare për shitje me shumicë 4VP/100m² të hapësirës shitëse. Sa i përket parkingjeve për bicikleta, duhet të sigurohen brenda parcelës së çdo ndërtesë rreth 5 VP/100 m² të sipërfaqes bruto të ndërtuar.
 - n) *Masat mbrojtëse për mbrojtje*: nëse është e nevojshme zhvilluesi duhet të ndërmer masa për parandalimin e ndotjes së mjedisit, zhurmës apo rrezatimit të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit apo aktet tjera ligjore.
 - o) *Bonuset e zonimit*: /
 - p) *Jonkonformitetet*:




Figure 6. Harta Zona ekonomike – industriale/komerciale

6.3 Zonat turistike

Zona turistike janë sipërfaqet me vlera të mëdha natyrore, peisazhike, kulturore, sportive, shëndetësore, pushimi dhe rekreimi të cilat janë përcaktuar para së gjithash për zhvillim të turizmit.

6.3.1 Sipërfaqet për turizëm sipas projeksioneve të PZHK-së

Potencialet e shumta si gjeomorfologjia e territorit komunal e karakterizuar me dy masive malore si Kopaonikun dhe Gollakun, si dhe fushëgropa e Llapit së bashku me lumin Llap dhe liqenin e Batllavës, monumentet natyrore dhe ato kulturore, numri i madh i shërbimeve hoteliere i japin vlerë konkurruese komunës së Podujevës në Kosovë, që mund të jenë bazë për zhvillimin e turizmit vikendor dhe rural.

Andaj PZHK rekomandon mbrojtjen nga zhvillimet, si dhe zhvillimin e avancimin e këtyre potencialeve në mënyrë që të jenë më atraktive për vizitorët apo pushuesit në të gjitha tërësitë hapësinore. PZHK ka rekomanduar që në të gjitha tërësitë të krijohen kushte më të mira për zhvillimin e turizmit duke e përmirësuar dhe shtuar infrastrukturën e nevojshme dhe krijimin e shtigjeve për ngjitje të lehtë në male dhe ecje në sipërfaqet e tokës bujqësore duke përfshirë dhe lokacionet për pushim, për çiklizëm si dhe hapësirat e hapura rekreative dhe shërbimet hoteliere. Rekomandime të cilat janë përfshirë edhe në HZK. Për më tepër për shkak të rëndësisë kombëtare dhe vlerave të rëndësishme natyrore sipas PZHK – së është rekomanduar që për zonën e Liqenit të Batllavës të hartohet një plan i hollësishëm rregullues dhe të zbatohet me përpikëri. Andaj edhe me HZK në vendbanimin Orllan do të planifikohet zhvillimi i

zonës turistike ku do të jepen kushtet zhvillimore si bazë për planin e hollësishëm rregullues. Komuna aktualisht është në finalizim të strategjisë së zhvillimit të turizmit e cila ka përcaktuar pikat turistike dhe llojin e turizmit që zhvillohet ato. HZK ka marrë parasysh përcaktimet e këtij dokumenti.

6.3.2 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: shërbime akomodimi dhe ushqimi, banim i përhershëm e përkohshëm.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: shërbime tregtare me pakicë në funksion të kësaj zone si shitore ushqimi dhe për përpunimin dhe shitjen e produkteve artizanale, shërbime financiare dhe të sigurimit, infrastrukturë sporti, hapësirë e hapur rekreative, infrastrukturë e transportit rrugor si rrugë rajonale, lokale dhe e pakategorizuar si shtigjet për ngjitje në male, ecje dhe çiklizëm, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit, dhe energjisë termike elektrike, infrastrukturë ujësjellësit dhe ujërave të zeza.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: infrastrukturë e sportit si pishina, terrene të sportit, impiante të skive, infrastrukturë e telekomunikacionit dhe e energjisë termike elektrike (trafostacionet), shërbime argëtuese si parqe dëfruese për të rritur dhe fëmijë dhe teknik profesional dhe shkencor.

Shfrytëzimet e përkohshme: shërbime kulturore si festivale, panaire, etj, gjueti dhe peshkim rekreativ, dhe shërbime tregtare të shitjes me pakicë si pikat e shitjes së produkteve bujqësore dhe artizanale.

Shfrytëzimet e ndaluara: prodhim bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore, pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër, pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë, dhe pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, minierë e materialeve për prodhimin e energjisë, minierë e xeheve metaleve, dhe miniera dhe gurore tjetër, akuakulturë, menaxhim i kafshëve shtegtare, prodhim i produkteve të tekstilit, i produkteve të letrës, produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, i produkteve kimike dhe fibrave, i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuara, i produkteve prej gomës dhe plastikës, dhe i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, dhe i produkteve tjera të rënda, prodhimi rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, i pajisjeve elektrike dhe optike, dhe i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë si prodhim i energjisë bërthamore, i energjisë së bazuar në fosile, i energjisë së bazuar në biomasë, dhe i energjisë së ripërtëritshme, shërbim tregtar me shumice dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpia, i patundshmërisë, dhe shërbim tjetër tregtar, dhe shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit, shërbim arsimor, shëndetësor dhe shoqëror, fetar, dhe shërbim tjetër i komunitetit, infrastrukturë e transportit ajror, dhe ujqor, shërbime publike si infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave dhe formë tjetër e infrastrukturës publike, banim i përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri.

6.3.3 Kushtet zhvillimore

Kushtet zhvillimore do të jepen për këtë zonë ashtu si kërkohet me UA nr. 24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale, dhe UA nr. 08/2014 mbi Normat Teknike për Planifikim Hapësinor, mirëpo sipas nevojës ato do të plotësohen apo ndryshohen me Plan të Hollësishëm Rregullues.

a) *Dimensionet e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit:*

Tabela 14. Dimensionet e parcelës, lartësia dhe intensiteti i zhvillimit

Kategoria e objekteve hoteliere dhe turistike	Madhësia e parcelës ndërtimore për objekt turistik		Lartësia Kat/m		Intensiteti		
	minimale	maksimale	minimale	maksimale	IShPKZh	SGJP	ISN

Objekte hoteliere deri 7 njësi	500 m ²	1500 m ²	3 kat	10 m	4 kate	13 m	10-40%	80-50%	0.25-0.5
Bujtina/pensione deri 7 njësi	500 m ²	1000 m ²	3 kat	10 m	4 kate	13m	10-40%	80-50%	0.25-0.5
Vila banimi me qira	300 m ²	750 m ²	1 kat	3 m	1kat + NK	5 m	10-40%	80-50%	0.25-0.5

a) *Lartësia në raport me rrugën publike*: nuk mund të jetë më e madhe se 1,5 L / 1 GJ, ku GJ është gjerësia e rrugës publike (distanca ndërmjet dy vijave rregulluese) dhe L është lartësia e ndërtesës. *Lartësia në raport me kufinj të parcelës*: Nuk mund të jetë më i vogël se 0.5 L / 1 GJ dhe më i madh se 2 L / 1 GJ, ku GJ është distanca mes ndërtesës dhe kufiri të parcelës kadastrale dhe L është lartësia e ndërtesës. Kur pjerrësia e parcelës kadastrale është (8%) për qind ose më pjerrët, lartësia e specifikuar (L) kontrollohet me rrafshin 45° të ndriçimit natyror.

b) *Vijat*: Vija ndërtimore (VN) caktohet me Plan të Hollësishëm Rregullues.

Vija rregulluese (VRr) duhet të përputhet me profilin e rrugës ekzistuese apo të planifikuar, në të kundërtën përcaktohet me Plan të Hollësishëm Rregullues.

c) *Qasja në parcelë*: qasja në parcelë do të bëhet përmes shfrytëzimit të rrugës ekzistuese (kjo sepse zvogëlon shpenzimet për ndërtim të ri të rrugës për qasje) ose rrugës së planifikuar me PZHK / HZK dhe duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushte shtesë për çasjen dhe mënyrën e hyrjes në parcelë përfshijnë:

- Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje ndaj një rruge publike ose private në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose me anë të krijimit të një servituti kalimi në një parcelë fqinje;
- Gjerësia e hyrjes private në parcelë e cila nuk ka qasje direkte nga rruga publike nuk mund të jetë më e vogël se 2,5m;
- Hyrja në objekt parashihet në anën e objektit përdhësa e të cilit është në nivel ose pak e ngritur në raport me terrenin.

Në rastet e zhvillimeve të reja, kur ekziston mundësia e paraqitjes së problemeve të çasjes në parcelë si në vijim, atëherë mund të aplikohet këto kushte të veçanta:

- Zhvillim i ri apo zgjerimi i objekteve ekzistuese nuk duhet cënuar qasjen e papenguar në parcelat kadastrale fqinje;
 - Në rast se zhvillimi i ri propozohet në parcelë kadastrale e cila gjendet në mes të rrugës publike dhe parcelës fqinje nuk ka qasje tjetër në rrugë publike, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të krijojë një shteg me gjerësi së paku 3m' dhe lartësi së paku 4m' përgjatë kufirit të parcelës kadastrale nga rruga publike deri në kufirin e parcelës kadastrale fqinje që nuk ka qasjetjetër në rrugë publike;
 - Para se të filloj realizimi i zhvillimit të ri, pronari i tokës apo investitori duhet të ketë një marrëveshje me pronarin apo shfrytëzuesin e parcelës fqinje të cilit mund t'i cenohet e drejta e çasjes në parcelën e tij kadastrale;
- d) *Distanca*: për përcaktimin e distancave ndërmjet vilave dhe objekteve të shërbimit akomodues dhe ushqimor merren në konsideratë faktorët: i) orientimi, ii) gjendja e fqinjësisë dhe iii) kërkesat higjieno- sanitare. Për orientimin merret kusht bazë orientimi drejt jugut në kufijtë deri 40 gradë të tij, si dhe 3 orë diell në periudhën 22 mars–22 shtator. Për gjendjen e fqinjësisë mbahet parasysh krijimi i hapësirave të nevojshme funksionale ndërmjet ndërtesave. Për kërkesat higjieno-sanitare përfshihen kërkesat për ndriçim, diellzim dhe ajrim.

Distanca duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes

të ndërtesave.

Distanca e zhvillimeve nga Liqeni i Batllavës duhet të rregullohet sipas ligjeve dhe akteve ligjore përkatëse për zonat e mbrojtura të veçanta.

- e) *Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës*: përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përfshijnë:
- Sipërfaqja ekzistuese gjelbëruese në kuadër të zonës duhet të ruhet;
 - Në rast se në parcelat e zonës ku planifikohet zgjerim, gjenden pemë ato nuk duhet të priten por të zhvendosen apo të përfshihen në gjelbërimin e zonës.

Peisazhi duhet të mbroj karakterin dhe identitetin e vendbanimit rural, ashtu që si në objektet ashtu edhe hapësira publike duhet përdorur materialet dhe bimësia lokale. Nëse për shkaqe sigurie do të ndërmerren masa mbrojtëse nga erozioni dhe vërshimet, ato veprime duhet të kontribuojnë në peisazh. Sa i përket rrugëve ekzistuese dhe të planifikuara si dhe parkingjeve duhet të kenë brezat e gjelbërta të cilat mbrojnë nga ndikimet negative në mjedis por edhe kontribuojnë në përmirësimin e peisazhit të vendbanimit.

- f) *Siguria nga zjarri*: distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku $\frac{1}{2}$ e H së ndërtesës më të lartë. Kjo distancë minimale zbatohet për të gjitha llojet e ndërtesave në të gjitha zonat specifike, nën zonat, zonat mbishtresore dhe sipërfaqet rregulluese. Duhet të merren parasysh kushtet e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.
- g) *Ndriçimi natyror dhe artificial*: përputhen Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Duhet të sigurohet diellosje maksimale dhe mbrojtja nga erërat e forta. Ndërtesat e reja dhe rindërtimet duhet të sigurojnë përdorimin e ajrosjes natyrale dhe ndriçimit natyror si burim kryesor i dritës. Ndriçimi natyror dhe diellosja duhet të sigurohen përmes rregullit 45° në zonat me densitet të mesëm dhe të lartë të zhvillimit, ose ndërmjet dy zonave me densitet të ndryshëm të zhvillimit siç është përcaktuar me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Përmes këtij rregulli kontrollohet hijezimi i strukturave dhe pronave fqinje. Për përcaktimin e lartësisë së ndërtesave në raport me kufijtë e parcelës, në rast se pjerrësia e parcelës kadastrale është 8% ose më pjerrët, lartësia e specifikuar (L) kontrollohet me rrafshin 45° të ndriçimit natyror. Për planifikimin e distancave ndërmjet ndërtesave kriteri për diellosje është $\geq 2h$ diellosje gjatë ditës për kthina të banimit më datë 21 dhjetor. Ky kriter njëkohësisht plotëson edhe kriteret për ndriçim natyror dhe privatësi.
- h) *Kërkesat për efikasitet të energjisë*: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- i) *Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës*: për shmangien, parandalimin apo zvogëlimin e efekteve të dëmshme që vijnë si rezultat i ekspozimit të zhurmës sidomos nga trafiku HZK ka përcaktuar si vijon:
- Të gjitha zhvillimet /ndërtimet e ardhshme në zonat e banimit duhet të planifikohen, dizajnohen dhe të operojnë në mënyrë që të mos prodhojnë zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara të përcaktuara me legjislacionin në fuqi sipas parametrave në tabelën vijuese.

Tabela 15. Vlerat kufitare të burimit të zhurmës (dBA) nga trafiku rrugorë dhe hekurudhor

Vlerat kufitare të burimit të zhurmës (dBA)	Trafiku Rrugor		Trafiku hekurudhor	
	Ditën Ld	Natën Ln	Ditën Ld	Natën Ln
Zonat e banimit dhe vendbanimet e vogla	59	49	57	48

- Ndalohet kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera, në mënyrë që me zhurmë

pengohet qetësia dhe pushimi i njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga ora 22:00 – 07:00;

- Në vendbanime lejohet dëgjimi i zërimit të zileve ose pajisjeve elektroakustike nga ora 07:00 – 22:00, përjashtim bën zërimi i zilës ose pajisjeve elektroakustike, në kohën e riteve fetare si dhe në ditët e festive;
- Për zvogëlimin e efekteve të zhurmës nga rrugët me trafik më të lartë/ngarkuar në dy anët e rrugës të përdoren rende drunjësh, ndërsa tek vendbanimet që ndodhen përgjatë rrugëve regjionale me rend të dyfishtë;
- Kërkesa specifike për mbrojtjen nga ndotja e zhurmës, rrjedhin nga ligji për mbrojtje nga zhurma me aktet përcjellëse dhe dokumente respektive komunale si p.sh. harta strategjike e zhurmës nëse ka, plani lokal për veprim në mjedis.

k) *Formësimi arkitektonik dhe estetik*: do të përputhen me Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike për këtë zonë, si: formësimi i objekteve të banimit në përgjithësi, duhet të jetë në përputhshmëri me strukturat e mjedisit përreth (rrethinës), në aspektin e parametrave elementar të formës dhe parimit të organizimit fizik të rrethinës. Gjatë formësimit të objektit të banimit duhet marrë parasysh: thjeshtësia e proporcioneve dhe formës, përshtatshmëria e formës së objektit me topografinë e terrenit, përshtatshmëria me kushtet klimatike dhe përdorimit të materialeve dhe vegjetacionit autokton, përkatësisht zbatimit të parimeve: unitetit, ambientalizimit dhe kontekstualitetit të hapësirës. Kushtet për formësimin arkitektonik dhe estetik të objekteve të banimit, duhet të përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kërkesa specifike për këtë zonë. Cilësia dhe mënyra e ndërtimit të shtëpive duhet ti përshtatet nevojave të popullsisë dhe orientimit të tyre prodhues, përkatësisht amvisërive bujqësore, të përziera dhe jobujqësore. Materializimi i objektit duhet të respektojë karakteristikat/atributet e lokalitetit/zonës, përmes përdorimit të elementeve autoktone si dhe të materialeve bashkëkohore, ngjyra e së cilës, tekstura dhe parametrat tjerë vizual afirmojnë kualitetet mjedisore të planifikimit të zonës. Kërkesat shtesë përfshijnë:

- Objektet të jenë të ndërtuara nga materiali i fortë dhe i qëndrueshëm. Materialet duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës dhe duhet t'i përshtaten strukturës dhe karakterit të objektit dhe të përdoren elemente ndërtimi që janë karakteristike për zonën. Objektet duhet ndërtohen nga druri dhe guri.
- Fasada për objektet e përkohshme-vilat të jetë tërësisht nga druri apo kombinim i drurit, gurit dhe/apo tullës.
- Dritaret dhe dyert duhet të jenë nga druri, PVC me ngjyrë druri. Nuk lejohet përdorimi i dritareve- pasqyrë dhe me ngjyrë;
- Kulmi duhet të jetë dy ujqor apo më tepër, dhe nuk lejohet kulmi mastard.
- Gardhi / rrethoja të parcelat e zhvilluara preferohet të jetë nga druri apo kombinim dru me gurë me lartësi maksimale 1.2m dhe gjelbërim i lartë, dhe nuk do të lejohet gardhi me materiale tjera. Rrethoja e parcelave ndërtimore mes fqinjëve mund të bëhet me mur të gjallë (me gjelbërim) i cili

mbillet në boshtin e kufirit të parcelave ndërtimore. Në rastet ku mund të ketë edhe rrethoja të mundshme për objektet përbrenda parcelës së njëjtë ndërtimore (objektet ekonomike, kopshte, depo etj.), lartësia e rrethojës nuk guxon të kalojë lartësinë e rrethojës së jashtme. Hapja e dyerve në kuadër të rrethojës nuk duhet të jetë jashtë vijës rregulluese.

- Streha kërkohet të jetë 0.9 m;

- i) *Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike*: para se të filloj zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike.

m) Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: në këtë zonë duhet të planifikohen:

Tabela 16. Vend parkimet

Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes së ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) 100 m ²	
Vila banim me qira	3VP/njësi banimi	
Shërbime akomodimi	0.5VP/një shtrat	
Shërbime ushqimi	4VP/100m ² të sipërfaqes bruto të ndërtuar	5 VPB/ 100 m ² të bruto sipërfaqes se ndërtuar për vizitor
Shërbime tregtare	4VP/hapësirës shitëse	




Figure 7. Harta Zonat turistike

7.0 Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit

Rezervat minerare janë hapësirat të cilat përmbajnë përqendrim të rezervave specifike minerare të akumuluar, të cilat për nga sasia, cilësia dhe kushtet tjera, janë të përshtatshme për eksploatim. Në sipërfaqet e tilla mund të planifikohen ndërtesa të cilat janë mbështetje të këtij funksioni.

Fushat e eksploatimit janë zona në të cilat shtrihen burimet e rezervave minerare, të cilat janë të dedikuara për hulumtimin, kryerjen e punëve, përgatitjen, gërmimin dhe transportimin e lëndës së parë. Në zonat e fushave të eksploatimit planifikohen hapësira për deponimin e mbetjeve industriale, ndërtimin e ndërtesave të minierës si dhe të ndërtesave për strehim të përkohshëm. Në zonat për eksploatimin e lëndës së parë minerare gjithashtu planifikohet ri-kultivimi dhe rehabilitimi i terrenit.⁹

⁹UA Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor

7.1 Sipërfaqet minerare sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjisë nacionale

Territori i komunës së Podujevës është i pasur me resurse të shumta minerare ku prej tyre më të njohura janë mineralet që mund të përdoren si lëndë e parë ndërtimore në industrinë e ndërtimit si: Silikatet (sh), Karbonatet (ch), Zhavori (gs), Argjila (cl), pastaj, Nikeli (NI), Plumbi (Pb), Zinku (Zn), Alumini (Al), etj. Sipas Strategjisë Minerare të Kosovës 2012 – 2025 si paraqitje dhe vendburime të rëndësishme më parë të hulumtuara dhe vlerësuara janë Quka e Batllavës për mineralet metalore si Plumb (Pb), Zink (Zn) dhe Argjend (Ag), dhe Llapashtica e Epërme për minerale jo – metalore Argjilë.

Për zhvillimin e aktiviteteve për eksploitim të resurseve minerare nëntokësore apo sipërfaqësore sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të MMPH-së dhe MZHE-së respektivisht KPMM operatori ekonomik duhet të pajset me lejet dhe licencat përkatëse nga niveli qendror dhe lokal.

Komuna nuk duhet të lejoj zhvillimin e kësaj veprimtarie nëse operatori ekonomik nuk posedon licencën për operim nga autoritetet e lartpërmendura.

7.1.1 Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: minierë e xeheve metaleve dhe minierë dhe gurore tjetër.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: infrastrukturë e transportit rrugor dhe hekurudhor, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, shërbim i logjistikës dhe magazinimit dhe administrativ dhe mbështetës si zyre administrative dhe objekte në shërbim të këtij funksioni.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: në sipërfaqet e eksploitura lejohet rikultivimi i sipërfaqes në pajtueshmëri me ligjet respektive, vendosja e paneleve solare për prodhimin e energjisë së ripërtërishme (me panele solate) nëse plotësohen kushtet e veçanta dhe ato mjedisore, e të ngjashme.

Shfrytëzimet e përkohshme: infrastrukturë/hapësirë për mbeturina si deponi e përkohshme e mbeturinave. *Shfrytëzimet e ndaluara:* prodhim bujqësor komercial, infrastrukturë bujqësore, prodhim

bujqësor për konsum vetjak, pylltari e bazuar në rotacion të shkurtër, mesëm dhe gjatë, pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, akuakulturë, peshkim profesional, gjueti dhe menaxhim i kafshëve shtegtare, mbledhje e produkteve natyrore, prodhim tjetër parësor, prodhim i produkteve të tekstilit, i produkteve të letrës, produkteve të koksit, vajgurit dhe karburantit bërthamor, i produkteve kimike dhe fibrave, i produkteve të metaleve bazike dhe metaleve të fabrikuar, i produkteve prej gomës dhe plastikës, dhe i lëndëve tjera të para, prodhim i makinerive, i automjeteve dhe pajisjeve të transportit, dhe i produkteve tjera të rënda, prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit, i rrobave dhe lëkurës, botim dhe shtyp, i pajisjeve elektrike dhe optike dhe i produkteve tjera të lehta, prodhim i energjisë si prodhim i energjisë bërthamore, i energjisë së bazuar në fosile, i energjisë së bazuar në biomasë, dhe i energjisë së ripërtërishme, shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpia, i patundshmërisë, i akomodimit dhe ushqimit, dhe shërbim tjetër tregtar, shërbim financiar dhe i sigurimit, teknik profesional dhe shkencor, dhe shërbim tjetër profesional financiar dhe i informacionit, shërbim arsimor, shëndetësor dhe shoqëror, fetar, dhe shërbim tjetër i komunitetit, shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ, argëtues, infrastrukturë sportive, hapësire e hapur rekreative, dhe shërbim tjera rekreative, infrastrukturë e transportit ajror, dhe ujqor, infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave dhe formë tjetër e infrastrukturës publike, banim i përhershëm, banim me funksione të tjera në pajtueshmëri dhe banim tjetër.

Sipas UA Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor në zonat e rezervave minerare dhe të fushave të eksploimitit ndalohet planifikimi apo ushtrimi i ndonjë veprimtarie mbi shfrytëzimin e resurseve minerare në ndonjë sipërfaqe që:

- ndodhet 200m' ose më afër nga kufiri i një vendbanimi;
- ndodhet 250.0 m' ose më afër nga ndonjë shtëpi, ndërtesë e banuar ose përkohësisht e pabanuar;
- ndodhet 20m' ose më afër (në varësi nga pjerrtësia e lejuar e shpatit të shfrytëzimit e planifikuar

kjo në projektin e shfrytëzimit) nga ndonjë tokë e pastruar ose lëvruar, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore, ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur bartësi i licencës ose lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë;

- ndodhet 200m' ose më afër nga ndonjë pendë ose rezervuar;
- ndodhet 150m' ose më afër të ndonjë termocentrali, largpërçuesi (35 KË ose më lartë) ose lumi; Termocentrali duhet të jetë jo më afër se 150.0 m' ose jo më larg se 250.0 m' nga largpërçuesit nëse aktiviteti minerar zhvillohet pa minim;
- ndodhet 60 m' ose më afër nga ndonjë rrugë e sistemit kombëtar;
- ndodhet 100m' ose më afër nga varrezat;
- ndodhet 100m' ose më afër nga ndonjë monument antik ose kombëtar i mbrojtur me ligj; ose 500.0 m' ose më afër nëse përdoret eksploziv;
- ndodhet 500m' ose më afër ndonjë aeroporti ose pjese të zonës së sigurisë së aviacionit;
- ndodhet brenda ndonjë parku kombëtar ose komunal të mbrojtur me ligj;
- ndodhet 500m' ose më afër nga ndonjë ndërtesë e banimit ose institucionale dhe publike, nëse përdoret eksploziv.

7.2 Kushtet zhvillimore

- a) *Dimensionet e parcelës:* Madhësia minimale e parcelës për një objekt në funksion të veprimtarisë është 300 m².
- b) *Lartësia:* Numri i etazhave 1 kat me lartësi maksimale 3.5m.
- c) *Lartësia në raport me rrugën publike:* /
- d) *Lartësia në raport me kufinj të e parcelës:* /
- e) *Intensiteti*
 - ☑ IShPKZh – 50%, dhe SGJP – 40%
 - ☑ ISN – 0.5
- f) *Vijat:* /
- g) *Qasja në parcelë:* Duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.
- h) *Distanca:* /
- i) *Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave të gjelbër mbrojtës:* Përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme, por duke shtuar disa kushte specifike të përcaktuara me ligjet përkatëse për të mbrojtur mjedisin dhe natyrën përreth nga ndotja. Në mënyrë që të parandalohet ndotja duhet të krijohen brezat mbrojtës me gjerësi minimale 5m'.
- j) *Siguria nga zjarri:* Duhet të merren parasysh kushtet e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri.
- k) *Kërkesat për efikasitet të energjisë:* përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme
- l) *Formësimi arkitektonik dhe estetik:* Objekti i administratës duhet ndërtuar nga materiali ndërtimor si dru, gur, tulla, betoni, dritaret duhet të jenë nga PVC me ngjyrë të bardhë apo druri, kulmi duhet të jetë dy apo më shumë ujor, dhe parcela duhet të jetë e rrethuar me rrethojë metalike apo të drurit me lartësi 1.20 m' apo me gjelbërim i lartë.
- m) *Çasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike:* Para se të filloj zhvillimi në parcelë duhet të sigurohet qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike.
- n) *Parkingu për gjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta:* Të planifikohen 2VP/100 m².
- o) *Masat mbrojtëse për mbrojtje të mjedisit:* Nëse është e nevojshme zhvilluesi duhet të ndërmerr masa për parandalimin e ndotjes së mjedisit, zhurmës apo rrezatimit të përcaktuara me Ligjin 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit apo aktet tjera ligjore.

- p) Bonuset e zonimit: /
 q) Jonkonformitetet: /
 r) Me Ligjin Nr. 03/L – 163 për Miniera dhe Minerale, Nr. 04/L – 158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L – 163, Nr. 03/L – 025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Nr.03/L – 233 për Mbrojtjen e Natyrës përcaktohen masat dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së eksplotimit të resurseve minerale.




Figure 8. Harta Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksplotimit

8.0 Zonat e rrjetit të transportit

Kjo zonë është sipërfaqe ku shtrihet infrastruktura e transportit rrugor, hekurudhor, ajror dhe transport jo i motorizuar si dhe shërbime tjera mbështetëse.

8.1 Zona e rrjetit të transportit rrugor

Rrjetin e rrugëve e përbëjnë: a) Autoudha, b) Rrugët nacionale; c) Rrugët regjionale; d) Rrugët locale; e) Rrugët e pakategorizuara.

8.1.1 Sipërfaqet për transport dhe komunikacion sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjisë nacionale

Rrjeti rrugor në vendbanimet rurale

Në Komunën e Podujevës shtrihen rrugët e pesë kategorive duke filluar nga autoudha Prishtinë – Merdar, rrugët nacionale, rajonale, lokale si dhe ato të pa kategorizuara. Shtrirja e Rrugës nacionale, kryesisht në pjesën qendrore dhe jug-lindore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësire. Në tabelën në vijim do të paraqesim shtrirjen e rrugëve sipas gjatësisë në km dhe sipërfaqen e tyre në ha.

Tabela 17. Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë dhe Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive

Kategoria	Drejtimi	Gjatësia		Sipërfaqja			Tërësitë hapësinore		
		Km	%	A	B	total	AQ	NT	MP
Autoudha	Prishtinë – Merdar								
Rrugë Nacionale	Rruga nacionale N25	18.8	1.53	16.54	4.51	21.05	18.8	0.00	0.00
Rrugë rajonale	R129 Podujevë-Mitrovicë R128 Podujevë-Vushtri R126 Podujevë – Pollatë R125 Podujevë-Orllan R127 Podujevë -Perpelac	80.0	6.53	47.44	14.20	61.67	37.29	23.12	19.59
Rrugë lokale	Rrugët lokale në 78 vendbanimet përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve	370.1	30.21	166.40	63.10	229.50	181	59.1	130
Rrugë e pa kategorizuar	Rrugë në të gjitha lagjet e fshatrave dhe hapësirat ku zhvillohen aktivitetet socio-ekonomike	756.30	61.73	185.48	0	185.48	370	107.8	278.5
Total %		1225	100	415.86	81.84	497.70	607	190	428.1
		100					49.55	15.51	34.94

A - sipërfaqe të mbuluara me asfalt dhe zhavorr – ha
B – Sipërfaqe që shfrytëzohen për sinjalizim dhe hapësira tjera – ha

Sa i përket Rrugës nacionale N25 PZHK ka planifikuar një sërë aktivitetesh duke përfshirë zgjerimin e saj

me 4 korsi në segmentin nga rreth-rrotullimi ku përfundon Autostrada Ibrahim Rugova deri tek Hotel Besiana në një gjatësi prej 20km, rritjen e cilësisë së asfaltit nga kufiri me komunën e Prishtinës deri tek vendbanimi Merdar me gjatësi 18.8km, mirëmbajtjen e rrugës, rregullimin e anësoreve dhe trotuareve, sinjalizimin, kufizimin e aktiviteteve ekonomike përgjatë segmenteve rrugore sipas standarteve etj. Rrugët rajonale, sipas PZHK-së kanë nevojë për mirëmbajtjen e rregullt, rregullimin e trotuareve, zgjerimin e rrjetit rrugor, rregullimin e anësoreve, sinjalizimin, kufizimin e aktiviteteve ekonomike etj. Sa i përket Rrugëve Lokale PZHK rekomandon rregullimin e rrugës tranzit e cila do të ketë gjatësinë 2.45 km dhe do të lidh Rrugët rajonale R126 dhe R127 dhe mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara dhe atyre me mbulesë nga rëra dhe zhavorri, të cilat kryesisht shtrihen në tërësitë Malet dhe Peisazhet e Natyra dhe Turizmi. Gjithashtu dhe rregullimin e trotuareve, sinjalizimit, anësorëve si dhe aty ku është e nevojshme apo mungon shtrirjen e shtigjeve për transport jo të motorizuar përfshirë dhe shiritat e gjelbër. Duke pas parasysh që HZK planifikon plotësimin, dendësimin dhe konsolidimin e vendbanimeve kërkohet ndërtimi i rrugëve të reja lokale apo asfaltimi i rrugëve lokale (kryesore, përmbledhëse dhe rrugëve për qasje) ekzistuese brenda vendbanimeve rurale.

Rrugët e pa kategorizuara shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të vendbanimeve.

Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

Rrjeti rrugor në vendbanimin urban

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK/U, është konstatuar se ka pasur investime të mëdha në shtrirjen dhe përmirësimin e rrjetit rrugor. Aktualisht, duke ju referuar planifikimeve të nivelit qendror, është duke u punuar në zgjerimin e rrugës nacionale N25. Në të ardhmen planifikohet edhe ndërtimi i autoudhës Prishtinë-Merdar, traseja e saktë e së cilës nuk ka mundur të sigurohet nga Ministria e Infrastrukturës. Në hartë është prezantuar traseja tentative me disa të dhëna nga burime jo zyrtare.

Bazuar në kërkesat ligjore dhe Strategjisë Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 e Ministrisë së Infrastrukturës, me këtë HZK është përcaktuar hartimi i planit të transportit lokal, një iniciativë kjo e diskutuar edhe me donatëorë potencialë për përkrahje. Strategjia parasheh investime në mbrojtjen e brezit rrugor nga uzurpimet si dhe nga ndërtimet dhe kycjet ilegale në rrjet.

8.2 Transporti hekurudhor

8.2.1 Sipërfaqet për transport dhe komunikacion sipas projeksioneve të PZHK-së dhe strategjive nacionale

Me PZHK është paraparë rregullimi i sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat (Podujevë, Surkish, Siboc i Epërm, Lluzhan). Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK-së, ky veprim nuk është realizuar. Në bazë të dhënave nga INFRAKOS, planifikohet të vihet në funksion segmentit të rrjetit hekurudhor që kalon nëpër komunën e Podujevës, ku matjet gjeodezike kanë përfunduar, matjet gjeomekanike dhe projekti janë në proces. Me projektin e ri traseja e linjës do të mbetet e njëjta dhe do të shqyrtohen të gjitha 29 vendkalimet ekzistuese për mundësinë e vazhdimin të statusit vendkalim, eliminim të disa prej tyre, por dhe nëse është e nevojshme hapje të ndonjë vendkalimit (disnivele) të ri. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeçar i Ministrisë së Infrastrukturës, ka përcaktuar rindërtimin e linjës hekurudhore në drejtimet Podujevë-Prishtinë-Fushë Kosovë-Pejë si mundësi për të krijuar një linjë/degë, e cila i shërben aeroportit të Kosovës dhe organizimin e lidhjeve të mira përmes të cilave ofrohen shërbime të qëndrueshme për popullsinë. Ky projekt kap një shumë prej 290 000 000

eurosh. Strategjia promovon intermodalitetit autobus-hekurudhë për udhëtime të pasagjerëve si objektiv afatmesëm/afatgjatë, që do të finançohej me mjetet e planifikuara për përmirësimin e rrjetit hekurudhor dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve për udhëtarë. Infrastruktura ekzistuese hekurudhore edhe pse në gjendje jo të mirë, paraqet bazë të mirë për modernizimin e saj, e me këtë edhe për ofrimin e shërbimeve cilësore për transportin e udhëtarëve, në kombinim me linjat e autobusëve. Duke u nisur nga kjo, me HZK është propozuar hartimi i studimit të fizibilitetit për ndërtimin e Qendrës multimodale të transportit e cila do të përfshinte stacionin hekurudhor, të autobusëve, rrugën tranzit në afërsi të qendrës komunale për shmangjen e kalimit të automjeteve brenda saj, parkingjet, taxit, etj. Propozimi i INFRAKOS për sipërfaqen e tokës në pronësi të tyre përballë stacionit hekurudhor në Podujevë është që të ndërtohet një stacion i autobusëve, vendparkingjet për bicikleta, taksi dhe eventualisht edhe ndonjë shërbim tjetër transportues. Planet për shfrytëzim të patundshmërisë janë komerciale respektivisht dhënie me qera pas marrjes së pëlqimit për ushtrim të veprimtarisë nga Komuna e Podujevës. Studimi i fizibilitetit duhet të identifikojë ndikimin në transport dhe në shfrytëzimin e tokës, vlerësimin e kostove dhe përfitimeve dhe vlerësimin 'vlerës në para'. Studimi duhet të merr parasysh të dhëna të sakta të udhëtimeve në linjat ekzistuese ndërrurbane dhe parashikimet për numrin e shfrytëzuesve të ardhshëm. Strategjia poashtu parasheh Sigurimin e vendkalimeve në hekurudha përmes instalimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, eliminimin e ndërtimeve ilegale në brezin mbrojtës të hekurudhave.

8.2.2 Zonat e rrjetit të transportit- ajror

Në komunën e Podujevë ekziston aeroporti sportiv në Dumosh. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 e Ministrisë së Infrastrukturës, ka përcaktuar Renovimin e tij (renovimin e ndërtesave ekzistuese, rregullimin e pistës, vendosjen e një hangari të parapregaditur, rregullimin e rrethojës). Ky projekt është përfshirë në HZK. Vlera e tij është 2 000 000 euro dhe është planifikuar të finançohej nga buxheti i Kosovës.

8.3 Zona e rrjetit të transportit publik dhe transportit jo të motorizuar

Transporti publik në nivel lokal organizohet nëpërmjet autobusëve, kombi-busëve dhe automjeteve të tjera të transportit dhe është mjaft mirë i organizuar. Nga 78 vendbanime të komunës së Podujevës, 40 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, 21 nëpërmjet të kombi-busëve dhe 17 vendbanime nuk kanë transport publik. Në zonën urbane ndodhet stacioni i autobusëve, i cili nuk është në gjendje të mirë. Sipas PZHK-së kërkohet që të përmirësohet transporti publik ku qytetarët do të kenë qasje më të mire, dhe shtrirja e rrjetit të transportit dhe qasja e të gjitha vendbanimeve në të, përmirësimi në rritjen e komoditetit në mjetet e transportit publik, si dhe respektimin rigoroz të itinerareve.

Gjithashtu kërkohet rregullimi i shtigjeve për këmbësorë e çiklistë përfshirë edhe shiritat e gjelbër rrugor brenda vendbanimeve. Sipas raportit të vlerësimit të PZHK/U-së ka pasur pak investime në realizim të projekteve të tilla.

a4) Transporti publik

Në mënyrë që t'u ofrohet qytetarëve një qasje më e lehtë, qarkullim i sigurt dhe i rehatshëm rekomandohet shtrirja e rrjetit edhe në ato vendbanime ku mungon, rritja e komoditetit në mjetet e transportit publik dhe respektimi rigoroz i itinerareve.

a5) Transporti jo i motorizuar

Meqenëse tentohet drejt kompaktësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të zonës urbane por edhe të vendbanimeve rurale, promovohet ndërtimi dhe përdorimi i shtigjeve për transport jo të motorizuar sidomos brenda zonave të banimit. Brenda vendbanimeve duhet të inkurajohet përdorimi i transportit jo të motorizuar në mënyrë që të zvogëlohet ndikim negativ në mjedis, andaj aty ku është e mundur duhet ndërtuar shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta si dhe brezi i gjelbër sipas standardeve të parapara me UA Nr. 08/2017 mbi Normat Teknike për Planifikim Hapësinor.




Figure 9. Harta Zona e rrjetit të transportit

8.4 Zonat e shërbimeve publike- Infrastruktura teknike

Sipas Normave teknike të Planifikimit hapësinor, të cilat i referohen nomenklaturës HILUCS, në kategorinë e shërbimeve publike apo Infrastruktura teknike siç është e njohur me LPH hyjnë:

- **Infrastruktura e ujësjellësit dhe ujërave të zeza:** hapësira të shfrytëzuara për nxjerrjen, grumbullimin, ruajtjen, pastrimin dhe shpërndarjen e ujit dhe mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza (duke përfshirë edhe tubacionet);
- **Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike:** hapësira të shfrytëzuara për shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit dhe energjisë termike. Kjo klasë përfshin hapësirat për transportimin e naftës dhe gazit;
- **Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave:** Hapësira të shfrytëzuara për grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave (venddepozitimeve, djegjen e mbeturinave, kompostimin, trajtimin e mbetjeve të rrezikshme dhe ndërtesat e riciklimit);
- **Format tjera të infrastrukturës publike:** Hapësira të shfrytëzuara për infrastrukturë tjetër publike të pa përfshirë në kategoritë e mësipërme.

8.4.1 Infrastruktura e ujësjellësit, ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza

Sipërfaqet e infrastrukturës së ujësjellësit sipas PZHK-së

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK i bërë në vitin 2018, gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK ka pasur realizim të pjesshëm të projekteve për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Orllan dhe punohet në vazhdimësi në zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit. Sa i përket Kaptazhës “Vrella e Revuqit” në të cilin janë përfshirë gjashtë fshatra, është kryer një pjesë e rrjetit të ujësjellësit dhe projekti është ndërprerë, pra kaptazha dhe rezervuari nuk janë kryer. Sipas të dhënave nga Kompania Regjionale e Ujësjellësit “Prishtina”- NJOU në Podujevë, ka probleme në furnizimin e vendbanimeve me ujë nga burimi i Revuqit për shkak të pamundësisë së qasjes nga banorët e pronave përreth si dhe kapacitetit të ulët i cili verës bie deri në 7[l/sec] përderisa prurja maksimale është 35[l/sec] gjatë muajit Prill. Prandaj HZK propozon që të bëhet analiza dhe punimi i elaboratit për gjetjen e modaliteteve për shtimin e kapacitetit (qoftë në formë të burimeve shtesë apo tjetër) për plotësimin e nevojave të vendbanimit. Për Kaptimin e burimit “Vrella e Zhitisë” duhet të bëhet punimi i elaboratit hidrogjeologjik. KUR “Prishtina” ka informacion që potencial për furnizimin e banorëve me ujë është edhe një burim në fshatin Surkish dhe Sfeqël, përgjatë lumit Dumnicë si dhe në Murgull dhe Llapashticë. HZK ka lokalizuar këto burime dhe përcakton punimin e studimit të fizibilitetit dhe më pas të elaboratit hidrogjeologjik.

Normat e furnizimit të vendbanimeve, me sasinë e nevojshme ditore të ujit janë si në vijim:

- 1) Ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri:
 - për vendbanime ≥ 5001 - 20000 banor: ≥ 150 - 200 litra /banor;
 - për vendbanime < 5000 banor: ≥ 100 - 150 litra /banor.
- 2) Ujë për shfrytëzim për nevojat jo-konsumuese-rekreacion/ ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike (Sipërfaqet e gjelbra, rrugët dhe sheshet): 1.50 litër/m².

Duke ju referuar strategjisë së ujërave 2017-2036, kudo që është e përshtatshme dhe e aplikueshme, të aplikohen sistemet e qëndrueshme urbane të drenazhimit (SQUD) në veçanti në zonat e reja zhvillimore dhe gjatë renovimit të sistemeve ekzistuese të rrjetit.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i ujësjellësit, ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse si dhe infrastruktura rrugore në kuadër të së cilës shtrihen këto rrjete.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: / Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:/ Shfrytëzimet e përkohshme: / Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë në funksion të infrastrukturës gjegjëse.

8.4.2 Infrastruktura e ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza

Sipërfaqet e infrastrukturës së ujërave atmosferit dhe ujërave të zeza sipas PZHK-së

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK--së, gjatë vitit 2017-2018 ka pasur investime në realizimin e projekteve në këtë fushë. Fshatrat e thella në të cilat do të shtrihet rrjeti i kanalizimit janë: Zhiti, Pollatë, Kalaticë, Repë. Në fshatrat të cilat për shkak të numrit të vogël të popullsisë apo konfiguracionit të terrenit nuk mund të kyçen në rrjetin e kanalizimit do të organizohet sistemi i të vetëpastrimit të ujërave të ndotura me gropa septike individuale dhe kolektive me sistem.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i ujërave atmosferik dhe ujërave të zeza lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse si dhe infrastruktura rrugore në kuadër të së cilës shtrihen këto rrjete.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: / Shfrytëzimet e lejuara të veçanta:/ Shfrytëzimet e përkohshme: / Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë në funksion të infrastrukturës gjegjëse.

8.4.3 Infrastruktura e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike

Sipërfaqet e infrastrukturës së shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike sipas PZHK-së

Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK-së, ka pasur investime në projekte

për përmirësimin e rrjetit energjetik që përfshin rritjen e kapacitetit energjetik prej 10 kv në 20kv në vendbanimet e identifikuar në PZHK. Pa u realizuar kanë mbetur këto projekte: Përmirësimi selektiv në drejtimin Podujevë 2 dhe në drejtimin fshatrat 2, përmirësimi solid në drejtimin Podujevë 4, Podujevë 5 dhe drejtimi Sillosi. Këto projekte mbesin relevante prandaj do të përfshihen në HZK. Por përveç projekteve të lartpërmendura, sipas planit të tij "Zgjerimi dhe përforsimi i rrjetit distributiv" KEDS ka planifikuar një mori projektesh të reja, për të cilat komuna vec ka kryer procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale (shih vendimet e KK në kapitullin 2). Këto projekte përfshijnë:

- Punime në rrjetin energjetik në:
- Zonën Aktive Qendrore, duke përfshirë largpërçuesit në vendbanimet: Majac, Lluzhan, Godishnjak, Kunushec, Buricë, Gllamnik, Velikarekë, Obrançë, Peran, Livadicë, Shtedim, Surkish, Sfeqël, Dumosh, Shajkoc, Siboc i Epërm dhe i Poshtëm, dhe
- Qytetin e Podujevës.

Të gjitha këto vendbanime janë të kyçura në nënstacionin Podujevë 220/35/10 kV.

Janë planifikuar tri stabilimente të reja:

- Një në fshatin Llapashticë e Poshtme (SS1), një në fshatin Kunushec (SS2, stabiliment me një hyrje dhe katër dalje, dalja e katërt është furnizim alternativ për Kunushec (rrin e shkyçur), dhe një stabiliment në fshatin Sfeqël (SS3).
- Ndërtimi i trafostacioneve të reja në: nga 4 trafo në Obrançë dhe Llapashticë e Epërme; nga 3 trafo në Dumnicë të Poshtme, Metehi, Bradash, Lupç i Poshtëm; nga dy trafo 2 në Podujevë, Dobratin, Surkish, Sfeqël, Velikarekë; nga një trafo në: Balloc, Batllavë, Tërrenavë, Halabak, Kërpimeh, Kaçybeg, Lladoc, Llaushë, Zakut, Dyz, Gërdoc, Brainë, Dobratin, Gllamnik.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të brezit përgjatë të cilit shtrihet rrjeti i energjisë termike elektrike në drejtimet e përcaktuara me plan lejohen shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të këtyre përmbajtjeve si dhe vendosja e rrjetit të telekomunikimeve.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: /

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: /

Shfrytëzimet e përkohshme: /

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë nuk janë të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara.

8.4.4 Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave

Sipërfaqet e infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave sipas PZHK-së

PZHK ka përcaktuar shtrirjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në tri nënqendrat: Kërpimeh, Lluzhan dhe Orllan dhe krahas grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht DUMM duhet të aplikojë masat ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Plani poashtu i referohet edhe largimit të deponive ilegale. Sipas vlerësimit të zbatimit të PZHK gjatë dy viteve të zbatimit të PZHK-së, ka pasur investime në teknologji për grumbullimin e mbeturinave. Sipas Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave (PLMM) për periudhën 2017-2022, ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në komunën e Podujevës do të trajtohet sipas prioriteteve të prezantuara në tabelën e mëposhtme. Numri i deponive ilegale aktualisht është 30 në gjithë territorin e komunës të lokalizuara në hartë. Veprime të rëndësishme nga aspekti hapësinor që PLMM ka paraparë përfshijnë:

- Funkcionalizimi i deponive për depozitimin dhe asgjësimin e mbeturinave inerte;
- Caktimin e pikave për grumbullimin e mbeturinave voluminoze, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura;
- Identifikimi i mundësisë për asgjësimin e mbeturinave spitalore në nivel rajonal ose brenda spitalit;

- *Largimi i deponive ilegale;*
- *Sigurimi i deponive duke i rrethuar me gardh pas pastrimit të tyre, për të evituar rikrijimin e tyre. Pas pastrimit të tyre dhe rrethimit me gardh, komuna mund të vendosë që këto zona t'i kthejë në zona rekreative, si gjelbërimi i tyre duke i mbjellë me barë.*

Tabela 18. Zonat funksionale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës (burimi: Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2017-2022 dhe azhurnuar nga të dhënat e fundit)

Zona	Njësia	Nr.i popullsisë	Nr.amvisërive me shërbim pa shporta	Nr.i amvisërive në të ardhmen
Zona A Prioritet 1	Bajçinë, Bellopojë, Bradash, Dobërdol, Dumosh, Gllamnik, Halabak, Kërpimëh, Kunushec, Letanc, Lupi Poshtëm, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Obrançë, Peran, Podujevë, Sfeqël, Surkish, Shajkovic, Shtedim, Katunisht, Zakut	57638	5290	3674
Zona B Prioritet 2	Ballovc, Batllavë, Buricë, Dobratin, Dumnicë e Epërme, Gërdoc, Godishnjak, Kaçybeg, Livadicë, Lladoc, Llaushë, Llugë, Lluzhan, Majac, Merdar, Metehi, Orllan, Penuhë, Pollatë, Radujevc, Repë, Revuq, Sallabajë, Siboc i Epërm, Shakovicë, Tërnavë	22182	1125	2188
Zona C Prioritet 3	Bërvenik, Bllatë, Brecë, Dvorishtë, Hërticë, Metergoc, Muhazob, Murgull, Potok, Rakinicë, Sllatinë, Surdull, Sylevicë, Tërnavicë, Turiçicë	8769	196	982
Totali		88598	6611	6844

Komuna organizon, grumbullon, trajton dhe rregullon organizimin dhe mënyrën e veçimit të mbeturinave për riciklim sipas dispozitave ligjore si dhe në përputhje me planin lokal të saj. Mbeturinave të rrezikshme (eksplozive, oksiduese, shumë të ndezshme dhe ato të ndezshme, toksike, etj) dhe ato speciale grumbullohen dhe transportohen si të veçuara; transporti bëhet me mjete adekuate.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Në kuadër të sipërfaqeve ku planifikohet depozitimi dhe asgjësimi i mbeturinave inerte, mbeturinave voluminoze, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura si dhe mbeturinave spitalore lejohen vetëm shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të përmbajtjeve gjegjëse.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: objekte të përkohshme mirëmbajtëse

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: /

Shfrytëzimet e përkohshme: /

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë nuk janë të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara apo të lejuara të veçanta.

8.4.5 Format tjera të shërbimeve publike- rrjeti i telekomunikimeve

Sipërfaqet e infrastrukturës së rrjetit të telekomunikimeve sipas PZHK-së

Për shtrirjen e rrjetit të telefonisë mobile dhe internetit në gjithë territorin e komunës, PZHK i referohet bashkëpunimin të ngushtë me operatorët e telefonisë mobile në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve duke ofruar paketa stimuluese, si dhe duhet të ndërmerret një

kampanjë për informimin e qytetarëve për mundësit e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre (vendosja e antenave individuale në lokacione të ndryshme të komunës sidomos vendbanime më të thella malore). Në qendrat sekondare të Kërpimëh dhe Orllan janë paraparë nga minimum dy foltore publike telefonike, mirëpo për shkak të teknologjisë aktuale këto nuk shihen si projekte të rëndësishme.

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara: Shtrirja e rrjetit kabllor të telefonisë, internetit dhe rrjetit kabllor të televizionit, mund të bëhet në kuadër të rrjetit të energjisë termike elektrike (e preferueshme si rrjet nëntokësor), në shiritin e gjelbërimit të rrugës respektivisht në sipërfaqet publike, kurse në rrugët me profil të ngushtë edhe nën trotuare.

Në kuadër të sipërfaqeve ku do të vendosen antenat transmetuese të PTK, internetit dhe RTV lejohen shfrytëzime dhe stabilimente që janë në funksion të këtyre përmbajtjeve.

Shfrytëzimet e lejuara dytësore: /

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta: Në kuadër të sipërfaqeve ku do të vendosen antenat transmetuese të PTK, internetit dhe RTV shfrytëzime të lejuara sipas kushteve të veçanta në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës lejohet: banimi, shfrytëzimi i përzier, bujqësia, pylltaria.

Shfrytëzimet e përkohshme: /

Shfrytëzimet e ndaluara: Të gjitha shfrytëzimet që nuk janë nuk janë të përfshira tek shfrytëzimet e lejuara apo të lejuara të veçanta.

8.6 Kushtet zhvillimore

a) Dimensionet e parcelës, b) lartësia e ndërtesës (H) dhe c) intensiteti i zhvillimit

Tabela 19. Madhësitë e parcelës për objektet e shërbimeve publike-infrastrukturës teknike

Nënkategoritë e zonës së shërbimeve publike-infrastruktura teknike		a) Dimensionet e parcelës b) lartësia e ndërtesës (H) c) intensiteti i zhvillimit
Infrastruktura e ujësjellësit	Kaptazha e ujit të papërpunuar Stacionet e pompimit Fabrikat për përpunimin e ujit Rezervuarët e ujit të pijshëm	Varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoren
	Rrjeti i ujësjellësit- primar, sekondar dhe terciar	/
Infrastruktura e ujërave të zeza	Galeritë e kullimit	Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të zeza
	Stacionet e pompimit për largimin e ujërave të tepërta Drenazhet Kolektorët për pranimin dhe transportin e ujërave të zeza Deponitë për materiet e ndotura Fabrikat (impianetet) dhe pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza Zonat e shkarkimit të ujërave të trajtuara	duhet të planifikohet në parcela kadastrale zhvillimore mesatare nga 5- 10 ha
	Rrjeti i kanaleve kryesore dhe dytësore	/

	Gropat septike (GS)	Madhësia e GS varet nga kapaciteti i shfrytëzuesve: -min.3000l (shtëpi individuale) -min.5700l (grup shtëpish) -19000l për obj.fabrikuese
Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë termike elektrike	Stacionet transformuese të të gjitha niveleve	Varen nga kapaciteti, pajisjet dhe lloji i teknologjisë që do të përdoren
	Linjat nëntokësore dhe mbitokësore Rrjeti i tensionit të lartë/ sistemi i transmisionit Rrjeti I tensionit të ulët/ sistemi i shpërndarjes	/ / /
Infrastruktura për trajtimin e mbeturinave	Fabrikat për trajtim të mbeturinave Deponitë për mbeturina -deponi për mbeturinat jo të rrezikshme -deponi të mbeturinave inerte	Infrastruktura e ndërtesave për trajtimin e mbeturinave duhet të planifikohet në parcela kadastrale zhvillimore të rregulluara në bazë të kapacitetit dhe legjislacionit sektoral nëfuqi.

d) Vijat,

e) Qasja dhe vendosja e objektit në parcelë dhe

f) Distancat Infrastruktura e ujësjellësit duhet të planifikohet si në vijim:

- 2m' nga vija ndërtimore, në rrugët me gjerësi 7m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.5m';
- 1.5m' nga vija ndërtimore, në rrugët me gjerësi 6m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1m';
- trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1m'.

Infrastruktura e ndërtesave ose pajisjeve për trajtimin e ujërave të zeza, duhet të planifikohet si në vijim:

- 6.6m' në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 7m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.5m¹⁰;
- 6m' në largësi nga vija ndërtimore, në rrugë me gjerësi 6m' dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m;
- trasohet në kuadër të njërit shteg për këmbësor përgjatë rrugës, në rrugët me gjerësi 5.00 m dhe shteg për këmbësor përgjatë rrugës me gjerësi 1.00 m.
- në afërsi dhe në drejtim të rrjedhës së jashtme të lumit me qëllim të shkarkimit të ujërave të trajtuara;
- në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- në lokacione jashtë vendbanimeve, dhe të izoluara nga vendbanimet;

Për organizimin e sistemit të largimit të ujërave të zeza përmes gropave septike individuale dhe kolektive me sistem të vetëpastrimit të ujërave të ndotura në vendbanimet më të thella (kodrinoro- malore) me

¹⁰Në referencë të UA për normat e planifikimit hapësinor: *Shënim: Në rast të pa-mundësisë së plotësisht të ndonjërit nga kriteret e kërkuar me sipër, autoriteti përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor është i obliguar të paraqesë alternative, në konsultim me autoritetin përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti.

numër më të vogël të banorëve duhet të mirren parasysh këto kushte:

- sistemi i përzgjedhur për trajtimin e mbeturinave të jetë në ngastrën vetjake;
- sistemi të jetë ekologjik dhe të mos shkaktojë bezdi për fqinjësinë dhe t'i respektojë kushtet sanitare dhe ekologjike;
- largësitë mes pusetave duhet të respektojnë kushtet për të mundur qasje dhe mirëmbajtje të lehtë.

Linjat mbitokësore dhe nëntokësore të rrjetit të energjisë elektrike, duhet të planifikohen:

- në bazë të vlerësimit të ndikimit të fushës magnetike dhe elektrike të krijuar nga rrjeti i linjave mbitokësore;
- në largësi nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, me përjashtim të ndërtesave industriale të rezistueshme ndaj djegies:
 - 40 m nga autoudhat
 - 20 m nga rrugët nacionale
 - 10 m nga rrugët rajonale dhe lokale
- për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët kallkan të ndërtesës, nuk ka kufizim;
- për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët e fasadës së ndërtesës (ballkon, lozhë, dritare, verandë) nuk duhet të jetë më e vogël se 2.00 m;
- për linjat nëntokësore, largësia ajrore e linjës duhet të jetë jo më e vogël se 1.00 m nga vija ndërtimore.

Deponitë e mbeturinave:

Duhet të planifikohen në lokacione si në vijim:

- në gryka të rrethuara me shpatina, sipërfaqe që kanë shërbyer për eksploatim, apo në lokacione të rrafshëta;
- në largësi nga kufiri i zonës neutrale, që rrethon deponitë deri tek shfrytëzimet në vijim:
 - nga rrjetet elektrike: 100 m;
 - nga infrastruktura hekurudhore: 100 m;
 - nga ndërtesat e banimit: 500 m;
 - nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze: 600 m;
 - nga shtretërit e lumenjve dhe brigjet e liqeneve: 1000 m;
 - nga vendbanimet: 1500 m;
 - nga burimet e ujit dhe ujësjellësit dhe spitalet: 2000 m;
 - nga spitalet: 2000 m;
 - nga infrastruktura ajrore: 4000 m. Nuk duhet të planifikohen në lokacione si në vijim:
- në zonat e rrezikuara nga erozioni;
- në zonat e rrezikuara nga vërshimet apo të vërshuar në 25 vitet e fundit;
- në zonat me shkallë të lartë të rrezikshmërisë sizmike;
- në zonat me pjerrtësi të thukët;
- në zonat ku ujërat nëntokësorë janë afër sipërfaqes së tokës;
- në zonat me pasuri minerale dhe minimet;
- në zonat me përdorim intensiv të bujqësisë;
- në zonat ku rrezikon llojet e veçanta të florës dhe faunës;
- mbi strehimore apo tunele nëntokësore;
- në zonat ku distanca nga fundi i deponisë deri tek niveli ujërave nëntokësore gjatë sezonit është < 2.00 m;
- në zonat ku përshkueshmëria e tokës është > 0,00001 cm/s.

g) Rregullat për zhvillim peisazhor dhe shiritave mbrojtës të gjelbërimit: përputhen me ato të dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

h) Kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial: kushtet për kërkesat dhe dizajni i ndriçimit natyror dhe artificial përputhen me ato të dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme. Kushtet e veçanta përcaktohen sipas normave apo rregulloreve të ligjeve respektive për ndërtesat e këtij shërbimi.

i) Kërkesat për zvogëlimin e zhurmës: të gjitha zhvillimet /ndërtimet e ardhshme në këto zona duhet të planifikohen, dizajnohen dhe të operojnë në mënyrë që të mos prodhojnë zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për zonat e tilla.

Ndalohet kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera, në mënyrë që me zhurmë pengohet qetësia dhe pushimi i njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga ora 22:00 – 07:00. Kërkesa specifike për mbrojtjen nga ndotja e zhurmës, rrjedhin nga ligji për mbrojtje nga zhurma me aktet përcjellëse dhe dokumente respektive komunale si p.sh. harta strategjike e zhurmës nëse ka apo plani lokal për veprim në mjedis.

j) Kërkesat për efikasitet të energjisë: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

k) Formësimi arkitektonik dhe estetik: përputhen me kushtet e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe sipas rregulloreve të ligjeve respektive.

l) Siguria nga zjarri: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme dhe legjislacionit përkatës.

m) Qasja në infrastrukturën rrugore dhe teknike: përputhen me kushtet dhe rregullat e dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

n) Parkingu përgjatë rrugës dhe parkingjet e përbashkëta: kushtet për vendparkim në kuadër të këtyre zonave përputhen me ato të dhëna në kapitullin Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme.

o) Bonuset e zonimit: bonuset e zonimit do të përdoren nga komuna për të intervenuar në shpronësimin apo kompensimin e pronës private në mënyrë që këto hapësira të kenë pronësi publike. Autoriteti përgjegjës komunal mund të përdor bonuset e zonimit për ofrimin e shërbimeve publike p.sh. për sigurimin e parcelës për ndërtesat e tilla dhe të gjitha përmbajtjeve të tyre përcjellëse.

p) Jonkonformitetet: /




Figure 10. Harta Zonat e shërbimit publik-infrastruktura teknike

9.0 - SWOT ANALIZA

Pas përfundimit të profilit komunal, ku janë përshkruar në mënyrë shumë konkrete të gjitha fushat tematike me të dhëna dhe analiza, është bërë edhe SWOT analiza. Kjo metodë e analizës në planifikim shërben për identifikimin e të gjitha përparësive dhe mundësive që ka komuna dhe në anën tjetër të gjitha dobësitë dhe rreziqet. Analiza pra shërben që në të ardhmen, gjatë procesit të hartimit të planit komunal të shikohen mundësitë për shfrytëzimin e të gjitha përparësive dhe mundësive që ka komuna dhe në anën tjetër, do të tentohet që dobësitë dhe rreziqet të evitohen apo të minimizohen.

9.1 Sfidat e identikuara

Bazuar në gjendjen ekzistuese (profilin) komunale janë identifikuar sfidat kryesore si çështje më të theksuara me të cilat aktualisht përballet komuna e Podujevës. Sfidat me të cilat përballet komuna e Podujevës janë:

1. Shërbime jo cilësore administrative
2. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve në arsim dhe shëndetësi
3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë
4. Shpërngulja e popullsisë nga viset rurale-kryesisht i brezit kufitar
5. Mungesa e qendrave sekondare dhe infrastrukturës urbane
6. Ndotja dhe degradimi i mjedisit
7. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
8. Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e pa kontrolluara
9. Ekonomi e pa zhvilluar dhe jo e balancuar
10. Infrastrukturë jo cilësore dhe e pa mjaftueshme

Sfida 1. Nivel i pakënaqshëm në administratë

Shërbimet administrative në komunën e Podujevës nuk janë në nivel të kënaqshëm.

Sfida 2. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve në arsim dhe shëndetësi

Përkundër investimeve të konsiderueshme në komunën e Podujevës, gjendja fizike e objekteve arsimore dhe shëndetësore nuk e arriti nivelin e dëshiruar. Njëkohësisht mungojnë pajisjet teknike për arsim dhe shëndetësi. Në disa vendbanime paraqitet si problem mungesa e hapësirës shkollore, derisa në shëndetësi paraqitet mungesë e kuadrit të kualifikuar.

Sfida 3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë

Në komunën e Podujevës ekziston shkallë shumë e lartë e papunësisë dhe varfërisë. Sipas të dhënave del se shkalla e papunësisë është rreth 45 %. Papunësia më e lartë është e shprehur te grup moshë e re e popullsisë 15-24 vjeç (66.67%). Krahas shkallës së lartë të papunësisë paraqitet edhe shkallë mjaft e lartë e varfërisë në komunën e Podujevës. Të dhënat tregojnë për një përqindje të lartë të varfërisë së përgjithshme në komunë që sillet rreth 70 %, ndërsa shkalla e varfërisë ekstreme arrin në rreth 17 % të popullsisë së përgjithshme.

Sfida 3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë

Në komunën e Podujevës ekziston shkallë shumë e lartë e papunësisë dhe varfërisë. Papunësia është e shprehur sidomos te grup moshat e reja. Krahas shkallës së lartë të papunësisë paraqitet edhe shkallë mjaft e lartë e varfërisë. Të dhënat tregojnë për një pjesëmarrje të lartë të varfërisë së përgjithshme dhe të asaj ekstreme.

Sfida 4. Shpërngulja e popullsisë nga viset rurale-kryesisht i brezit kufitar

Ekzistojnë disa vendbanime në komunën e Podujevës që shtrihen në pjesë të thella kodrinore-malore, brezin kufitar dhe me mungesë të infrastrukturës së nevojshme. Vendbanimet e tilla, për shkak të kushteve të vështira, pasigurisë për jetës, larg qendrës urbane dhe shërbimeve të tjera të nevojshme po zbrazen vazhdimisht.

Sfida 5. Mungesa e qendrave sekondare dhe infrastrukturës urbane

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme urbane si dhe mungesa e qendrave sekondare paraqet vështirësi në realizimin e kërkesave të qytetarëve.

Sfida 6. Ndotja dhe degradimi i mjedisit

Problemet mjedisore janë prezent pothuaj se në tërë territorin e komunës. Shfrytëzimi i pa kontrolluar dhe pa plan i mjedisit po përcillet me probleme të natyrave të ndryshme. Shfrytëzimi i inerteve dhe pyjeve ndikojnë negativisht në mjedis dhe ambientin shoqëror.

Sfida 7. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Komuna e Podujevës është e pasur me trashëgimi natyrore dhe kulturore, mirëpo kujdesi jo i mjaftueshëm ndaj tyre po ndikon në degradimin e saj.

Sfida 8. Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e pa kontrolluara

Ndërtimet po ndikojnë në shoqëri dhe mjedis në shumë mënyra- shkatërrimi i zonave të gjelbra, shfrytëzimi i tokës bujqësore të kategorisë II-IV, deformimi i linjave të ndërtimit dhe uzurpimin pronës publike etj.

Sfida 9. Ekonomi e pa zhvilluar

Konsiderohet se shkalla e papunësisë në komunë e Podujevës është shumë e lartë. Kjo tregon edhe për gjendjen e mirëqenies njerëzore në këtë komunë duke shprehur rëndimin më negativ që ka komuna e Podujevës. Gjithashtu edhe të ardhurat për kokë banori janë të vogla për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, pagave të vogla si dhe familjet me shumë anëtarë kushtëzojnë të ardhura të vogla në Komunën e Podujevës.

Sfida 10. Infrastrukturë jo cilësore dhe e pa mjaftueshme

Në infrastrukturë arritjet janë të dukshme, mirëpo akoma mbetet shumë punë për tu bërë. Qasja e popullsisë në rrugë të kualitetit të lartë, rrjet të kanalizimit, shërbime të internetit, në valët e TV-së kombëtare, etj, të gjitha këto arritje po reflektohen në standardin jetësor të qytetarëve.

9.2 Vizioni për komunën e Podujevës

Bazuar në të dhëna dhe nga situata ekzistuese e komunës së Podujevës, analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve, është përcaktuar edhe vizioni për të ardhmen e komunës. Ky vizion përqendrohet kryesisht në zgjidhjen apo minimizimin e problemeve kryesore me të cilat përballet komuna e Podujevës.

Qëllimet janë mjaft të qarta dhe të dallueshme sipas fushave të ndryshme. Përmes realizimit të këtyre qëllimeve, njëkohësisht jepen edhe zgjidhje edhe për sfidat që janë identifikuar më parë.

Vizioni për komunën e Podujevës parashih zhvillime konkrete dhe të realizueshme siç janë:

- Përmirësimi i shërbimeve administrative
- Zhvillim të harmonizuar ekonomik dhe social
- Mundësi punësimi dhe zvogëlim të shkallës së varfërisë
- Sistem më të avancuar arsimor dhe shëndetësor
- Planifikim të ndërtimeve dhe infrastrukturë adekuate
- Shfrytëzim racional të mjedisit
- Mbrojtje të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Në të gjitha këto fusha ekzistojnë probleme të theksuara të cilat do të gjejnë zgjidhje në të ardhmen. Këto fusha janë të përfshira në formë të qëllimeve të përgjithshme, por te pjesa e qëllimeve do të përshkruhem më konkretisht edhe synimet si veprime më specifike që duhet të arrihen.

9.3 Strategjia e Zonimit komunal

Harta Zonale për komunën e Podujevës përmban strategjinë, përmes së cilës do të realizohet vizioni për të ardhmen e komunës si dhe do të arrihen synimet dhe objektivat e parapara gjatë procesit të

planifikimit. Strategjia përfshin masat dhe veprimet që do të ndërmerren në të ardhmen për ta realizuar një zhvillim më kompakt dhe të qëndrueshëm të komunës së Podujevës. Propozimet që janë dhënë në këtë strategji, janë parashikime që do të realizohen në periudhën kohore deri në vitin 2027. Të gjitha propozimet që përmban kjo fazë janë të arritshme dhe shprehin nevojat e qytetarëve të komunës.

Përmes kësaj strategjie, arrihet një zhvillim efikas në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës etj. Strategjia parasheh avancim të administratës komunale, të arsimit dhe shëndetësisë. Gjithashtu kjo strategji do të mundësoj krijimin e hapësirave të mjaftueshme rekreative për periudhat e ardhme kohore. Kërkesat për ndërtime të reja do të plotësohen duke bërë ndërtime të planifikuara, por njëkohësisht duke e mbrojtur mjedisin, me një përkujdesje të veçantë ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Element mjaft i rëndësishëm është edhe arritja e një zhvillimi të harmonizuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, ku bujqësia dhe aktivitetet tjera ekonomik do të jenë më të avancuar se që janë sot. Për ta realizuar zhvillimin e dëshiruar ekonomik, do të krijohen kushte më të mira për investitor dhe infrastruktura të jetë e përshtatshme dhe bashkëkohore.

9.4 Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor

Synimi 1. Parandalimi dhe largimi i mbeturinave në trupat uJOR dhe mjedisë tjera

Hapësirat mjedisore të pa shfrytëzuara të cilat janë prona jo private shfrytëzohen pa kritere për deponimin e mbeturinave si në masat tokësore dhe ato të trupave uJORë.

Sfera mjedisore paraqet disa prej sfidave më të rëndësishme me të cilat duhet të përballet komuna.

Vlerësimet e bëra në fazën e par të profilit rezultojnë me probleme të shumta mjedisore ku deponimi i mbeturinave ilegale ka në mjedisë të shumta në hapësirë si rezultat i mos efikasitetit dhe mungesës së sistemit për grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë dhe atyre industriale .

Janë evidentuar një varg çështje të cilat kanë ndikuar në mjediset të cilat janë tani me deponime të mbeturinave e që komuna duhet nderuar hapa konkret në zgjedhjen e këtyre problemave .

- Kapacitetet për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve janë të pamjaftueshme
- Nuk ka traditë të trajtimit dhe hedhjes së përshtatshme të mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;
- Mungon ndërgjegjësimi publik për dëmin e shkaktuar nga keqadministrimi i mbetjeve.

Sa më efikase të jetë shërbimi i largimit publik të mbeturinave për një komunë të pastër dhe të gjelbër, për një komunë me cilësi jetese më të mirë për qytetarët e saj, për një komunë më të shëndetshme dhe aktive, duhet të ndermirren një varg aktivitetesh dhe projekte të zbatueshme për Uljen e Shkallës së Ndotjes duke:

- Duhet rritur shpenzimet dhe teknologjitë për mbledhjen e mbeturinave
- Vënie në funksion të procesit të riciklimit të mbeturinave
- Vazhdimin e rehabilitimit të sipërfaqeve me mbetje ilegale
- Ndërtimi i një fushe të re të depozitimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave me komunat fqinje
- Marrja e masave për mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve komunale
- Sigurimin e Partneritetit Privat-Publik për përpunimin e riciklimin e mbeturinave
- Iniciativa fiskale për sjellje miqësore ndaj mjedisit
- Vazhdimi i mbjelljes së drunjtëve dhe shtimin e hapësirave të gjelbra
- Marrja e masave për ruajtjen e hapësirave të hapura, bukurive natyrore
- Marrja e masave për rehabilitimin e zonave të ndotura të mjedisit dhe hapjen e zonave të reja gjelbëruese

Organizimet në nivel komunal në bashkëpunim me OJQ-ët dhe partneritetin privat - publik

Një ndër iniciativat që janë shumë të preferuara për një mjedis të pastër e që komuna ka mundësi ta

organizoj në bashkëpunim me ndonjë OJQ-ë mjedisore si dhe në bashkëpunim me MMPH-në është edhe : Fushata për reduktimin e mbetjeve 2019-2027 me moton “Së bashku, për një mjedis të Shëndetshëm”

Fushata Mjedisore, përmban një paketë projektsh drejtuar grupeve të ndryshëm interesi në referencë të çështjeve mjedisore kryesore që ata përfaqësojnë.

Është orientuar në çështjen e Reduktimit të Mbetjeve, si një metodë e re alternative, por edhe si një nga çështjet që përbën problem në cilësinë e mjedisit dhe jetës.

- Programi “Edukimi mjedisor” nga subjektet e kontraktuara për shërbimin e pastrimit” synon të ndërgjegjësojë dhe sensibilizojë opinionin publik për sa i përket çështjes së depozitimit të mbeturinave në kontejner, për të lehtësuar mbledhjen e tyre, si dhe menaxhimin e depozitimit, duke krijuar premisat për të prezantuar elemente të tjera të trajtimit të mbetjeve, nëpërmjet riciklimit. Po ashtu edhe çështje që kanë të bëjnë me pastrimin e rrugëve (fshirjes dhe larjes së rrugëve).

Hapat që duhen ndërmarr për riparimin e dëmeve mjedisore janë:

- Analiza e shtrirjes dhe natyrës së problemit – llogaritja e rrezikut
- Shqyrtimi i alternativave që qojnë në një metodë të pëlqyer – vlerësimi i alternativave
- Hartimi i detajuar i projektit që qon në një specifikim tenderi – përgatitja për programin e pastrimit.
- Lidhja e kontratës dhe zbatimi i saj për pastrimin e mbetjeve

Disa prej këtyre hapave tashmë janë ndërmarrë për sa i përket mbledhjes së mbeturinave por ka ende për tu bërë. Parimi bazë që duhet të respektohet është që toka dhe trupat ujor të ndotur duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme sipas përdorimit të planifikuar. Hapat që duhet ndërmarrë:

- Vetëdijësimi i qytetarëve për aktivitetet jo legale dhe pasojat
- Shtrirja e aktivitetit të Kompanisë për në vendbanimet e mëdha si dhe ndarja në faza deri sa të mbulohet i terri i territorit të komunës
- Mënjanimi dhe grumbullimi i të gjitha mbetjeve ilegale

Hartimi i rregullores komunale në bazë të Ligjit për Mbrojtje të mjedisit dhe funksionalizimi i Inspektoratit të Mjedisit në gjobitjen e veprimeve ilegale mjedisore.

Pjesë e synimit të parë është edhe e masave që duhet ndërmarr me projekte konkrete për **Lumenj të pastër - Parandalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj**

Sfidë e madhe në tërë Republikën e Kosovës por edhe në Komunën e Podujevës është hedhja e mbeturinave të amvisërisë dhe ato të tjera në shtretërit e lumenjve ku pasojat janë shumë të mëdha për ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, si dhe për botën bimore dhe shtazore.

Mbeturinat e ngurta (materiale ndërtimore), mbetjet e plehrave shtëpiake, mbetjet e amvisërisë etj. janë ndotësit shumë të mëdhenj. Nëpër çdo vendbanim ku lumenjtë kalojnë janë vërejtur dukuri të tilla negative.

Hapat që duhet të ndërmirën janë:

- Pastrimi i shtretërve të lumenjve Llap dhe Batllava
- Kontroll rigoroze nga inspektorati Komunal dhe pajisja e tyre me mjete të nevojshme
- Angazhimi i aksionit vullnetar për pastrim të mbeturinave nga lumi Llap, me degët e tij si dhe hapësirës ujore të Liqenit të Batllavës organizuar nga OJQ-të mjedisore dhe Komuna, Drejtoria e Arsimit si dhe nga vet Komuniteti për vetëdijësim për ujëra .

Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjeve në fuqi nga inspektorati si dhe zbatimi i dënimeve për ndotësit.

Synimi 2. Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale në Lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza

Problem në vete në tërë territorin e Kosovës përveç ndotjes nga trupat e ngurtë që hidhen në shtretërit e lumenjve është edhe shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak e sidomos edhe i objekteve komerciale.

Podujeva ka një rrjet hidrografik të pasur edhe pse sasi të janë të mjaftueshme për nevojat aktuale. Cilësia e tyre shpesh është problem për shkak të ndotjes, sidomos në zonat ku jetojnë pjesa më e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen aktivitetet kryesore.

Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore është pasojë e të gjitha veprimtarive aktuale urbane, industriale dhe bujqësore. Ujërat e zeza urbane paraqesin problem të veçantë si pasojë e mungesës së trajtimit të tyre.

Pjesa më e madhe e qytetit, kombinon sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza dhe mbledhjes së ujit të bardha që shkarkohen drejtpërdrejtë në ujin sipërfaqësor.

Ndotja e ujit nga aktivitetet si p.sh. pastrimi i automjeteve dhe servisimi, mbetjet bujqësorë, pesticidet e ruajtura keq apo të braktisura dhe kimikate të tjera, shkarkimi i ujërave të zeza në trupat ujqor pa trajtim paraprak ndikojnë në cilësinë e dobët të ujit.

Presione të tjera përfshijnë ndërtimet e pakontrolluara, ndotja dhe eutrofikimi që vjen nga ujërat e zeza të pa trajtuara që shkarkohen në lumenj dhe nga rrjedhja e plehrave kimike dhe pesticideve nga toka bujqësore në drejtim të lumenjve, rrëshqitje dhe gërryerje të tokës, praktikat e gjuetisë në dëm të mjedisit etj.

Masat e parapara në këtë strategji:

- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në tërë zonën urbane .
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet rurale, dhe ndërtimi i sistemeve të gropave septike
- Përcaktimi i lokacionit varësisht se cili opsion është i përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- Ndarja e kanalizimit fekal nga ai i shirave
- Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza në përputhshmëri me standardet
- Identifikimi i lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në jug të qytetit .
- Prioritet është mënjanimi i ujërave të zeza që shkarkohen në Liqenin e Batllavës

Të gjitha implikimet buxhetore janë paraparë në Infrastrukturë. Këto rekomandime janë konformë rregullave mjedisore .

Synimi 3 . Ndërmarrja e masave anti-erozive

Dy janë problemet gjeneralë më kryesore dhe më shqetësuese: Erozioni dhe prishja e cilësisë së tokës. Erozioni është procesi natyror i veprimit të ujit dhe erës mbi tokën. Megjithatë, shkalla e erozionit mund të rritet shumë nga aktivitetet e papërgjegjshme të njeriut. Niveli i lartë i erozionit paraqet një sërë problemesh që janë të pranishme sot në territorin e komunës . Rreth 22000ha janë të ekspozuar direkt erozionit

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive :

Meliorimi i pyjeve 11850 ha

Brezi mbrojtës i shpateve 18170 ha

Mbrojtja ndërtimi i tarracave 3498 ha

Zonat e zhvillimit të punëve të antierozionit 790.3 ha

Masat parandaluese me molerim të pyjeve kanë kosto më të lirë se aktivitetet tjera antierozive dhe në

bashkëpunim me MBPZHR mund të arrihen efekte pozitive në përmirësimin dhe stabilizimin e masave tokësore.

Një ndër prioritetet e ngadalësimit eroziv është edhe kontrolli rigoroz i shfrytëzimit të masës drusore

Pasojat:

- Prishja e cilësisë së tokës dhe humbja e pjellorisë
- Dalja e ujit nga shtretërit e lumenjve
- Është shtuar rreziku i rrëshqitjeve të tokës dhe humbjes së saj;
- Depozitimi i sedimenteve në lumenj, që ndryshon rrjedhën e tyre natyrore dhe problemet ekologjike;

Degradimi i pyjeve, mbi kullotja, zhdukja e sipërfaqeve me drunj dhe atyre frutore dhe ndërtimet, e sidomos i rrugëve, kanë zvogëluar sipërfaqet me bimësi dhe si pasojë rrisin erozionin.

Kontrolli i erozionit është kërkesa kryesore, e shoqëruar nga praktikatat e administrimit të baseneve të lumenjve dhe të cilat ulin efektet negative të transportimit dhe depozitimit të sedimenteve.

Në rastin e erozionit është bërë një dallim mes erozionit në zonat e larta malore dhe erozionit në zonat e ulëta fushore. Edhe pse kjo “ndarje” nuk është aspak e përsosur ajo duhet kuptuar si e tillë, që përfshin një dallim mes zonave me pjerrtësi të madhe dhe zonave me pjerrtësi më të vogël. Të parat, në përgjithësi përfshijnë zona pyjore kurse të fundit janë kryesisht bujqësore.

Masat që kërkohet të ndërmerren përfshijnë:

- Masat hidroteknike
- Masat bujqësore
- Masat biologjike

Ruajtja e cilësisë së tokës – Ndërtimet e pa kontrolluara, mbetjet e amvisërisë, mbetjet ndërtimore, mbetjet industriale, përdorimi jo i drejtë i plehrave kimike dhe pesticideve, mënyra e përdorimit të tokave, shkarkimi i ujërave të zeza, fatkeqësitë natyrore siç janë vërshimet etj. ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e tokës.

Duke marr parasysh një varg problemesh që shkaktohen nga faktori njeri duhet marr masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet eksperteve të fushave bujqësore.

Masat parandaluese;

1. Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë
2. Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme
3. Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve
4. Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave

Synimi 4 Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve

Komuna me kapacitetet e veta dhe në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamentin e ujërave, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës) duhet të ndërmarrë masat vijuese hidrologjike, në mënyrë që të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet nga rreziku i vërshimeve:

- Largimi i barrierave nga shtrati i lumenjve, qofshin ato natyrale apo të krijuara nga njeriu
- Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese
- Ndërtimi i kanaleve dhe / ose mureve mbrojtëse
- Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet.
- Komuna do të ndërmarrë masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve. Prerja e domosdoshme do të lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave

peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për rregullim peizazhor për rekreim, si modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit.

- Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve aty ku ka licencë për eksploatim, si dhe ndëshkimi i operatorëve ilegal të bëhet nga Inspektorati komunal me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore të lumenjve dhe dëmtimeve të shtratit që mund të shkaktojnë vërshime.
- Çdo ndryshim i rrjedhës së lumit do të ndalohet nga komuna dhe veprimet që mund të çojnë deri në rritjen e rreziqeve nga vërshimet do të kontrollohen në mënyrë strikte.

Synimi 5 . Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Vlerat e natyrës në favor të zhvillimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit janë prezentë në komunën e Podujevës. Synim kryesor për mbrojtjen e vlerave natyrore është edhe mbrojtja nga ndërtimet në zonën e Liqenit të Batllaves.

Masat

- Parandalimi i ndërtimeve
- Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të hartoj planet rregulluese për „Liqenin e Batllavës”
- Komuna së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të ketë efekte negative ndaj këtyre vlerave.
- Komuna në bashkëpunim me MKRS, të inicioj me akt të veçantë vënien nën mbrojtje lokalitetet arkeologjike.
- Të përpilohet katalogu i hartave për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për nevojat e turizmit.

Synimi 6. Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve

Problemet e natyrës ilegale të prerjeve të pyjeve janë prezentë në territorin e Kosovës njashtu edhe në komunën e Podujevës si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar të pyjeve . Shifra ekzakte nuk ka edhe pse vlerësimet janë të larta nga se shumë ekonomi familjare që shfrytëzojnë lëndën djegëse për amvisni me aktivitetin ilegal të prerjes së pyjeve shkaktojnë pasojat të mëdha mjedisore që janë edhe të pa riparueshme.

Hapësira mjedisore është e llojllojshme në komunë. Përzierja e ekosistemeve dhe habitateve përfshin ato malore, fushore, lumenjve, shkurret, pyjet gjetherënëse, halore dhe të përziera, kullotat, livadhet dhe zonat e larta malore. Kjo shumëllojshmëri bimore dhe shtazore nuk është mbrojtur në nivelin e duhur nga njeriu dhe moskujdesi ndaj tyre ekziston edhe sot e kësaj dite. Problemet thelbësore janë praktikatat e papërshtatshme të ndjekura në zonat malore, sidomos shpyllëzimi si dhe degradimet mjedisore

Problemet lidhur me administrimin e pyjeve janë identifikuar qysh në fillim të viteve 1990. Këto probleme janë duke u trajtuar kohët e fundit nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës si dhe me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale ku nevojat e decentralizimit dhe nevoja për administrim më të mirë ja ka kaluar pronësinë e pyjeve pushtetit vendor, me kusht që të hartojnë e të marrin masa për zbatimin e Planeve për Administrimin efikas.

Masat që duhet ndërmarr komuna:

- Në bashkëpunim me MBPZHR/Agjencionin e pyjeve të ndërmarr masa strikte për parandalimin e prerjeve ilegale.
- Në bashkëpunim me njësinë Zjarrfikëse, SSPK, FSK, Njësinë e Ujësjellësit, Agjencionin e pyjeve dhe të gjithë faktorët relevant të krijohet shtabi i emergjencës në rast të paraqitjes së zjarreve

në pyje.

- Të bëhen vlerësime nga ekspertet e pylltarisë për nevojat e rralimit dhe prerjes sanitare të pyjeve në mënyrë që shfrytëzimi i pyjeve do të plotësojë nevojat e qytetarëve
- Hartimi i planeve menaxhuese të pyjeve për periudha afatgjate.

Ripyllëzimi i hapësirave të zhveshura dhe krijimi i brezave të gjelbëruar

Sipërfaqet e zhveshura në territorin e komunës së Podujevës janë prezentë sidomos në lartësitë mbidetare mbi 700m ku edhe aktiviteti eroziv është më i theksuar.

Masat që duhet ndërmerren për ruajtjen e këtyre zonave dhe peizazheve të mbetura e të cilat mbrohen me ligj, për qëllime argëtimi, çlodhjeje e turizmi por edhe për ruajtjen e biodiversitetit janë:

- Ripyllëzimi ose ripërtëritja e kullosave të sipërfaqeve që kanë pjerrtësi më shumë se 15%
- Sipërfaqet e identifikuara me erozion të mesëm, të lartë dhe shumë të lartë të pyllëzohen.
- Krijimi i brezave të gjelbër për gjatë shtretërve të lumenjve është masë parandalues erozive.
- Hulumtimet e tokës dhe përshtatja e fidanëve për pyllëzim dhe ripyllëzim.

9.5 Mjedis i pastër dhe atraktiv

- Eliminimin e të gjitha vend grumbullimeve ilegale të mbeturinave në të ardhmen.
- Organizimin e një sistemi funksional dhe mjaft efikas për menaxhimin e mbeturinave.
- Angazhimi i kompanive profesionale për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- Funksionalizimi i inspektoratit të mjedisit dhe ndërmarrja e masave të rrepta ndaj veprimeve ilegale mjedisore.
- Kontroll më të shpeshta dhe të veçanta përgjatë rrjedhave lumore me qëllim të mbrojtjes së tyre nga hedhja e mbeturinave.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe me donatorët privat për të gjetur mundësinë e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve dhe gropave septike.
- Parandalimin e operatoreve ilegal të gurthyesve, grumbullimin e taksave mjedisore dhe ndalimin e furrave për pjekje të gëlqeres me materiale plastike.
- Mbrojtja e trashëgimisë përfshinë disa masa konkrete për të ardhmen, ku paraprakisht duhet kushtuar vëmendje të veçanët mbrojtjes së trashëgimisë ekzistuese nga degradimet eventuale deri realizimin e projekteve të parapara në këtë strategji për fushën e trashëgimisë.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatorët tjerë për hartimin e planeve menaxhuese të pyjeve, si dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura.
- Për ta mbrojtur tokën kualitative bujqësore, organet komunale duhet ta respektojnë vijën e ndërtimit që është përcaktuar në fazën e koncepteve, ku të gjitha vendbanimet e komunës kanë drejtimitet e zgjerimit dhe drejtimitet kah nuk mund të zhvillohen për shkak të tokës kualitative.

10.0 PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIM TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

Harta Zonale Komunale ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat të prezantuara si në tabelën vijuese, për të cilat janë planifikuar një mori veprimesh për zbatim.

Tabela 20. Objektivat e PZHK-së të për të cilat HZK ka paraprr kushte zhvillimore për zbatim

FUSHAT TEMATIKE / QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	
ADMINISTRATË PUBLIKE	Q1. Administratë funksionale dhe efikase
	O1. Kuadër profesional
	O2. Digjitalizimi i administratës
ZHVILLIM EKONOMIK	Q3. Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë
	O1. Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut
	O2. Sigurimi i punës sezonale
	O3. Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme
	Q7. Zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm ekonomik
	O1. Zhvillim dhe rritje e prodhimit në bujqësi (drithërave, pemëtarisë dhe perimtarisë)
	O2: Përkrahja e zhvillimit të blegtorisë dhe bletarisë
	O3: Funksionalizimi i zonave industriale
INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	Q2. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi
	O 1. Ofrimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore në ato vendbanime ku janë identifikuar kërkesat
	O2. Zgjerimi i hapësirave dhe ngritja e cilësisë fizike të objekteve arsimore dhe shëndetësore
	O3. Rritja e numrit të kuadrit të kualifikuar profesional, në arsim dhe shëndetësi
	O4. Programe dhe trajnime të vazhdueshme profesionale në arsim dhe shëndetësi
	O5. Sigurimi i pajisjeve teknike për shërbime arsimore dhe shëndetësore
MJEDISI/TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE	Q6. Mjedis të pastër me shfrytëzim racional dhe mbrojtje efikase
	O1: Parandalimi dhe largimi i mbeturinave nga trupat ujor dhe mjedise tjera
	O2: Ndërmarrja e masave anti-erozive
	O3: Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve
	O4: Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore
INFRASTRUKTURA	Q8. Infrastruktura e planifikuar
	O1. Asfaltimi i rrugëve për zonat me prioritet
	O2. Funksionalizimi i vijës hekurudhore
	O3. Përmirësim i rrjetit energjetik
	O4. Shtrirja e telefonisë fikse dhe internetit në zonat me prioritet
	O5. Zgjerim dhe kontroll i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Me vlerësimin e zbatimit të HZK-së e cila përfshin periudhën nëntë vjeçare (2019-2027) të zbatimit të tij, janë evidentuar veprimet e zbatuara në masë të plotë, të pjesshme, ato që kanë qenë në zbatim e sipër, veprimet që zbatohen në vazhdimësi si dhe ato që kanë mbetur për tu zbatuar në të ardhmen. Vlerësimi i zbatimit të PHZK-së ka evidentuar disa veprime të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të tij, të cilat

nuk janë marrë parasysh gjatë hartimit të PZHK dhe ka konsideruar të domosdoshme përfshirjen e tyre me HZK. Poashtu gjatë hartimit të HZK, janë analizuar dokumentet dhe strategjitë më të fundit qeveritare dhe plane të ndryshme lokale të veprimit të hartuara pas PZHK-së si dhe ka konsultuar Institucione të ndryshme relevante të cilat planifikojnë investime të ndryshme në komunë. Në këtë mënyrë janë identifikuar një mori veprimesh/projektesh të cilat janë inkorporuar në planin e veprimit të HZK.

11.0 PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operationale në kuadër të hartimit të HZK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin Komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe të qytetit.

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen në dhjetë pika si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjedisve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të HZK-së parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës nëpër vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar.

- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës.
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – akses i nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit.
- Rehabilitimi i tokës bujqësore
- Rihvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime.
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

11.1 Objektiva Strategjike

Objektivat strategjike të HZK-së janë në përputhje me parimet e lartpërmendura të planifikimit hapësinor të qëndrueshëm, ato janë shprehje e nevojave të zhvillimit të Podujevës, dhe si të tilla janë pranuar gjerësisht qofte nga Grupet punuese, e qofte nga Ekipi komunal i Planifikimit të ngritur për hartimin e Hartës Zonale Komunale.

Objektivat strategjike të pranuar gjerësisht përfshijnë:

- Komuna e Podujevës– komunë me vendbanime atraktive dhe që përballojnë nevojat për banim;
- Komuna e Podujevës– Komunë e shëndetshëm
- Komuna e Podujevës – Komunë policentrike;
- Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe tjera të gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe krijimin e korridoreve ekologjike në dhe për rreth vendbanimeve;
- Përmirësime dhe zgjerimi i rrugëve përfshire edhe koristë për biçikleta dhe këmbësoret;
- Përmirësim transportit publik (përmirësim i shërbimit të autobusëve)
- Zgjerim i vendbanimeve në drejtimin e tokës më pak kualitative bujqësore
- Përfshirja dhe integrimi në planifikim i situatës faktike të ndërtimeve dhe tipologjisë së përdorimit të tokës [psh. përdorim toke i përzier në vendbanimet që kanë kushte për zhvillime të tilla]

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, HZK-ja përpiket të zbatohet disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si psh. Komuna e Podujevës komunë e X-sit policentrik, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhëtojë për të siguruar shërbimet veç në qendrën administrative.

HZK-së parashikon zhvillimin e Komunës si një e tërë me territor të bashkuar me vendbanimet, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, duke qenë plan i zhvillimit komunal, do jepen kufijtë, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijojë me planet rregulluese urbane të detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi. Plani do përpiket të përfshijë konceptin e formulës së menaxhimit të pronës në mënyrë adekuate pa dallime të pronarëve gjatë destinimeve në zona ndërtimi, gjelbërim etj.

HZK-ja parasheh një zhvillim me miqësor me mjedisin, duke synuar pyllëzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve dhe shume mundësi të rritjes së sipërfaqeve të gjelbra brenda vendbanimeve. Parashikohet krijimi i një mundësie qarkullimit me biçikleta përgjatë disa rrugëve e sidomos në disa vendbanime të mëdha. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktikë i këtyre synimeve të HZK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisore të komunës.

Gjithashtu plani synon të integrojë dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë me plleshmëri të dobët dhe me përdorim të përzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i Hartës është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisore, ndërrmarje që krijon mundësi për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për çlodhje dhe argëtim.

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Krijimi i një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
2. Identifikimi dhe krijimi i habitetve të reja dhe korridoreve të gjelbër;
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
4. Kursimi i energjisë dhe pakësimi i emisioneve të gazeve serrë;
5. Cilësia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës Kuadër për Ujin të BE-së;
6. Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe menaxhimi i integruar i tyre;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me biçikleta;

8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror nga erozioni dhe vërshimet;
11. Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

11.2 Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbra në Podujevë:

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura dhe të propozuara si zona të mbrojtura në komunën e Podujevës;
2. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me HZK;
3. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve;
4. Krijimi i korridoreve të reja ekologjike sipas Planit të ri dhe zonave të Podujevës;
5. Zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridorin përgjatë shtretërve të lumenjve;
6. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve në vendbanime etj;
7. Kthimi i zonave të ndotura industriale në sipërfaqe të gjelbra;
8. Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive private;
9. Gjelbërimi me drunj dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
10. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

Veprime operacionale për përmirësimin e sistemit të transportit dhe shtimit të përmbajtjeve:

1. Përmirësim i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i rrugëve të reja sipas mundësisë;
2. Krijimi i rrjetit të plote rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biçiklistët dhe këmbësoret;
3. Përmirësim i sistemit, orareve dhe cilësisë së autobusëve;
4. Përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korsive për biçikletat sipas standardeve evropiane të rrugëve;

11.3 Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatësisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret e trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peizazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

11.3.1 Kriteret e Forta Mjedisore-Shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. Parqet nacionale), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore.

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

- zonat e mbrojtura me vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Nuk lejohen ndërtimet në zonat që bartin vlera të veçanta mjedisore.

Synim kryesor për mbrojtjen e vlerave natyrore është edhe mbrojtja nga ndërtimet në zonën e Liqenit të Batllavës.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtretërit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre

- Zonat me pjerrësi më të madhe së 15 apo 20%

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmbytjeve (qofte dhe shume të rralla), mund të shkaktojnë erozion të brigjeve, si dhe të cenojnë regjimin hidrogeologjik të sistemit ujor.

Nuk lejohen ndërtimet në tokat bujqësore të kategorisë prej I – IV,

Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore të sigurohen me masa konkrete dhe të mos lejohen ndërtimet e pa planifikuara.

Ndërtimi është i lejuar vetëm në zonat e përcaktuara për zhvillimin e vendbanimeve (tokën ndërtimore). Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat me pjerrësi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqësojnë) situatë erozive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në këtë fazë të Hartës Zonale Komunale është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjatë hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhshme mund të super punohet me informata tjera dhe të shfrytëzohet si bazë për plane rregulluese dhe projekte tjera.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore përfshijnë:

- Deponit e egra të mbeturinave komunale
- Ndërmarrjet si: fabrika e armaturës, prodhimit të bllokave, prodhimin e lëngjeve
- Pularit, Thertoret
- Ndërmarrjet e riparimit të automjeteve
- Zonat ku është gjuajtur me granata me përbërje edhe të uraniumit të varfëruar

Këto zona duhet të jetë objekt i studimeve për vlerësimin e situatës mjedisore mbi bazën e të cilit do të mund të gjykohet mbi nivelin e ndotjes së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërmarrë për rehabilitim.

Në mënyrë të ngjashme, në afërsi të hot-spotëve tjera duhet hulumtuar shkalla e ndotjes dhe rrezikut mundë të kemi raste kur ndotja ose edhe shkalla e rrezikut nuk i kalon standardet dhe zonat e tilla mund të konsiderohen për zhvillim, por edhe raste të kundërta dhe kësaj mund të konsiderohen si zona që nuk janë të përshtatshme për zhvillim ose mundë të zhvillohen nëse merren masa të caktuara.

11.3.2 Kritere të Trashëgimisë Kulturore

Komuna e Podujevës ka objekte të trashëgimisë kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturore dhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qellim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Monumentet arkitekturale të rëndësisë lokale, nacionale dhe internacionale janë:

Kullat në Herticë, e Sali Agës, Kompleksi në Reçicë, Përmendorja te Tabet e Llapashticës, Shtëpia Muze e Hasan Ramadani, Kulla dhe oda e Dem Ahmetit kanë rëndësi nacionale.

Sugjerohet zhvillimi në respekt të funksionit kryesor kulturor. Duhet të krijohen kushtet që monumentet të bëhen të vizitueshme nga publiku.

Lista e monumenteve të kulturës do duhet rishikuar dhe lehtësuar ndjeshëm. Disa prej monumenteve të kulturës janë cenuar, tjetërsuar apo zhdukur dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi që mund të mbrohen. Duke pasur vlera të ndërtimit tradicional, këto zona turistike duhet ruajtur me karakter të veçantë.

11.3.3 Kritere Peisazhike

Kriteret peisazhike janë më të vështirë për të përcaktuar pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe

duhen caktuar në bashkëpunim dhe pajtueshmëri me institucionet tjera.

Zona me vlera të larta peizazhike në të cilat nuk duhet të lejohet ndërtimi përfshijnë:

- Liqeni i Batllavës me karakter hidrologjik dhe ekonomiko-turistik.
- Peizazhet bujqësore, po ashtu në periudha të caktuara të vitit paraqesin një atraksion
- Livadhet dhe kullosat, është paraparë që të mbjelljen me lloje të shumta të bimëve barishtore,
- Masivet malore të Kopaunikut dhe Gollakut

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t'i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atrakte, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e planeve hapësinore, ndërkohë që Podujeva edhe se ka përgatit këtë planë duhet që të gjejë mirëkuptim dhe bashkëpunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjerë për nevojën e mos-lejimit të ndërtimeve në këto zona, qoftë duke e sanksionuar këtë edhe me akt-normativ.

11.3.4 Kriteria Inxhinierike dhe te Infrastrukturës

HZK-ë duke trajtuar shfrytëzimin e tokës, mjedisin, infrastrukturën dhe fushat tjera si ajo e zhvillimit ekonomik dhe social ofron një mundësi të zhvillimeve të qëndrueshme nëse merr në konsideratë posaçërisht sistemin inxhinierik dhe nevojat e infrastrukturës së komunës si pjesë integrale dhe i trajton në sistemin multishtresor për të mënjeluar konfliktet eventuale dhe ofruar zgjidhje të qëndrueshme.

Duke qenë se Transportit mbështet kryesisht në cilësinë e transportit publik me autobusë dhe promovim nëpër vendbanime edhe shfrytëzimin e biçikletave dhe udhëtimin këmbë, HZK-ja duhet të marrë parasysh tipin e sistemit rrugor të planifikuar dhe ndërtesat që mund të ngrihen duhet të respektojnë një largësi të mjaftueshme nga sistemi rrugor, përfshi trotualet apo korsite e biçikletave sipas rastit.

Në mënyrë të ngjashme, projekti i vendosjes së kolektorëve të ujërave të ndotura, trajtimit të përkohshëm të ujërave të ndotura në nivel komunal, të vendbanimeve apo të lagjeve (sipas Planit për Ujin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura brenda HZK-së) duhet zbatuar atë që është përfshirë në HZK-ë, dhe ajo përmbajtje duhet evidentuar në sistemin GIS-it. Edhe ndërtimet e mundshme duhet të respektojnë një largësi të pranueshme. Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit duhet monitoruar për të parandaluar rrjedhjet, rinovuar sipas nevojës dhe futur nëntoke sipas standardeve dhe duke u shënuar problemet në sistemin GIS që shoqëron HZK-në.

Gjithashtu, linjat e transmetimit të energjisë, dhe ato të telefonisë fikse do duhet të rekonstruohen, avancohen dhe sa më shumë të futen nëntokë dhe të shënohen në sistemin GIS-it që shoqëron HZK-ja. Natyrshëm ndërtesat e reja do duhet të respektojnë distancë të pranueshme nga këto linja. Antenat e telefonisë celulare nëpër vendbanime është mire të jenë të grupuara dhe jo të shpërndara, megjithëse kjo çështje është e vështirë të trajtohet në kuadër të HZK-së. Mendojmë që problemi i antenave duhet të jetë objekt i një studimi të veçantë, përfshirë ndikimin eventual në shëndetin e njeriut.

Duke pasur parasysh që mbetjet mbështeten në sistemin e trajtimit të mbetjeve sipas hierarkisë Redukto-Ripërdor-Riciklo-Djegje-Vend depozitim (Landfill), duhet që HZK-ja të pasqyrojë këtë parim dhe të planifikojë zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit dhe mundësisht të parashikojë zona që mund të përdoren për djegie apo pikë transiti për të ardhmen, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.

11.4 Efektet kumulative

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhden e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në HZK të Podujevës.

Në këtë raport ndikimet mjedisore kumulative percaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të zhvillimeve të planifikuara të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vlerësohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktorët klimatike, biodiversitetit impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të HZK-së shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- ajrin, shkarkimet e ndotesve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;
- token, zona toke bujqesore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;
- faktorët klimatik, shkarkimet e gazeve serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve të të gjithë veprimeve të HZK-së janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- shkarkimet limiteve të ndotësve
- menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyren, trashëgimie kulturore dhe peisazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur zhvillimet përmes kushteve zhvillimore në HZK-së. Kur vlerësohen efektet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe ne distance) dhe kohës (afat-shkurter, afat-mesem dhe afat-gjate, perkohësisht dhe permanent) të efekteve.

Nëse vlerësohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efekti komulativ të HZK-së shprehen si efekte të kombinuara komulative dhe zakonisht referohen për:

- zvoglimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike;
- zvoglimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat e marrura në HZK që lehtësojnë veprimtari shlodhëse dhe rekreative në një mjedis.

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të HZK-së shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për zhvillimin e kushteve zhvillimore të HZK-së janë

positive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

Në vlerësimin e efekteve komulative në larmaninë biologjike të llojeve organike (biodiversitet) në zhvillimet e planifikuara shprehën si efekte të kombinuara duke rritur impaktin në biodiversitet, mirëpo me masat që janë marr me HZK efekti do të jetë më i zbutur deri te efekti pozitiv për biodiversitetin.

Tabela 21. Matrica e përmbljedhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentet

Komponentet mjedisore	Elementete e HZK-së					Vlerësimi i efekteve kumulative
	Kushtet Zhvillimore për rrugët e planifikuara	Autostradat dhe rrugët nacionale	Kushtet Zhvillimore për Zonat e planifikuara të ndërtimeve	Kushtet Zhvillimore për Zonat ekonomike dhe industriale	Kushtet Zhvillimore për Pyllëzimi dhe bujqësi	
Emetimi i gazrave serrë	0	-	+	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Burimet natyrore	+	0	0	+	+	Pozitive
Toka	+	0	+	-	+	Pozitive
Uji	+	0	+	0	+	Pozitive
Ajri	+	-	+	0	+	Pozitive
Biodiversiteti	0	-	0	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës

mjedisore.

12.0 NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

12.1 Harta Zonal Komunale e Podujevës dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit

HZK është rezultat i evidentimit, vlerësimit, dhe prioritizimit të nevojave strategjike zhvillimore sociale-mjedisore të Komunës së Podujevës dhe komunitetit të saj nga ana e Grupit hartues të Hartës Zonale Komunale. HZK ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e Vizionit, të këtyre objektivave dhe prioriteteve strategjike në një sistem planifikimi zhvillimor komunal. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i planeve tjera të vendbanimeve dhe zonave ndërtimore të niveleve më të ulëta dhe kodeve me instrumente të veçanta zhvillimi hapësinor, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të veprimit me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit komunal në zonën e përfshirë në studim.

Plani merr në konsideratë dhe përgjithësisht është në përputhje me planet e ndryshme të niveli më të lartë, si dhe në linjë edhe me shtyllat kryesore të zhvillimit të Planeve Sektoriale, Planet dhe projektet Sektoriale që hartohen edhe si rezultat i këtij plani duhet të bëjnë ose të parashikojë të përfshijë vlerësime të kostove dhe të identifikojë ose përfshijë identifikimin e masave të nevojshme që duhen ndërmarrë për implementimin e këtyre propozimeve. Propozimet për zhvillimin zonave, rrugëve etj përfshihen si në propozimet për përdorimin e tokës, ashtu edhe për ndarjen në faza, pasi duhet që të ruhen apo të gjenden sipërfaqe toke për zhvillimin e zonave, ndërtimin e rrugëve etj, për sa kohë që mundësia e aksesit shihet si mekanizmi kryesor që drejton zhvillimin.

Ka edhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me HZK-në. Përveçse bën sistemin e planifikimit më efektiv, plani bën identifikimin dhe përshkrimin e problemeve të menaxhimit komunal, por nga ana tjetër ai është i orientuar drejt përgjigjeve të këtyre problemeve.

Si rezultat, HZK do të shërbejë edhe si një proces i cili mundëson adresimin e shumë prej problemeve mjedisore të Komunës së Podujevës. Kryesisht duhen investime në infrastrukturë dhe përmirësim i menaxhimit komunal me qëllim që t'u jepet përgjigje shumë prej problemeve mjedisore të hapësirës komunale të marrë në studim, ndërsa procesi i planifikimit të zhvillimit të zonave dhe shfrytëzimit të tokës duhet zbatuar sipas këtij plani, me qëllim që të parandalohet shtrirja e mëtejshme nëpër zonat bujqësore dhe zonat me vlera tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Kjo nevojë për planifikim dhe menaxhim në nivel vendbanimesh të shumta bashkërendimi dhe veprimi në mes tyre është identifikuar si çështje e rëndësishme edhe në raportet e HZK. HZK gjithashtu propozon masa për mbrojtjen e zonave ekzistuese të gjelbra dhe ujërave brenda dhe rreth territorit komunal dhe ka përgatitur planin e masave për zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Këtu përfshihen zonat e ujërave sipërfaqësore, përgjatë lumenjve dhe nëpër vendbanime.

12.2 Konsiderata Mjedisore në Hartimin dhe Përpunimin e Hartës

Plani është punuar duke pasur në konsideratë edhe vlerësimin mjedisor në çdo fazë të zhvillimit të tij. Megjithatë nuk është qëllim kryesor për HZK-në, outputet e fazës së parë të studimit të HZK-së (faza e profilit komunal) përmbajnë të dhëna dhe komente të konsiderueshme mbi gjendjen dhe problemet e mjedisit në Podujevë. Gjatë fazave të zhvillimit të HZK-së merren në konsideratë çështje mjedisore apo të ofrimit të shërbimeve dhe diskutojnë gjendjen dhe shkakun e problemeve mjedisore në Komunë.

Analiza e Plotë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK-së

Ndikimi i problemeve mjedisore në komunën e Podujevës nuk është kthyer ende në efekte ekonomike apo shëndetësore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një check-list e kritereve mjedisore sipas të cilave

është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse HZK-ja e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nëpërmjet shenjave si më poshtë:

- Atje ku HZK-ja i jep përgjigje të plotë problemit është vendosur treguesi V;
- Në se HZK-ja e ka trajtuar problemin, por ka nevojë për masa të mëtejshme vendoset treguesi ?
- Në se ka problem i cili duhet të trajtohet nga HZK-ja, vendoset treguesi X.

Tabela 22. Objektivat me veprime për zbatim të HZK

Tabela: Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të HZK-së			
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në HZK ?	Si është trajtuar problemi në HZK ?	Treguesi
1. Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Përfshihen në seksionet e mëposhtme.	√
2. Përfshirja e konsideratave shëndetësore	Po	Përshkruhen në seksionet e mëposhtme	√
3. Marrja parasysh e objektivave ndërkombëtarë, kombëtarë dhe lokalë për mjedisin dhe shëndetin gjatë formulimit të HZK -së	Po	Merren fort në konsideratë në procesin e hartimit të HZK-së	√
4. Përfshirja në sintezë e Konsideratave Mjedisore	Po	Janë përfshirë në HZK	√
5. Konsideratat mjedisore në Opsione	Po	Kjo është bërë si pjesë e procesit të VSM .	√
6. Koncepti i Planifikimit të HZK-së			
a. Mbështetje për zhvillimin policentrik të Podujevës	Po	Propozimi ndjek në mënyrë pragmatike prirjet ekzistuese dhe ato strategjike të zhvillimit komunal dhe socialo ekonomik të Podujevës. Problemi është që kjo rritje të bëhet mbi bazën e kritereve të forta mjedisore, dhe të mos shtrihet në tokat bujqësore dhe pyjet përreth.	√
b. Afirmon rolin e Podujevës në nivel të Kosovës, krahas ofrimit të mundësive të reja që përforcojnë	Po	Orientohen drejtimit e konfirmimit te Podujevës si qendër dhe si pike fokale për të gjitha anët e vendit në kuptimin e zhvillimit të turizmit dhe fuqizimit të trashëgimisë kulturore.	√

funkcionet aktuale dhe që tërheqin aktivitete të reja.			
d. Përforcimi i kapacitetit të Komunës për të thithur banorë të rinj dhe për t'u siguruar atyre mundësi punësimi	Po	Kjo propozohet të bëhet nëpërmjet zgjerimit në hapësirë në vendbanimet që kanë trende rritje dhe ofrimit të kushteve edhe në vendbanimet tjera	√
e. Integrimi i zonave rurale në komunë dhe ulja e shkallës së përjashtimit ekonomik dhe social të banorëve të tyre	Po	Është marr në konsideratë që në fazën e nismës së hartimit të HZK -së, zonat rurale të trajtohen njëjtë si vendbanimet tjera.	√
f. Fuqizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve në dy akset kryesor që formojnë konceptin e X-sit	Po	Ky koncept ka si qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe rigjenerimin e vendbanimeve në sistemin policentrik. Ai përfshin propozime mjedisore në formën e ruajtjes së zonave të gjelbra edhe përtej kufijve ndërtimor të vendbanimeve	√
g. Strukturimi dhe ekuilibrimi i zhvillimit komunal rreth nën-qendrave të reja	Po	Ky propozim ka si qëllim zhvillimin e nënqendrave të tjera për të ulur stresin në një zonë qendrore. Si i tillë, ai propozon ndërtimin e një serie funksionesh nëpër këto nënqendra.	√
h. Fuqizimi i korridorit industrial përgjatë rrugës regjionale dhe trasesë së planifikuar të Autostradës në përgjigje të potencialeve dhe nevojave të reja ekonomike	Po	Ky koncept ka si qëllim të mbështesë por dhe ridimensionojë atë që po ndodh aktualisht, zonat përkaj rrugëve regjionale po zhvillohet pak më shpejtë dhe intensitet më të theksuar nga zonat tjera, Ka disa shqetësime mjedisore që lidhen sidomos me zonat pranë lumenjve ,zonat ku shtrihen objektet industriale. Është e nevojshme të tregohet mënyra se si do të ruhen dhe trajtohen këto zona. Duhet bërë kufizimin e shtrirjes së disa vendbanimeve afër trasesë së autostradës është proces që kufizon shtrirjen në drejtim të autostradës në	√

		largësi minimale 50 m, raste të tilla ku duhet të parandalohen.	
i. Valorizimi rrënjësor i aksit të Lumenjve të Podujevës	Po	Ky koncept dhe kjo ndërhyrje ka për objektin insertimin e disa zonave ujore brenda hapësirës së Podujevës, dimensionimi i zonës sipas kriterëve mjedisore, dhe zgjidhja e një problemi të fortë mjedisor të zonës	√
j. Përmirësimi i shërbimeve publike dhe aksesit ndaj transportit në zonat rurale	Po	Po, por duhet arritur një ekuilibër mes aksesit të përmirësuar dhe inkurajimit të zhvillimit të mëtejshëm të ndërtimeve rurale në zonat ku kjo gjë mund të mos jetë e dëshirueshme.	√
7. Ndryshimet e klimës			
a. Përshtatja me ndryshimet globale	Po. Nuk është objekt parësor i parashikuar nga TeR, por në studimin mjedisor janë integruar objektiva dhe instrumenta zbatimi të cilat shkojnë në këtë drejtim si ai i uljes së "gjurmës së karbonit" të komunës.	a. Përshtatja me ndryshimet globale	√
b. Marrja parasysh e ndryshimeve lokale	Po	Përfshihet si tregues mjedisor, por nuk trajtohet në mënyrë parësore.	?
8. Demografia			
a. Problemet e evolucionit demografik	Po	Një faktin se kjo është ende e vështirë për t'u parashikuar saktë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet, për t'i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme.	√
b. Skenarët e zhvillimit demografik	Po	Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet jo edhe aq shumë deri në vitin 2027. HZK mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	√
9. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i Tokës			
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në HZK?	Si është trajtuar problemi në HZK?	Treguesi
a. Planifikimi komunal dhe Drejtimi i	Po	Një nevojën për pranimin e zhvillimit aktual, përveç zonave ku	√

Zhvillimit		mund të shkaktohen probleme mjedisore	
b. Kapacitetet mjedisore në zonat dhe vendbanimet e propozuara për zhvillim	Po	Vlerësohet se vetëm në disa zona si ato ku shtrihen deponit ilegale të mbeturinave, gurthyesit ka një gjurmë të cenimit ekologjik, duke e rrezikuar kapacitetin e saj mjedisor. Ndërsa në vendbanime nuk ka një gjurmë të cenimit ekologjik, duke qenë brenda kapaciteteve mjedisore. Zona e propozuara për zhvillim industrial apo ekonomik shtrihet në tokën jobujqësore dhe propozohet studimi i VMN-së së veçantë për aspektet tjera mjedisore ndërsa në vendbanimet brenda konceptit policentrik vërehen tendencat e shtrirjes në kategorinë “tokë bujqësore” të konvertuara vonë në zona informale, por edhe këtu tentohet të ruhet sa ma shumë tokë bujqësore dhe kompaktsim sa ma i madh i zonës ndërtimore.	√
c. Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja të çlodhëse	Po	Njeh problemin e mungesës së tokës për këtë qëllim vetëm brenda vendbanimeve dhe propozon mbrojtjen e zonave të gjelbra dhe parqeve duke krijuar një Kurorë të gjelbër të përbërë nga disa zona dhe sisteme kodrinore malore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe zonat që gjenden brenda vendbanimeve dhe në zonat jashtë tyre janë të përcaktuara kufijtë, duhen marrë vendimet përkatëse për shpalljen zona të interesit komunal, dhe duhen aprovuar Planet e Menaxhimit lidhur me zhvillimet brenda këtyre kufijve.	?
d. Zhvillimi i parqeve të reja brenda vendbanimeve policentrike	Po	Edhe se pjesërisht e thamë më lartë se njohim problemin e mungesës së tokës brenda zonës së vendbanimeve policentrike PZHK propozon një varg masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me veprime për çdo kategori zonash në vendbanime.	?
e. Mbrojta e pyjeve,	Po	Njihen problemet dhe bëhen	√

gjelbërimeve dhe parqeve ekzistuese		propozimet përkatëse, dhe për Pyjet, hapësirat e gjelbra duhet çuar përpara statusi i tyre dhe duhet hartuar dhe aprovuar Plani i Menaxhimit të tyre por edhe Parqet ekzistuese duhet trajtuar në mënyrën adekuate në tërë territorin e komunës.	
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në HZK?	Si është trajtuar problemi në HZK?	Treguesi
f. Zhvillimi i zonave të reja komunale	Po	Nxitet ky zhvillim veçanërisht në fushën e hapësirave dhe terreneve sportive, për të lehtësuar presionin në. Disa vendbanime me zhvillime të reja janë tashmë të me elemente urbane . Ekziston rreziku që të mund të inkurajojë shtrirje të mëtejshme jashtë kufijve ndërtimor, dhe për këtë shkak VSM ka sugjeruar shpalljen e kufizimit të ndërtimeve në këto drejtime të komunës. Mund të shkaktojë humbje të mëtejshme të tokës bujqësore.	?
g. Industrinë	Po	Përdorimi i zonës me kualitet të dobët të tokës për zonë Industriale si zona prioritare për zhvillim. HZK i përputhet me parimet strategjike ku aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje nuk do të lejohej dhe do të dekurajohen mirëpo gjithashtu që për gurthyesit, Ndërmarrjet si: fabrika e armaturës, prodhimit të bllokave, prodhimin e lëngjeve, pularit, thertoret dhe zhvillimet tjera me karakter industrial në Podujevë që kanë prani të ndotjes duhet menaxhuar në përputhje me normat e sigurisë mjedisore dhe shëndetësore evropiane .	V
h. Zonat ish-industriale	Po	Do të diferencohen mbi bazën e kriterëve mjedisore zonat ish-industriale, duhet të konsiderohen si hot-spote të ndotjes dhe duhet të trajtohen si të tilla, Disa zona të tilla ish-industriale ose zona eksploatuese pa operator të njohur kanë prani të ndotjes e cila duhet menaxhuar në përputhje me normat e sigurisë mjedisore dhe shëndetësore evropiane .	?

i. Shërbimet dhe lehtësirat Publike (shkolla, stadione sportive)	Po	Propozon norma dhe nevojën për to në komunën e Podujevës.	√
j. Pyjet, Kodrat dhe parqet	Po	Trajtohen si zona të mbrojtura për pyje dhe parqe. Dekurajohet me forcë ndërtimi në këto zona për pos kur është definuar me këtë planë. Vija problematike shtrihet rreth rrugëve regjionale ku kërkohet zona e shiritit të gjelbër dhe fillon edhe depërtimi në kodra dhe male. Duhet të trajtohen zonat prioritare edhe nga pikëpamja e peizazheve pra e pikave panoramike me rëndësi peizazhistike dhe turistike për komunën.	?
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në HZK?	Si është trajtuar problemi në PZHK?	Treguesi
k. Forma e vendbanimeve dhe dendësia	Po	Propozime konkrete në kodin e zonimit për lartësinë e ndërtimeve. Ato bazohen në ruajtjen e formës së vendbanimeve, mbushjen e zonave me densitet të ulët, dhe identifikimin e zonave ku do të lejohet zhvillimi i ndërtimeve në lartësi.	√
l. Mbrojtja e detajuar e Zonave të Gjelbra			
m. Lumenjtë	Po	Të kthehen në korridore të gjelbër, por ndërkohë duhen përcaktuar kufijtë e shtretërve të lumenjve dhe të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi mjedisor	?
n. Parqet dhe zonat e mbrojtura			
a) Kombëtare	Po	Zona rreth Liqenit të Batllavës duhet të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi në kuptimin e zhvillimit mjedisor	X
b) Të reja	Po	Sugjerohet një seri Parqesh dhe zonave të rëndësisë komunale, por mbetet problemi i Planeve të Menaxhimit të tyre pasi që kufijtë janë caktuar me HZK.	?
o. Brezi i gjelbër	Po	Në zonat përgjatë rrugëve magjistrale, zonat industriale dhe zhvillimet tjera.	√
p. Pjesa e brendshme e vendbanimeve	Po	Jepen standardet për zonat lokale. Njihet problemi i mungesës së hapësirës për rritjen e sipërfaqeve të	√

		gjelbra apo për zona komunitare si sheshe, kënde lojërash, etj. dhe bëhen propozime në lidhje me instrumentet planifikues në planet e detajuara vendore.	
q. Zona të reja	Po	Zonat e reja me përdorime të ndryshme propozohen të kthehen në zona të gjelbra dhe parqe.	√
10. Rreziqet natyrore apo humane			
a. Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe.	?
b. Rrëshqitjet e tokës	Po	Trajtohen në mënyrë specifike, sepse jepen standardet kufizuese për pjerrësitë e mëdha.	?
c. Vërshimet	Po	Trajtohen në përgjithësi, propozohen masat për zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet	√
d. Erozioni	Po	Trajtohen në përgjithësi, propozohen masat për zvogëlimin e rrezikut nga erozioni	√
e. Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjence në rast tërmeti.	?
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në HZK?	Si është trajtuar problemi në HZK?	Treguesi
c. Të ardhurat e ulëta	Po	Njeh problemin se strehimi në ndërtesa të reja të ligjshme është i mundshëm vetëm për grupet me të ardhura të larta. Rekomandon nevojën që të ndërmerren politika sociale të strehimit.	√
d. Cilësia	Po	Kërkohej miratimi dhe respektimi rigoroz i kodeve të ndërtimit.	
e. Shkalla sizmike	Po	Rekomandon kritere projektimi në përputhje me nivelin 8 në shkallën MSK-6421, pasi ky është një rrezik i njohur. Do të ishte mirë të sugjeroheshin projekte sipas Shkallës Evropiane Makrosizmike (EMS) për të respektuar standardet Evropiane.	√?

12.3 Masat e Nevojshme në HZK-ë për Mbrojtjen e Mjedisit

Bazuar në analizën e mësipërme ky seksion bën rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me V nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mësipërme përmban një përmbledhje të të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën HZK-ja u jep përgjigje secilit prej tyre. Megjithatë, një nga pikat e tabelës së mësipërme që ka të bëjë me skenarët dhe parashikimet e rritjes së popullsisë, megjithëse është trajtuar, ka nevojë për diskutim të mëtejshëm.

12.3.1 Konceptet Urbanistike të Përdorimit të Tokës, përfshi Zhvillimin e Qendrave

Problemi më kryesor dhe i pariparueshëm mjedisor për komunën e Podujevës, aktualisht është depërtimi (shtrirja) në tokat bujqësore me plleshmëri. HZK-ja e njej plotësisht këtë problem dhe sugjeron mekanizma për parandalimin e tij. HZK-ja sugjeron se duhen marrë masa nga të gjitha vendbanimet, kompetentët dhe institucionet me qëllim trajtimin e këtij fenomeni.

HZK-ja tregon destinimin e propozuar të tokës për vitin 2027. Këtu prezantohen edhe kufijtë e rij ndërtimeve edhe zhvillime tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me plleshmëri, tokës së pasur me resurse, të kodrave dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e të cilat potencialisht mund të paraqesin pikat e nxehta mjedisore.

Konfliktet e mundshme për hapësira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet edhe në Harta Zonal Komunale e Podujevës. Janë organizuar takimet e para me komunitetin për të filluar këtë proces. Rreziku kryesor mjedisor do të ishte në se nuk arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët për Podujevën.

Në Kosovë e veçanërisht por edhe në Podujevë, shtrohet problemi i përmirësimit të kapaciteteve mbajtëse mjedisore nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të planeve të qëndrueshme (ky është një nga synimet edhe të HZK-së), përmirësimit të menaxhimit komunal dhe investimeve në infrastrukturën e mjedisit.

Rritja e Podujevës besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Komuna e Podujevës, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës. Duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, sërish lind pyetja: ka një kufi maksimal për rritjen e popullsisë? Kapaciteti mjedisor mbajtës i Podujevës nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financime të mëdha në infrastrukturën mjedisore. Plani i njej këto probleme dhe përpiqet në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

12.3.2 Ndryshimet e klimës

Ndërkohë që ka shumë faktorë të jashtëm që ndikojnë në ndryshimet klimatike, dendësimi i ndërtimeve mund krijojë ndryshime në mikroklimë. HZK-ja nuk mund t'u japë zgjidhje këtyre ndryshimeve, por mund të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës. Megjithatë skenari "mos bëj asgjë" i cili nuk ndihmon në ruajtjen e zonave të gjelbra dhe që lejon zhvillimin e pakontrolluar në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim shumë më të madh në mikroklimë, jo vetëm në rritjen e temperaturave, por edhe stuhi më të rralla, por më të fuqishme, të cilat do të shkaktojnë përmbytje më të dëmshme.

12.3.3 Mbrojtja e Pyjeve, Zonave të Gjelbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja

Kodet e zonimit të propozuara nga HZK-ë krijojnë mundësinë për struktura të gjelbra, kryesisht për përdorim të ndryshëm, Pyllëzim, ripyllëzim etj. Duhet hartuar udhëzues për:

- Projekte pyllëzimi konform planit
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Përdorimin e tyre, të themi për grupe/festa të mëdha, gjë që do të kishte ndikime negative.
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues; dhe
- Shërbimet e infrastrukturës për ofrimin e energjisë, ujit dhe menaxhimit të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndikimeve vizuale dhe ndotjet e mundshme.

Ka deri diku zhvillim në këto zona. Duhet përgatitur propozimet lidhur me mënyrën se si do të trajtohen këto zhvillime. Harta zonale e komunës ku hynë edhe lumenjtë e Podujevës shërbejnë pikërisht për këtë qëllim.

Disa nga zonat e Podujevës kanë të përcaktuar në mënyrë të qartë kufijtë e zonës së gjelbër. Megjithatë, kjo çështje bëhet më komplekse në disa zona. Shumë nga vijat e pronave bien mbi zona të pa definuara edhe në kontekstin pronësor, ky problem është i theksuar, për këtë arsye, duhet ngritur një sistem i cili të bëjë të mundur përcaktimin e këtyre kufijve.

12.3.4 Cilësia e Ajrit

HZK-ja mundet të adresojë problemet e cilësisë së ajrit vetëm në mënyrë të pjesshme. Ndërtimi i rrugëve cilësore do të ulë trafikun nëpër vendbanime të mëdha, duke sjellë përmirësim të cilësisë së ajrit, ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2027 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, Nox, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve)ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afatmesme. PM10 mund të reduktohet nëpërmjet përdorimit të teknikave më të mira të

ndërtimit dhe shtrimit të më shumë rrugëve. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së keqe të ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së sëmundshmërisë me qëllim vlerësimin sasior të demit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën. HZK-ja nuk e ka adresuar problemin e zhurmave. Megjithatë, disa nga masat e parashikuara në Hartësi shtimi i numrit tampon zonave, diversifikimi i transportit publik, futja e korsive të biçikletave, furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike dhe shmangia e përdorimit të gjeratoreve, krahas masave administrative komunës së Podujevës për pakësimin e zhurmave në një kategori të mjediseve publike që aktualisht janë problematike, do të ndikojë në uljen e nivelit të zhurmave, krahasuar me vlerat aktuale.

12.3.5 Menaxhimi i Mbeturinave

Në vendbanimet rurale të komunës ekzistojnë shumë deponi të egra, shpesh herë nga 2-3 sosh në çdo vendbanim. Sa më efikase të jetë shërbimi i largimit publik të mbeturinave për një komunë të pastër dhe të gjelbër, për një komunë me cilësi jetese më të mirë për qytetarët e saj, për një komunë më të shëndetshme dhe aktive, duhet të ndermirren një varg aktivitete dhe projekte të zbatueshme për Uljen e Shkallës së Ndotjes duke:

Duhet rritur shpenzimet dhe teknologjitë për mbledhjen e mbeturinave. Vënie në funksion të procesit të riciklimit të mbeturinave. Vazhdimin e rehabilitimit të sipërfaqeve me mbetje ilegale. Ndërtimi i një fushe të re të depozitimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave me komunat fqinje. Marrja e masave për mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve komunale.

12.4 Probleme të Mjedisit në Podujevë dhe Përgjigja që Jepet përmes HZK-së

Tabela e mëposhtme bën një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në të cilën HZK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Tabela 23. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas HZK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e keqe e ajrit në disa zona të Komunës së Podujevës	Aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar Rrugë të pashtruara Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve Karburate të cilësisë së keqe Gjeneratorë me naftë Cilësi e keqe e zonave të gjelbra të cilat gjenerojnë pluhur për shkak të mungesës së bimësisë së vazhduar në to.	Cilësia e ajrit në disa pjesë të komunës më e ulët se standardet ndërkombëtare përsa i takon përmbajtjes aerosolëve dhe grimcave tjera.	Nuk ka të dhëna për lidhjen, por sëmundjet respirator e janë shkaku i tretë i vdekjeve në Komunë (pas sëmundjeve kardiake dhe kancerit)	Do të vazhdojë të përkeqësohet me rritjen e numrit të automjeteve. Mundet vetëm të ngadalësohet. Mund të balancohet vetëm nëpërmjet reduktimit të aktiviteteve ndërtimore. Mund të riparohet vetëm në rast se ndërmerren masat e duhura	Propozimet për pyllëzim Propozimet për shirita gjelbërues Propozimet për transportin ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime.	Janë kryer dhe po kryhen studime mbi pyllëzimin. Janë kryer dhe po kryhen studime mbi transportin Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e squfurit të bjerë). Përmirësimet dhe ndërtimet e rrugëve nga Komuna e Podujevë në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës. Mbjellja e pemëve nga Komuna	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së keqe të ajrit në shëndet dhe ne ekonomi. Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar pluhurin. Shtrimi i rrugëve, përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave. Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit. Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve Vendosja e kritereve strikte për pyllëzimin Vendosja e kritereve strikte për Cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore). Rehabilitimi i zonave të gjelbra ekzistuese nën këtë këndvështrim.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjve	Të gjitha ujërat e ndotura derdhen në lumenj.	Ujë i ndotur i lumenjve përgjatë gjithë rrjedhës.	Përbën problem shumë të madh në Komunë. Nuk njihen efektet që mund të ketë përgjatë rrjedhës së lumenjve.	Do të përkeqësohet më tej dhe mund t'i kthejë lumenjtë në septikë, veçanërisht në stinën e verës, me rritjen e ngarkesës së ndotjes dhe reduktimit të bazës së prurjes nga prerja e pemëve. E riparueshme në se ndërmerren masat e duhura.	Skenari i zhvillimit të PZHK në përputhje me studimin e Planit hapësinor të Kosovës. Vendi i identifikuar për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura është në përputhje me Planit hapësinor të Kosovës pjesa e trajtimit të ujërave të ndotura. Trajtimi i përkohshëm dhe sipas zonave I ujërave të ndotura	Përgatitja e Projekteve Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza të Podujevës	Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqërohet edhe me minimizimin e rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm	Furnizim me ndërprerje i ujit të pijshëm që nuk i garanton një cilësi konsumatorit Puse të ndotura nga zhvillimi i pakontrolluar Lidhje të paligjshme dhe pompa të përdorura. Intersektime të linjave të ujërave të zeza me ato të ujit të pishem.	Ndotja e ujërave nëntokësore Konsum i ujit në shishe dhe gjenerimi i mbetjeve plastike.	Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.	Do të përkeqësohet me rritjen e përmasave të disa vendbanimeve dhe të kërkesave. Është i nevojshëm zhvillimi i burimeve të reja. Një ndikim i kthyeshtëm nëse merren masat e duhura.	Skenari i zhvillimit i HZK përputhet me studimet e mëhershme për cilësinë dhe sasinë, Në HZK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të interferencave që ka.	Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.	Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujërave të zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe nëpërmjet masave të parashikuara në pikën e mësipërme 2.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
4. Mbledhja dhe grumbullimi mbetjeve të ngurta dhe komunale	Mungesa e një sistemi reduktim-ripërdorim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës së Podujevës Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme, Podujeva do të ketë edhe disa tjera deponi ilegale brenda vjetëve të ardhshme. Mbetjet ndërtimore, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale	Komuna gjeneron sasi të mbetjesh të ngurta. Në disa vendbanime të Podujevës pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara, sidomos në shtretërit e lumenjve pamja është shumë e shëmtuar. Mund të jenë burim sëmundjesh veçanërisht në stinën e nxehte.	Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë këtyre deponive dhe herë pas herë kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Podujevës.	Sasia e mbetjeve do të rritet njëherazi me zhvillimet e reja Duhet përmirësuar mbledhja e mbeturinave në komuna. Rreziku se mund të ketë rritje të hedhjes së paligjshme të mbeturinave, pasi deponia e e Dumnicës nuk i plotëson kushtet dhe deponia regjionale është larg, ka kosto për deponim dhe transport dhe disa pika grumbullimi të përkohshmeend e nuk janë organizuar.	HZK sugjeron fort adoptimin e një sistemi të integruar të administrimit të mbetjeve të ngurta, bazuar në itinerarin reduktim-ripërdorim-riciklim-rikuperim. HZK propozon zhvillim për disa zona. Grumbullimi i mbetjeve të ngurta është proces që ka filluar dhe për këtë arsye nuk përfshihet në plan.	Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi Për pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbetjeve. Ky projekt sektorial do të eksplorojë opsione të ndryshme të trajtimit dhe menaxhimit me deponi të përkohshme dhe transportit drejt deponisë regjionale	Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohshme drejt asaj regjionale njëjtë të menaxhohet me pagesë për ton për hedhjen e mbeturinave në Deponin regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina. Zbatimi i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit . Vazhdimin e rehabilitimit të sipërfaqeve me mbetje ilegale. Ndërtimi i një fushe të re të depozitimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave me komunat fqinje. Marrja e masave për mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve omunale

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
5. Rehabilitimi /Inkapsulim i pikave te nxehta të ndotjes	Ndotja e tokës nga aktivitetet Industriale viteve 90-ta dhe luftës së fundit	Ndotja e tokës dhe ajrit nga përbërje të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe biodiversitet	Në vartësi të lëndëve ndotëse, mund të shkaktojnë një game të gjerë sëmundjesh	Hapësirat, zonat dhe rrethina e ish zhvillimeve industriale, tashme jashtë funksionit, ose edhe pjesërisht në funksion mund të përdorën për aktivitet te tjera përfshirë në disa raste edhe mjedise banimi, qe mund te jete me pasoja te rrezikshme për shëndetin e njeriut	Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat,zonat me rrethinë ku janë zhvilluar industritë ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Podujevës që kane përdorur ose gjeneruar kimikate te rrezikshme për shëndetin, para, gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazën e shkalles se rrezikut të bëhet ndërhyrja teknike	Te mblidhet informacione më të thelluara për këtë gjendje, për nivelin dhe llojin e ndotjes,për ndikimet në tokë,ujë ajër ekzistencën e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcënimet për shëndetin, llojin e kërcënimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator	
6. Shtrirja e ndërtimeve	Nevojat për banim Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendbanimeve sidomos nëpër terrene me tokë të pëlleshme bujqësore dhe ato kodrinore e malore.	Humbje e tokës së pëlleshme dhe gjelbërimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistike të territorit komunal.	Jo i drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm Por shtrirja pa përcjellë me infrastrukturë normal që shkakton edhe pasoja në shëndet Edhe rrëshqitjet e mundshme të tokës dhe përmytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbërimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut	Do të vazhdojë të zhvillohet me këto trende shkon në drejtim të përkeqësimit dhe do të jetë e pakthyeshme?	Planifikohet kufiri ndërtimor për të gjitha vendbanimet Standardet dhe normat e planifikimit të përdorura në HZK bëhen automatikisht të vlefshme Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe,zona të gjelbra dhe tampon zona për rreth disa vendbanimeve	HZK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi HZK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e parkut,zones së gjelbër dhe tampon zonës	Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve Të përgatiten projekte për gjelbërim, parqe dhe tampon zona. Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen plane rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit policentrik.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
7. Degradimi i pyjeve, dhe mungesa e parqeve tampon zonave të gjelbra	Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve Djegëjet e pyjeve Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve.	Ndotja e ajrit Ndotje e ujit, mungesë e kënaqësisë si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët.	Ndotja e ajrit edhe e ujit kanë ndikim dhe pasoja në shëndet Edhe ndikimim	Do të vazhdojë me degradimin e mëtejshëm i pyjeve Të ketë ndotje nga mos ekzistimi i shiritave të gjelbër në rrugët ku janë të nevojshme këto shirita Të ketë ndotje nga gurëthyesit dhe industritë e zhvillimet tjera në mungesë të tampon zonave Këta tregues do të tregojnë rënie dhe do të jetë e vështirë të riparohet.	Revitalizimi i pyjeve ekzistuese Propozohen mbulim me fidane të reja sipërfaqet e zhveshura Revitalizim i zonës për rreth Liqenit të Batllavës Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime. Gjelbërim dhe tampon zona gjelbëruese	Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi, sanim për pyjet e Podujevës në zonat e parapara me PZHK Projekt Propozimi për të shpall park nacional Liqenin e batllavës dhe disa parqe të reja, Projekt propozimi për tampon zonat	Ngritja e një mekanizmi bashkëpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte Kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjelbërim dhe tampon zona Aktivizim i gjykatave, policisë inspektorëve në mënyrë cilësore Në ish vend depozitimet legale dhe ilegale duhet të merren masat rehabilituese dhe ri gjelbërim ose gjelbërim.
8. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar dhe disa vendbani me të mëdha	Zhvillimet me trende të ndryshme nëpër vendbanime nuk janë në harmoni me arkitekturën ekzistuese.	Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike.	Të dhëna të pa disponueshme por aspekti psikologjik dhe shpirtëror mendohet se do jetë prezent	Do të vazhdojë dhe ndoshta do të përshpejtohet, duke qenë i pakthyeshëm.	Identifikon zonat brenda studimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie	Identifikimi i instrumenteve ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Podujevës që banojnë në këto vendbanime dhe zona.	Përditësimi, zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
9. Mungesa e hapësirave të reja të gjelbra nëpër vendbanime të komunës së Podujevës.	Shumë hapësira janë të degraduara. Sipërfaqe të gjelbra dhe të lira publike janë tjetërsuar nga disa banorë	Humbja e pemëve, sipërfaqes së gjelbër dhe e vlerës së kënaqësisë për banorët.	Rritje e sëmundshmërisë për shkak të shtimit të ndotjes së ajrit, veçanërisht të përmbajtjes së PM10, PM2.5, etj., në ajër.	Në se nuk identifikohen dhe mbrohen zonat potenciale, atëherë ato do të humbasin.	Përfshin zona prioritare dhe sugjeron procesin nëpërmjet të cilit do të identifikohen dhe ruhen. Propozohen ndryshime në plan, duke shtuar sipërfaqe të gjelbër.	Zgjerimi i parqeve dhe rehabilitimi i shesheve të vendbanimeve të mëdha dhe tjerave. Propozohet rehabilitimi dhe pastrimi i hapësirave ekzistuese	Të bëhet analiza e deficitit për secilën vendbanim të komunës për të caktuar zonat prioritare. Identifikimi i zonave prioritare dhe i fondeve për zhvillim. Krijimi i zonave të gjelbra pilot në hapësirat në disa vendbanime.
10. Rrezik për tërmete, rrëshqitja e tokës, vërshimet dhe element tjerë rreziku	Podujeva bën pjesë në zonë sizmike aktive të nivelit mesatar Ka rrëshqitje në disa zona dhe erozion e burime tjera rreziku	Varësisht por dine të jetë me ndikim të lartë mjedisor sidomos nga ndikimet indirekte	Mund të rezultojë katastrofik	komuna nuk ka një strategji të meaxhimit të risqeve natyrore ose tjera të shkaktuara	Në kodet e ndërtimit, por nuk specifikon nevojat e ndërsjellta.	Komuna duhet të ndërtojë brenda standarteve të larta anti-sizmike	Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet pasur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.
11. Rreziqe nga radoni.	Rreziku natyror nga shtresa e kuqe e sub – argjilës të deltës së lumenjve	Nuk dihet plotësisht shkaku	Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj radioaktivitetit mund të shkaktojë kancer..	Rreziku mbetet i pa menaxhuar	Nuk ka	Nuk njihen	Përcaktimi i rreziqeve për shëndetin Përcaktim i zonave me rrezatim të lartë Kode të ndërtimit për të siguruar mbrojtje nga radioaktiviteti i tokës nëpërmjet materialeve të padepërtueshme si dhe ventilimin. Ndërgjegjësim më i mirë rreth problemit.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
12. Rreziqe nga amiati / azbesti.	Rreziku kancerogjen nga ekspozimi ndaj lëshimit të fibrave të holla të amiatis në ajër	Fijet e holla futen brenda trupit të njeriut dhe maturojnë sëmundje kancerogjene në harkun kohor të 10-30 vjetëve brenda trupit.	Ekspozimi i qoftë edhe i rastësishëm dhe sado i vogël ndaj fijeve të amiatis.	Rreziku do të mbetet i njëjtë.	Sugjeron identifikim të zonave me prani të trashëguar të amiatis dhe ndërhyrje për sanitarizim të këtyre zonave	Duhen ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amiatis.	Përcaktimi i rreziqeve për shëndetin nga amiatis. Kode të ndërtimit për të siguruar mbrojtje i nga emetimi i radioaktivitetit. Ndërgjegjësim më i mirë rreth problemit.
13. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes	Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të komunës	Humbje e zinxhirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të banorëve	Do të vazhdojë të përkeqësohet.	Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.	Projekte të asistuara nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunë duhet zhvilluar studime të situatës.	Nevoja për të pasur një studim bazë për Podujevën me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe mundësitë për përmirësimin e situatës.
14. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Podujevë	Të gjitha problemet e lartpërmendura, por nuk ka informacion të detajuar mbi ndikimin	Ndotje e lumenjve dhe tokës	Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen	Ndotja e ajrit do të shtrihet në një zonë më të madhe me zgjerimin e vendbanimeve dhe përkeqësimin e ndotjes	Jashtë studimit, por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industrial dhe ndërtimore.	Projekte të asistuara nga MMPH, BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zonës së veprimit lokal, komunal ,kombëtar ose edhe ndërkombëtar	Nevoja për të pasur një studim bazë për Podujevë me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundësitë për përmirësimin e situatës.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa HZK	Propozimet e HZK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
15. Ndotje akustike në Podujevë	Qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët regjionale e magjistrale, mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të moseficensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standarteve, cilësia e ulët e automjeteve, Objekteve industriale	Nivel i lartë i zhurmave.	Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.	Rritja e vazhdueshme ose mos disiplinim i problematikës.	Krijim i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të "zgjuar" rrugor Përmirësim i transportit publik Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve.	Edukimi qytetar për mos shkaktimin e ndotjes akustike. Aplikimi në ndërtesat ekzistuese dhe te reja te materialeve izolues te zhurmave.	Masa të karakterit rregullator për standardet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penaltitetet ndaj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Podujevës.

13.0 MONITORIMI

Suksesi i HZK-së dhe VSM përkatëse do përcaktohen nga respektimi i kushteve, rregullave dhe objektivave të shpallura dhe të aprovuara. Në mënyrë të veçantë, puna do vijojë me hartimin e Planeve dhe projekteve tjera që do të detajojnë dhe qartësojnë më tej elementet kryesore të cilat paraqiten përmbledhtas në HZK -ë. Si të tilla, duhet që këto Plane dhe projekte të ndjekin frymën dhe parimet e HZK-së e të mos cenojnë rregullat përkatëse. Monitorimi i respektimit të HZK -së edhe gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve tjera do jetë përgjegjësi dhe detyrim i komunës së Podujevës.

Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e “Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE për VSM-n. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjencisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal .

Me qëllim që HZK -ë të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruar edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qene sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbatuese të HZK -së. Plani Monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësajndërmarrjekërkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjencisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbështetur në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Podujevës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të HZK -së. Këtu përfshihen qoftë Planet ,projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i HZK-së në Plane rregulluese për vendbanimet policentrike, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Podujevës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerëzore dhe financiare të gjithë veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorin e planifikimit të Mjedisit dhe struktura të tjera në vartësi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësinë e ndërtimeve, ecurinë e pyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, rregullimin e shtretërve të lumenjve, ecurinë nderimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me biçikleta dhe tjetër indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të HZK-së.

Rezultatet e monitorimit, komuna e Podujevës sipas ligjit për VSM-n, duhet të publikoj në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM, VNM për monitorimin dhe rezultatet të përcillen komunës së Podujevës dhe MMPH-s gjegjësisht Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor të publikoj nëkuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën Kosovës.

Tabela 24. Receptorët Mjedisor

OReceptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtjes së Mjedisit		Indikatori	Raportimi	Institucioni përgjegjës
Shëndeti banoreve	Promovimi për krijimin e një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme	1. Cilësia e burimeve të ujit të pijshëm konform stand. të BE ujeratsipërfaqësore dhe nëntokësore destinuar për ujë të pijshëm 2. Cilësia e ujit të pijshëm konform standardit 3. Dendësia e popullsisë e qëndrueshme në vendbanimet me trend të rritjes së popullësisë	1. Cilësia e burimeve të ujit të pijshëm, kundrejt standardit të BE. 2. Cilësia e ujit të pijshëm në përputhje me standardin 3. Dendësia mesatare për këto vendbanime	1. Rap. Vjetor 2. Rap. Vjetor 3. Rap. Vjetor	1. Drejt. Shërbimeve Publike Podujevë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 2. komuna e Podujevës
Biodiversiteti	Identifikimi dhe krijimi i habitetve të reja, dhe korridoreve të gjelbëra	1. Zgjerimi dhe përmirsimi parkut në Zonen e Liqenit të Batllavës dhe Krijimi i parqeve tokësore të reja nëpër disa vendbanime 2. Krijimi i mjedisve të gjelbra në vendbanime 3. Rehabilitimi i sipërfaqeve të pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra në zonat e banimit 4. Mbjellja e drujëve, pemeve dhe shkurreve dekorative përgjatë rrugëve regjionale, shtratit të lumëve 5. Krijimi i korridoreve të gjelbra dhe tampon zonave	1. Sipërfaqet e reja të krijuara, sip. m ² 2. Sipërfaqe të reja, m ² 3. Sipërfaqet të rehabilituara, m ² 4. Numri i drujëve, pemeve dhe shkurreve dekorative të mbjella 5. Sipërfaqe të kthyer në zone të gjelbra, pjesë e korridorit dhe tampon zona; m ²	1. Raportim 1 herë vit 2. Raportim 1 herë në vit. 3. Raportim 1 herë në vit 4. Raportim 1 herë në vit 5. Raportim 1 herë në vit	1. komuna e Podujevës dhe MMPH 2. komuna e Podujevës dhe MMPH 3. komuna e Podujevës dhe MMPH 4. komuna e Podujevës dhe MMPH & MBPZHR 5. komuna e Podujevës dhe MMPH & MBPZHR dhe Ministria e Infrastrukturës
Ajri	Përmirësimi i cilësisë së ajrit	1. Ulja e nivelit të ndotjes së ajrit për: NO ₂ ; LNP; PM ₁₀ ; PM _{2.5} ; O ₃ . 2. Rruge të asfaltuara	1. Arritja e vlerave të standardit për cilësinë e ajrit lidhur me treguesit mbi norme 2. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara rishtas	1. Raportim 1 herë në 6 muaj 2. Raportim	1. AKMM dhe komuna e Podujevës 2. komuna e Podujevës

		<p>rishtas</p> <p>3. Ulja e nivelit te zhurmave ne zonat problematike te Komunës</p> <p>4. Aplikimi ne banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtje akustike</p>	<p>3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmës gjate ditës dhe natës</p> <p>4. Ulja e niveli te zhurmave në mjediset e banimit</p>	<p>1 here ne vit</p> <p>3. Raportim 1 here ne 6 muaj</p> <p>4. Raportim 1 here ne vit</p>	<p>3. komuna e Podujevës</p> <p>4. komuna e Podujevës</p>
Faktorët klimatik	Kursimi i, energjisë dhe pakësimi i emisioneve te gazeve serre	<p>1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat</p> <p>2. Promovimi i paneleve diellor për gjenerim energjie ne ndërtesat residencele dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era</p>	<p>1. Sipërfaqja e objekteve (m²) me izolim adekuat</p> <p>2. Sipërfaqja (m²)e paneleve te instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m²)</p>	<p>1. 1 here ne vit</p> <p>2. 1 here ne vit</p>	<p>1. komuna e Podujevës</p> <p>2. komuna e Podujevës</p>
Uji	Cilësia e ujërave sip.nëpërputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives kuadër për ujin te BE	<p>1.Shmangia e shkarkimeve te ujërave te ndotura ne Lumenj</p> <p>2. Sigurimi i hudhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtien e niveleve minimal të ndotjes</p>	<p>1a.Vëllimi i ujërave qe shkarkohen ne Lumenj;</p> <p>1b. Vëllimi i ujërave mbi normat e lejuara qëshkarkohen Lumenj; m³.</p> <p>2. Sipërfaqja e ndotjes (m²) vëllimi i mbeturinave (kg ose m³) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit</p>	<p>1.Dy herë në vit</p> <p>2. Dy herë në vit</p>	<p>komuna e Podujevës, AKMM.</p> <p>2. komuna e Podujevës dhe AKMM</p>
Mbetjet	<p>3)Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi qendrushem i tyre</p> <p>b) Shnderrimi i pikave te nxehta</p>	<p>a.1. Pakesimi ne burim dhe riciklimi i mbetjeve</p> <p>a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere per ndarjen ne burim te mbetjeve urbane</p> <p>b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne</p>	<p>a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara.</p> <p>a.2. Numri i residenteve qe mbuloohen nga sherbimi kontenier</p>	<p>a.1. 1 Një herë në vit</p> <p>a.2. 1 Një herë në vit</p> <p>b.1.1. Një herë në vit</p>	<p>a.1. komuna e Podujevës ,kompania regionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AKMM</p> <p>a.2 komuna e Podujevës ,kompania</p>

	mjedisore ne siperfaqe te gjelbra/parqe ose zona residenciale	territoret industriale te mbyllura	b.1. m ² te rehabilituara ose inkapsuluara		regionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AKMM b.1. komuna e Podujevës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AKMM
Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intesnsitetit te trafikut nepermjet promovimit te transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhë	1.Zgjerimi i rrjetit rrugor per trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive per bicikleta 3. Ndertimi i rrugeve te reja me hapsira te pershtatshme trotuaresh (perfshire korsite e bicikletave). Zgjerimi i trotuareve gjate rehabilitimit te rrugeve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugeve lokale	1. Km rruge shtese qe mbulohen nga trafiku urban. 2. Km korsit shtese per levizje me bicikleta. Numri i bicikletave ne qarkullim. 3. Km rruge te reja dhe te rehabilituara. m ² trotuarre dhe korsit bicikletash te shtuara. 4. Km rruge lokale te rehabilituara ose/dhe asfaltuara	1.1 Një herë në vit 2. 1 Një herë në vit 3.1 Një herë në vit 4.1 Një herë në vit	1. Komuna e Podujevës, Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 2. Komuna e Podujevës. 3. Komuna e Podujevës, Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 4. Komuna e Podujevës.
Trashegimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirembajtja dhe ruajtja e objekteve te trashegimise kulturore	1.Numri i objekteve/ndertesave me status mbrojtjes 2. Numri i objeketve/ndertesave te restauruara	1.1 Një herë në vit 2.1 Një herë në vit	1. Komuna e Podujevës Instituti për mbrojtjen e Monumenteve 2. Komuna e Podujevës Instituti për mbrojtjen e Monumenteve

<p>Peizazhi,pyjet dhe toka</p>	<p>1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Riperdorimi i tokave te ndotura 4.Mirmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5. Kultivim i pyjeve të reja</p>	<p>1. Shtimi i hapsirave te reja dhe numurit te pemeve e shkurreve. 2. Dhenie e statusi mbrojtje dhe hartimi i nje plani manaxhimi mjedisor i ktyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe venia ne eficiense per zona te gjelbera/parqe ose rezidenciale 4.Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5.Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura</p>	<p>1. Siperfaqet ne m2 dhe numuri i pemeve te mbjella 2.Progresi i zbatimit te planit 3. Siperfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m2) dhe e vene ne perdorim sipas PZHK. 4. Siperfaqe toke së zhvilluar pyjore (ha) 5. Sipërfaqe toke së re pyjore (ha)</p>	<p>1. Një herë në vit 2. Një herë në vit 3. Një herë në vit 4. Një herë në vit 5. Një herë në vit</p>	<p>1. Komuna e Podujevës 2. Komuna e Podujevës 3. Komuna e Podujevës 4. Komuna e Podujevës dhe MBPZHR 5. Komuna e Podujevës dhe MBPZHR</p>
--------------------------------	---	---	--	---	--

14.0 PËRFUNDIM

Hartimi dhe zbatimi rigoroz i HZK-së në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis, bazuar në rekomandimet e VSM-së. Ai do të orientojë rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Podujevës me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Podujevës. Ai gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme. HZK-ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore përreth. Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikasë të tokës.

Ndër alternativat e paraqitura të mundshme, zhvillimi pa plan i deri tanishëm në aspektin e problematikes së zonave ndërtimore, shoqërore dhe mjedisore të Podujevës është total i papranueshëm. Hartimi i HZK-së është një proces i plote i planifikimit të territorit për komunën e Podujevës. Ai gjithashtu shoqërohet me pjesëmarrje të gjerë publike në nivelin teknik dhe strategjik, me VSM, me disa strategji e plane të më hershme, me GIS, Vlerësim të Kapaciteteve Investive, si dhe mundësinë e publikut të gjere të konsultohet dhe të shprehet për projekt-Planin. HZK-së lejon mundësinë e qartësimit dhe detajimit më të hollësishëm gjate hartimit të planeve dhe projekteve tjera lokale (planeve rregulluese). Si e tillë, alternativa e paraparë me HZK vlerësohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera .

Janë pasur parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazheve, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, etj.

Zbatimi praktik i parimeve të përgjithshme në rastin e HZK-së nxjerr disa përparësi si psh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë historike, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

HZK-ja përpiket të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuarra gjerësisht përfshi:

- Komuna e Podujevës– komunë me vendbanime atraktive dhe që përballojnë nevojat për banim;
- Komuna e Podujevës– Komunë e shëndetshëm
- Komuna e Podujevës – Komunë policentrike;
- Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe tjera të gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe krijimin e korridoreve ekologjike në dhe për rreth vendbanimeve;
- Përmirësime dhe zgjerimi i rrugëve përfshire edhe korsitë për biçikleta dhe këmbësoret;
- Përmirësim i transportit publik (përmirësim i shërbimit të autobusëve)
- Zgjerim i vendbanimeve në drejtimin e tokës më pak kualitative bujqësore
- Përfshirja dhe integrimi në planifikim i situatës faktike të ndërtimeve dhe tipologjisë së përdorimit të tokës [psh. përdorim toke i përzier në vendbanimet që kanë kushte për zhvillime të tilla]

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim icilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbra në Podujevë

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbra në Podujevë:

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura dhe të propozuara si zona të mbrojtura në komunën e Podujevës
2. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me HZK,
3. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve
4. Krijimi i korridoreve të reja ekologjike sipas Planit të ri dhe zonave të Podujevës
5. Zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridorin përgjatë shtretërve të lumenjve;
6. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve në vendbanime etj;
7. Kthimi i zonave të ndotura industriale në sipërfaqe të gjelbra;
8. Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive private;
9. Gjelbërimi me drunj dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
10. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

HZK-ja parashikon zhvillimin e komunës së Podujevës si policentrike dhe kompakte në vendbanimet e sajë, duke trajtuar të gjitha elementet deri tek banimi. Në këtë fazë, duke qenë plan i zhvillimit komunal, do jepen zonat, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e parashikuara për të përgjithshme dhe veçanta për vendbanimet dhe zonat tjera, ndërsa puna do vijojë me Planin rregullues, projekte dhe zhvillime tjera për të detajuar zhvillimin. Plani do përpiqet të përfshijë konceptin e formulës së menaxhimit të pronës.

Plani do të jetë një mekanizëm që ofron zgjidhje për zhvillimin e komunës. HZK-ë duhet të fuqizojë komunën të luajë rol me aktiv mes palëve për të ofruar mundësi për të mos mbetur peng i mosmarrëveshjeve mes palëve.

VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga HZK-ja. Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal janë (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret e trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peizazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret e forta mjedisore-shëndetësore përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (i) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. parqet), (ii) zona të rrezikshme për zhvillim (pjerresë të mëdha, shtrat lumi, etj.) dhe (iii) zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. zona të ndotura me mbetje kimike, akumulatore, zona industriale etj.). Nuk lejohet gjurmimi në zonat "hot spot" mjedisore pasi zhvillimi i zonës mund të cenojë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore dhe mund të shkaktojë sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonës në fjalë. Në zonat e ndotura rekomandohet inkapsulimi i tyre duke i kthyer në zonë të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatimit të HZK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Monitorimi i zbatimit të HZK-së dhe parametrave mjedisore të tij do të jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të HZK-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit dhe burimeve natyrore, por puna nuk përfundon këtu. Hartimi i Planeve rregulluese dhe projekteve tjera do duhet të sigurojë përfshirjen e faktorëve mjedisorë gjatë detajimit të planeve në nivel më të ulët gjatë zbatimit të HZK-së. Përveç pikave të renditura më sipër, ka nevojë që hartimi i Planeve rregulluese të shërbejë për të përcaktuar dhe siguruar kufijtë e zonave të gjelbra, si edhe për të

identifikuar dhe zhvilluar hapësira të vogla çlodhëse dhe rekreativo sportive në vendbanime.
Së fundmi – por jo nga rëndësia – duhet të punohet vazhdimisht dha nga të gjitha institucionet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontrollit mjedisor. Ngritja e mekanizmave të tillë në nivel komunal do duhej të ishte vetëm një hap i parë në drejtimin e duhur.

15.0 LITERATURA

1. Plani Zhvillimor Komuna.
2. Plani Rregullues Urban.
3. Plani Lokal i Veprimit Lokal në Mjedis 2012 – 2017.
4. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010.
5. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.
6. Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County.
7. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998.
8. Ernest A. Lowe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries.
9. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010.
10. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
11. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013.
12. Komuna e Podujevës , Hartat e prezantuar në HZK.
13. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë;
14. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010;
15. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
16. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;
17. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.
18. London, ODPM Publications, 2005.
19. PARTIDÁRIO, Maria do Rosário, Guia de Boas Práticas para Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas, Lisbon, Agência Portuguesa do Ambiente, 2007.
20. UN-HABITAT, State of the World's Cities: Cities for All, bridging the urban divide, London, Earthscan, 2010.
21. World Business Council for Sustainable Development, Cement Technology roadmap: carbon emission reductions up to 2050, Paris, International Energy Agency, 2009.
22. Agência Portuguesa do Ambiente, Guia de boas práticas para a Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas, Lisbon, Direcção-Geral do Ordenamento do Território e Desenvolvimento Urbano, 2007.
23. ANDRÉ, Pierre et al, Public participation: international best practice principles, Special Publication Series No. 4, Fargo, USA, International Association for Impact Assessment, 2006.
24. BERGERHOFF, Joachim, Environmental Assessment methodology, UN-Habitat Municipal Spatial Planning Support Program in Kosovo, 2010.
25. CALTHORPE, Peter, Urbanism in the age of climate change, Washington, Island Press, 2010.